

FITOR

GJAZIM

che

BIBLIOTEKA

E

85Hf-32

F 66

SHEFIT

GJIROKASTËR



TREGIMË

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

85Hf-32
F-66

FITORE DHE GËZIM

(Tregime dhe përshkrime)

BIBLIOTEKA E SHKOLLËS
PIONIERIT

~~53.448~~

820

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

DY FJALË LEXUESVE

Nevoja e fëmijëve tanë për libra leximesh letrare në orët e lira ka qenë dhe vazhdon të jetë e madhe. Për plotësimin e kësaj nevoje, Shtëpia Botuese «Naim Frashëri», përveç veprave të shkrimtarëve dhe letrarëve tanë të rinj, ka botuar çdo vit edhe një numër librash me përmbledhje tregimesh nga shumë autorë tanë. Një libër i tillë është edhe vëllimi «Fitore dhe gëzim» që po u jepet sot në dorë lexuesve të vegjël.

Këtu janë përfshirë 23 tregime të 21 autorëve. Lënda ndahet në dy pjesë. Në të parën lexuesit e vegjël do të gjejnë tregime me temën e së kaluarës, kur populli ynë dhe fëmijët tanë vuanin për kafshatën e bukës dhe hiqnin të zitë e ullirit në uri, mjerim e padije nën regjimin e egër feudoborgjez të Ahmet Zogut. Gjithashtu do të gjejnë edhe tregime ku pasqyrohen përpjekjet heroike gjatë Luftës nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, i cili u ngrit në këmbë si një bllok i vetëm në luftë e në revolucionin nën kushtimin e partisë për t'u çliruar një herë e përgjithmonë dhe për t'u hakmarrë.

Tregimet e pjesës së parë do të ndihmojnë që të njohin të vegjëlit tanë se sa shumë kanë vuajtur shokët e tyre në të kaluarën, sa sakrificat janë bërë e sa shumë gjak është derdhur për të fituar lirinë e për të krijuar këtë begati e lumturi që gëzojmë. Në këtë mënyrë ata do të dinë të urrejnë me gjithë shpirt të kaluarën e zezë dhe të çmojnë si duhet të mirat e ditët e bardha që jetojnë, kështuqë, jo vetëm sot që janë të vegjël, por, edhe kur të rriten, do të dinë mirë t'i mbrojnë me çdo sakrificë.

Tregimet e pjesës së dytë trajtojnë tema nga jeta, nga puna dhe nga përpjekjet e pasqirimit të popullit dhe të fëmijëve tanë. Nëpërmjet tyre të vegjëlit do të mësojnë se kombinatet që u ngritën, uzinat e fabrikat, rrugët automobilistike e hekurudhat, hidrocentralet e rezervuarët, shkollat e spitalet, me një fjalë, gjithçka lulëzon e zbukuron sot atdheun tonë të dashur, janë fruti i një pune revolucionare dhe fruti i një mudi e djerse të paparë në historinë e popullit shqiptar. Ato janë frut i mendimit krijues dhe i forcës së pamposhtur të popullit shqiptar, i cili, me shpirt revolucionar, me sy të patrembur, i pamposhtur kundrejt vështirësive, pengesave e mungesave, dhe i udhëhequr, si dje në luftë, edhe sot në ndërtim nga Partia jonë e Punës, me shokun Enver Hoxha në krye, ka ditur që, me duart e veta e duke u mbështetur kryesisht në forcat e veta, të ndërtojë jetën e tij të lumtur.

Në këtë mënyrë ne kemi bindjen se, ashtu sikundër tregimet e pjesës së parë, po kështu dhe tregimet e pjesës së dytë të këtij vëllimi, do të

ndikojnë te pionierët që të duan punën, të duan
dijen dhe shkencën, të jenë luftëtarë të paepur
e revolucionarë dhe, të udhëhequr gjithmonë nga
drita jetëdhënëse e Partisë sonë të Punës, të rri-
tin gjithmonë begatinë e lumturinë e atdheut të
tyre.

si pazvan dhe merrte dy lekë në ditë. Me kaq para s'mund të ushqeheshin vetëm me bukë as tre vetë. Po pesë të tjerët?

Sanija e mbante mend shumë mirë kur i ati e kishte thirrë dhe i kishte thanë:

— Do të shkosh ke hanko Xhevahirja.

— Po shkolla, tatë? — kishte guxue me e pyetë ajo.

Maksuti e kishte pa me trishtim, i kishte përkëdhelë flokët me dhimbje e me dashuri dhe i qe përgjigjun.

— S'qenka shkolla për ne, moj bijë. Po atje, keq, mirë, një copë bukë do ta kesh. Dhe ndigjo: banu e urtë, puno, mos kthe kurrë fjalë.

Sanija qe në klasë të tretë kur e hoqën nga shkolla. Dhe tash, prej disa muejsh, punon si shërbyese ke Demir agai, një nga pasanikët ma të mëdhenj të Tiranës, me kaq e kaq dyqane plot e përplot me mall e me sa e sa çifliqe nëpër fshatra.

Në shtëpi të Demir agait ka të gjitha të mirat... Si i thonë fjalës, gjen edhe qumësht dallandysheje. Por këto të mira s'janë për Sanijen. Ata e fryjnë barkun dhe e bajnë calik me mish e me pula, me pilaf e me bakllava, kurse asaj i japin pak bukë misri e gjizë. Dhe këto, jo gjithmonë. Ata shtrohen në tryezë, në dhomë të bukës, kurse ajo ha vetëm, në hashef ose në oborr. Dhe, sikur kjo të mos mjaftonte, Dylberja për t'i ngjallë zili, shkëputet nga dhoma, vjen pranë saj, tue kafshue herë një copë mish pate, herë një thellë bakllava.

Kur Sanija mbërrini në shkollë, zilja e orës së fundit kishte pak kohë që kishte ramë. Dylberja po luate përpara portës me ca shoqe. Sa pa shërbëtoren tue u afrue, ja pat me inat e me të madh:

— Po ti, moj rjepacake, ç'u bane? Kam nji orë që po të pres.

Shoqet e Dylberes, të nji sëre me të, ja shkrepën gazit. Zonja e vogël u krekos edhe ma tepër. Sanija s' bani za, megjithëse do të kishte dashtë t'ja bante kurizin ma të butë se barkun

Dylberja tha me gjithë madhëshiti:

— Eja mbas meje! — dhe filloi të ecte me hap të randë.

Sanija e ndoq, tue vlue përbrenda nga inati. Dhe, ndërta i shkonte prapa, tue kundrue trupin e saj të majmë, mendonte. «Si e ama, ashtu dhe e bija».

— Ç'u bane, moj kërcune, që u vonove kaq shumë? — thirri hankua kur i pa, — dhe, tue u drejtue nga e bija: — Ku je, moj shpirti i momës? Ec të të put!

Sanijes i erdhi të pështirë, po heshtte, duronte.

Zonja, si u shmall me të bijën, i shfreu prapë Sanijes:

— Ç'më rri ashtu, si e ngrime? Shporru këndeje e mbaroji rrobot, se ta preva kryet...

2.

Kur shkonte në shtëpi të vet, Sanija, pyetjeve të prindve se si e çonte te Demir agai, u përgjigjeje gjithnji:

— Mirë!

Këtë e bante që të mos i mërziste, të mos i dëshpëronte. Ç'kuptim kishte t'u tregonte të vër-

820
LIBRARI E MËTRES
TIRANË
~~53.419~~

tetën, t'u thoshte se as barkun s'e ngopte me bukë, se silleshin me të ma keq se me një kafshë? Edhe po t'u fliste troç, gjendja s'do të ndryshonte. Ma mirë t'i linte me mendimin se gjithçka shkonte mirë.

E ama kënaqej nga përgjigjet e së bijës dhe thoshte:

— Të paktën, ti u rregullove.

Dhe prapë e porosiste të bijën:

— Dëgjoje zonzjën, të keqen nana. Mos prish gojë me të. Ta kem mendjen të fjetun për ty. Ti e di si e kemi hallin.

I ati ndërhynte:

— Sanija asht vajzë e mendshme. Nuk na turponon.

Me gjithë mjerimin që i rrethonte, ato pak orë që kalonte në shtëpi të saj, ishin shumë të bukura për Sanijen! Të paktën, atje e donin, e përkëdnelnin. Fëmijët ma të vegjël e rrethonin, e tërhiqnin nga fustani, s'i shqiteshin nga dora. E pushtonte një ndjenjë e ambël lumtunie... Ajo do të kishte dashtë të mos largohej kurrë prej andej, të mos i shkelte ma asnjë herë kamba ke ajo shtëpi e huej, ku e ndjente veten të përbuzun, të poshtnueme, ku lodhej e kapitej aq shumë, tue ndigjue fyemje e shamje e kurrë një fjalë të mirë... Por e dinte se kjo ishte e pamundun... Shtëpisë do t'i shtohej edhe një gojë ma shumë...

Gjithë javën, kur e rrifshin, e shajsin, e përbuzshin, e mendojshin me njëmijë e një punë, që s'ishin për moshën e saj, ajo i jepte zemër vetes, duronte, se e kishte mendjen te orët që do të kalonte, ma në fund, me njerëzit e vet.

Kjo ishte kënaqësia e parë e Sanijes. Një këna-

qësi që s'mund t'ja ndalonin as Demir agai, as e shoqja, as e bija. Sanija kishte edhe një kënaqësi të dytë, shumë të madhe: librat. Por leximi i tyre ishte me rrezik të madh për të. Ajo i donte librat, sepse ata e fushnin në një botë të mahnitshme, ata e tërhiqshin aq tepër, saqë, po t'i thoshe a don një fustan e një palë këpucë të reja, që s'i kishte veshë kurrë, apo një libër, do të përgjigjej pa kurrfarë ngurrimi: një libër.

... Dhe libra s'kishte. Vajza e zonjës po. Gjithfarë librash të bukur, që Dylberja s'i hapte kurrë. Mërzia e Dylberes ish in librat. Ajo s'do t'i kishte prekë kurrë me dorë, po të mos ishte e detyrueme për punë të shkollës. Po, edhe atëhere, mbas dhjetë minutash i hidhte. Megjithëkëtë, s'e lente Sanijen t'i prekte. Kur e gjet një herë tue i shfletue, filloi të çirrej e të bërtiste si e çmendun.

Rendi hanko Xhevahirja. Pyeti të bijën pse bante gjithë atë shamatë. Dylberja tregoi Sanijen e i tha:

— Kjo zgjebarakja më mori librat.

Xhevahirja s'e çoi gjatë. Ja përveshi me pëllambë nja dy-tri herë shërbëtores së vogël e ju gërmush:

— Rri, moj dreq, rehat. Ku merr vesh ti nga librat! Dëgjo mirë, mos ja prek ma, se të piu e zez, të piu. Po të zuna edhe një herë, qërohesh këndej. More vesh?

Sanija s'bani za, po u largue tue fshi lotët...

Kjo kishte ngjamë disa muej ma parë. Që nga ajo ditë, shërbyesja e vogël s'ja kishte ngamë ma librat Dylberes, po kishte jetue me dëshirën e tyre në zemër... Sa keq që s'kishte të holla të blinte

të paktën një! Do të kishte zgjedhë atë ma të bukurin, si ai me kapak të trashë, që kishte Dylberja... Do ta kishte lexue me andje, mbramjeve atje në hashef, mbas punëve të mundimshme të ditës. E do ta kishte ndjemë veten të çlodhun, të kënaqun. Po ku t'i merrte parat? I ati dihej që s'kishte. Sa për zotnijtë, ata kurrë s'i kishin dhanë as edhe një çerek leku! E librat kushtojshin shtrenjtë! Duhej të mblidhte kushedi sa çerek leku, që të mund të blinte një! Dhe librat, për të, mbetën si një andërrim i mrekullueshëm, i paplotsueshëm, po gjithmonë i gjallë e i bukur...

3.

Nata ishte e qetë, me hanë të plotë. Ishte verë. Një verë e nxehtë, gjithë zagushi, si ato të Tiranës.

Sanija kishte ramë prej kohe të flinte në hashef, por nuk po e zinte gjumi. Bante tepër vapë. S'frynte fare. Gjethet e pemëve të oborrit as që pipëtinin.

Një qetësi e thellë, e plotë, sundonte anekand. Zotnijtë me vajzën flejshin prej kohe atje në konak. Ata kishin zakon me ranë shpejt. Mbas dëndeshin mirë e mirë, s'e zgjatshin po ja këputshin gjumit. Për të lexue ndonji libër, as që u shkante ndër mend.

Sanija u ngrit, duel nga hashefi në oborr. Karafilat e trandafilat lëshojshin një erë të rrallë. Lulet e mollëve dimnore zbardhëllojshin. Vajza qëndroi për ca kohë në kambë, e mahnitun. Çfarë bukurie, çfarë qetësie!...

Jeta ishte e bukur. Por jo për atë, jo për shoqet e saj. Ajo s'kishte asgja. Ja, asaj i qante zemra për një libër. Dylberja kishte sa të donte dhe as që i hapte. Kurse ajo, Sanija, s'mund t'i prekte as me dorë. E pra, sa do t'i pëlqente tashti të shkonte e të merrte ndonji libër, sidomos atë me kapak të trashë, të lexonte gjithë ato tregime të bukura, nën dritën e kandilit, deri në mëngjez! .

Me gjithë atë dëshirë të madhe që i vlonte në gj, Sanija e dinte se ishte punë me rrezik. Zotnajtë s'kishin mëshirë, s'dijshin ç'asht dhimsunia: të lejshin edhe pa atë kafshatë buke të njomun me lot e gjak. . . Por prapë diçka e shtynte të futej në sallon, në katin e poshtëm, të plotësonte atë dëshirë të pangopun. Dylberja s'do të ndigjonte. As edhe ata të tjerët. Ishte tepër vonë.

Qëndroi për një kohë të gjatë në dysheme. Ma në fund vendosi. Tue u përpjekë të mos bante zhurmë, tue mbajtë edhe frymën, hyni mbrendë, nga porta e mbrapme. Vuni veshin. Asgja. Mori zemër. U fut në sallon. Prapë asnji zhurmë. Priti edhe pak. Qetësi e thellë. Kapi nga rafti librin që ëndërronte aq shumë, ndërsa gjithë trupi i dridhej e zemra i rrihte me aq forcë, si të donte t'i shponte krahnorin. Ju duk se kërciti dera e dhomës së fjetjes së zotnijve, se u ndigjuen hapa nëpër shkallë. Mbeti e ngrime në vend. Tash do ta gjejshin, do ta pinte e zeza. . .

Sa e marrë ishte! Frikshej kot. Ata flejshin për shtatë palë qejfe, kurse ajo tmerrohej pa arësye. E lehtësueme, doli jashtë e shkoi në hashef. Vuni veshin, përgjoi. S'e kishte ndie kush. Sa mirë! Natën e kishte përpara. Do të kënaqej së lexuemi. Kështu do të bante çdo natë. Ata s'do ta merr-

shin vesh. Ditën do ta gjente rastin e çdo libër që merrte do ta vinte në vend.

Filloi të lexonte me et... U zhyt në faqet e librit. Harroi në ato çaste gjithçka: edhe mjerimin e saj. Sa kohë kaloi ashtu, në atë kënaqësi të veçantë?

Gjumi i ishte zhdukë fare. Patjetër do ta kishite zanë agimi sikur një za mos ta kishte pyetë rreptë:

—Ç'ban ashtu, moj qelbanike?

Qe diçka fare e papritun, bash atëherë kur ajo e kishte fjetë mendjen se askush s'e kishte diktue. U hodh përpjetë, si ta kishte pickue gjarpni. Me sy të zgurdulluem, vuni re, si nëpër mjegull, se te dera e hashefit qëndroshin, në rrobe nate, Demir agai me hanko Xhevahiren. Vështrimet e tyne dojshin ta përpijshin të gjallë.

Ajo s'ishte në gjendje me folë, me u shfajësue. Sikur i ishte ngrimë gjuha. Me vështirësi të madhe qëndronte në kambë.

Hanko Xhevahirja u suell nga i shoqi:

— E, t'u mbush mendja? Të kam thanë sa herë se s'asht hajri i saj!

Dhe pa i lanë kohë Demir agait të përgjigjej, u drejtue nga vajza:

— Po a nuk të kisha thanë, moj zgjebarake, se nuk duhet t'i prekësh librat me dorë? Oj, po të shkojshin në shkollë njerëz si ti, lum ne, pastaj! Hajt, vishu, këput qafën!...

— Zonjë!.. Zonjë!.. — belbëzoi Sanija.

— Ç'ke që të ngeci pështyma në fyt? Mos e zgjat, mblidh leckat dhe... nga kambët sytë!..

— Asht natë... zonjë!.. Prit deri nesër.

— Vetë e deshe. Ta kishe mendue ma parë. Do të dalësh vetë, apo të të nxjerr me shkelma?

Ajo ju afrue vajzës, e kapi për krahu, e shtyu. që ta hidhte me forcë jashtë. Hanko Xhevahirja ishte e fuqishme. Krahu i saj ishte ma i trashë se kamba e Sanijes. Por kjo, me fuqinë e dëshpërimit e të zemrimit, se ku e gjeti gjithë atë forcë sa të shkëputej nga zonja e ta shtynte, tue thirrë:

—Hiqi duert, dal vetë!

Hanko Xhevahirja ja dha britmës:

— Zgjebarake! Shih, më qëlloi, më qëlloi!

Demir agai ja preu:

— Mbylle, se do të tallet bota me ty! Asht natë!

Por Hanko Xhevahirja vazhdoi të bërtiste:

— Kape, kape zgjebaraken! Kape!

Sanija nxitoi, ashtu gjysmë e zhveshun, nga porta e jashtme, e kapërceu me shpejtësi dhe duel në rrugë... Filloi të ecte me nxitim në rrugët e shkreta, me grushtat e vegjël të shtrënguem, si të donte të qëllonte dikë, ndërsa lot të nxehtë vuajtjeje, zemërate, urrejtjeje rigonin nëpër mollëzat e saja të zbeta...

RRUGËVE TË LUFTËS

1

Çomja la shkopin e gjatë prapa asaj lase që ishte çarë, dhe ju ngjit me të shpejtë shkallëve të gurta të shtëpisë së tij. Diku u pengua, por e mori veten në çast dhe, pa bërë «oj», u gjend te hyrja. Siç e kishte zakon, ai shtyu me të dyja pëllëmbët e hapura derën, që kishte lëshuar bark, Po, për çudi, ajo nuk u çel. Balli dhe hunda ju përplasën në të dhe Çomja, i mbushur tërë inat, trokiti fort. Por ajo përsëri nuk u çel. Ai do të kishte thirrur me zë të lartë sikur atë kohë të mos kishte ndjerë se diku përreth, a ndoshta aty brenda, u ndërpre një muhabet i zjarrtë. Mbajti vesh. Asnjë zë s'ndihej, askush s'bëzante. Po mbase i bënë veshët, apo ndoshta ashtu ju duk, ndaj ja dha derës me grushtet e mbledhura. Ndërkohë nga brenda u dëgjuan zvaritje hapash, pastaj çapa më të shpejtë dhe llozi i hekurt që krisi. Dikush ja befi te dera, por dritë nuk kishte, andaj Çomja s'e njohu aty për aty njeriun që hapi derën. Ai bëri të çante përpara duke shtyrë me supet e varura.

— Ç'është, pse erdhe? — i tha një zë femre dhe e ndali.

Ishte e motra. Atë zë Çomja kushedi sa herë e kishte dëgjuar, kushedi sa herë e ndjente afër, kur bënte faj, por atë kohë s'e njohu. Ju duk ndryshe, fare ndryshe: i trashë, i vrazhdë dhe disi i frikshëm. Tjetër zë, fare tjetër ju duk Çomos ato çaste.

— Hë, ç'është? Pse erdhe, pse shtyhesh?! — i tha përsëri ai zë, duke kapërcyer prakun e derës së bashku me të.

— Do të hyj brenda, hë! — u përtyp ai, ashtu siç e kishte zakon kur vendoste në të tijën.

— Jo, të keqen motra, jo; kemi miq, ç'do bësh! Dhe e motra i kaloi gishtat nëpër kaçurrelat e rëna mbi ballë.

— Jo, jo, do të hyj, do të hyj!

Ai thërriste me buzët e varura, duke tundur ato supet e vogla, duke e shikuar motrën me kokën e lëshuar pak dhe me qepallat që i lëvizte vazhdimisht.

— E pse erdhe? — e pyeti përsëri e motra.

— Do të marr kapelen.

— Mirë, prit!

Kur e motra shpejtoi brenda, Çomja ndenji pak në fund të shkallëve, pastaj shkoi nga ana tjetër e shtëpisë. Vuri veshin të dëgjonte dhe përsëri ndjeu zhurmë. Ajo zhurmë bëhej brenda në shtëpi të tij, nga ajo dhoma e miqve dhe atë çast Çomja mendoi se njerëzit e ardhur si miq nuk kishin pse të pëshpërisnin aq ulët, ashtu... fshehur...

Në këto e sipër ai dëgjoi derën që u hap, dhe shpejtoi e doli në oborr.

—Eja, Çome, — i thirri e motra, — merre, ta qepa edhe yllin!

Ai e vuri kapelen në kokë, ndenji një çast,

mori shkopin dhe u nis për te kuajt, tej në livadhe.

Pastaj ra përsëri heshtja. Një heshtje e vogël e një nate të nxehtë gushti. Rrugëve të fshatit pothuaj s'ndihej këmbë njeriu, veç më të rrallë dëgjohej çapitja e ndonjë kafshe. Të të binte rruga në një natë të tillë në atë fshat, do të të dukej sikur njerëzit i kishin braktisur shtëpitë dhe sikur aty s'merrte frymë njeri i gjallë. Ndoshta se kishte shkuar vonë dhe fshatarët dremisnin, duke u shpirë nga tërë ajo lodhje.

Dhe pikërisht në një natë të tillë, tej, nga ana e fshatit, përmes një shtegu të verbër, u duk një siluetë e vogël, që kaloi një gardh dhe shpejtoi në një rrugicë.

2

Në atë dhomë të ulët të asaj shtëpie fshati ishin mbledhur shumë burra. Ata kishin kohë që po bisedonin dhe ai muhabet, herë i qetë e herë i rrëmbyer, vazhdonte ende, megjithëse nata po thyhej. Dhomën e ndiqonte një kandil, që përhapte shtëllunga të trasha tymi të zi. Burrat të gjithë thithnin kush çibuk e kush cigare të pleksura.

— Po mirë, edhe sa pushkë na duhen? — pyeti një burrë, që kishte zënë vend në krye të minderit, duke hequr thellë duhanin, që digjej në një çibuk të trashë.

— Unë s'kam, — tha dikush.

— As unë, — tha një tjetër.

—

—

— Epo kështu atëhere, ti Llukan merr ato tri

bombat që kam unë, — tha ai burri i hollë e i gjatë që ishte mbështetur atje te qoshja e dhomës.

— Edhe unë kam dy bomba, — foli një tjetër nga fundi.

— ... po i ndajmë kështu: disa pushkët, disa bombat, ë?

— Ashtu, ashtu! — thanë së bashku ca zëra.

— Mirë e ka, fjalë me vend.

— Ashtu, pooo, edhe unë e jap atë bombën time, e di ti, Xhoke.

Dikush pohoi me krye dhe me zë.

— Po mirë, or shokë, po...

Në atë çast të gjitha fytyrat u kthyen nga ai që po fliste i fundit. Mbase u kthyen se ai e la fjalën përgjysmë, nuk vazhdoi. Ai belbëzoi edhe diçka dhe heshti duke e ngurosur tërë shikimin, tërë qenjen e tij në krahun e djathtë, te dritarja e dhomës, në parvazin e së cilës po përgjonte diçka e strukur si silueta e një njeriu. Burri, që rrinte në krye të minderit, u soll në një mënyrë të tillë, që i ftonte të gjithë ata burra për të parë te ai. Te ai dhe jo gjetkë. Pastaj, duke belbëzuar diçka jash-të bisedës së zënë, shkroi në një copë letër:

«Çavo, në dritare nga e djthta dikush përgjon. Me kujdes, dil jashtë!» Dhe e shtyu letrën tej. Dorra-dorës ajo shkoi deri në dorë të atij që rrinte në fund të dhomës, te hyrja. Ndërsa të tjerët po vështronin atë që shkroi pusullën, burri që mori letrën hapi derën dhe shpejtoi jashtë. Hija e strukur në dritare filloi të lëvizte. Pas pak, ata që ishin brenda ndien zërin e Çavos që thirri: «Ç'bën aty?!» Pastaj panë hijen e vogël, që u shkëput nga hekurat e dritares dhe ra poshtë. Menjëherë dualën jashtë edhe disa të tjerë.

— Fëmijë? — tha i habitur burri që rrinte në krye.

— Do të jetë Çomja, vëllai i Çavos, shoku Dalan.

— Edhe? — pyeti ai që quhej Dalan.

— Është dreqi vetë! Edhe kur shkuam javën e parë për të çarmatosur postën, ai s'na u nda. «Do të vij edhe unë partizan», thoshte.

— Ashtu?

— Po.

— Sa vjeç është?

— Trembëdhjetë, shoku Dalan.

— Qenka i vogël. Pa silleni!

Njëri shpejtoi jashtë dhe pas pak të gjithë u dukën te dera me Çomen, që e kishin vënë përpara dhe s'dëgjonte të ecte.

— Po eja, djalë, eja! — i tha me të butë ai që rrinte në krye.

Djali vrëjti vetullat e rëna dhe s'bëri më tej. Ishte shpupurishur i tëri. Rufiti hundët, pastaj bëri më lart ato pantallonat e varura dhe ngjeshi më mirë në kokë kapelen e vjetër me yllin e kuq.

— Eja, pra, eja, ti je burrë! — i tha përsëri ai, duke qeshur.

Ai bëri ca çapa përpara.

— Pa na thuaj, po të drejtën, ama, pse hiqe në dritare?

Dhe burri qeshi përsëri. Çomja s'bëzante. Shih-te përdhe duke lëvizur majën e këmbës së djathtë.

Burri u ngrit, i shkoi pranë, i hodhi njëren dorë në sup dhe e afroi edhe më pranë vetes.

— Hajt, thuaj, mos u tremb, ti je partizan; thuaj pse hiqe në dritare?

Çomja gati sa s'po qante. Ashtu i ishte bërë fytyra.

— Do të flasësh? — e pyeti përsëri ai.

Çomja shkoi llërën e dorës nën hundë dhe, si e vështroi mirë e mirë burrin që po e pyeste, pëshpëriti:

— Mua më kanë thënë që edhe ai Tili nga Gjoshi ka dalë partizan, hë!

Shoku Dalan shikoi përçark, ndërsa njëri foli:

— Po, Tili është i madh!

— Poo, po unë e kam mundur Tilin vjet kur ishte me qe këtej!

Në dhomë u shkreh një gaz i madh.

— Po tani e mund dot? — e pyeti përsëri po ai burrë.

— Tani? Tani jo.

— Pse?!

— Po tani ai është bërë partizan.

Përsëri u përtëri gazi.

— Po le të jetë bërë partizan.

— Po partizanët nuk munden.

Të qeshura të forta.

— Po ti, pse do të bëhesh partizan?

— Unë?.. Që të vrasim ata fashistët, ballistët, ata që do të luftoni ju nesër.

— Shë-ë-ët, ku e di ti?

Burrat panë shoqi shoqin.

— Po unë i dëgjova në dritare.

Një çast u bë heshtje. Çomja, sikur të kishte marrë forcë nga diçka, tha përsëri:

— Po të bëhem partizan, do t'ja tregoj qejfin atij djalit të beut, që na branit ashtu, kur na shkejin kuajt në barërat e tij.

Kur tha kështu, Çomja u duk fare fëmijë. Edhe vetë e ndjeu këtë.

- Po të fshehtën e di ta ruash ti, Çome?
 — Di posi,
 — Mirë. Atëhere të japim fjalën se vitin tjetër, si të rritesh edhe ca, do të të marin partizan, kështu?
 — Pse nuk më merrni tani?
 — Të thashë, vitin tjetër; ja erdhi viti.
 Çomja nuk foli.
 — Veç mos zër në gojë asgjë nga këto që bisedove këtu, ë?
 — Jo, s'i tregoj kujt, po ju merrmëni tani partizan!
 — Ti e sheh që sonte s'marrim asnjë të vogël. Vitin tjetër. E di vetë ti, vitin tjetër Çomja do të bëhet partizan. Kështu? Hajt pra, natën e mirë!
 — Vdekje fashizmit! — tha Çomja.
 — Liri popullit! — pëshpëritën ata, duke shikuar përsëri njëritjetrin, me një gaz që u shkri shpejt.

3

Natë. Një natë vere e qetë. Herë pas here veriu i lehtë shpupurishte kaçurrelat e rëna të Çomes dhe bënte të pëshpëritnin degët e pemëve. Errësira kishte shtrirë kudo ngjyrat e zeza dhe drurët ngjanin si qenje të gjalla, që diç belbëzonin, diç flisnin, diç mendonin, diç kurdisnin. Kështu i dukej Çomes. Ndihej ndonjëherë ndonjë zog nate, që kalonte rrëmbimthi dhe ndonjë shqetësim i vogël i ndonjë trumcaku, që dremiste në degën përbri folesë.

Ai ecte vetëm, krejt i vetëm. Kaloi në një rru-

gicë të ngushtë, kaloi vijën e ujit që gurgullonte heshtur, duke humbur nëpër ferra, kapërceu gjer-dhe dhe traga të fshehta, për të arritur deri në ato ara të korrura ndanë livadheve, ku kullosnin dy kuaj, ai i tij dhe ai i Janit. Aty do të gjente Janin, shokun e tij më të afërt. Ecte shpejt, duke u munduar të përfytyronte veten të veshur ashtu, me atë kapelen me yllin e kuq. «A t'i them Janit? — mendonte. — ...Po, unë duhet t'i them... E kush m'i ka mësuar mua tërë këto? Jani është shoku im më i ngushtë, ai... Po ai burri që rrinte në krye të dhomës, te minderi, më porositi që të ruaj të fshehtë... Patjetër që ai do të ishte ndonjë komandant... a komisar... Pse, ashtu janë komandantët e partizanëve?! Po komisarët?! Po ai s'kishte yll në ballë?! Po ata burrat e fshatit të gjithë partizanë do të dalin nesër?..

Po yjet ku i kanë, po kapelet? Jo, Jani më ka thënë se partizanët ndodhen kudo; ata vishen edhe si italianë, edhe si gjermanë... A t'i them Janit?.. Po si më tha ai komandanti mua? Si mund të bëhem partizan, po s'dita ta ruaj të fshehtë?! Atëhere?!.. Po ato që më tregon Jani, a s'janë të fshehta?.. Si?! Të fshehtë s'duhet t'ja them askujt? Askujt?!»

Përreth nata solli zilkat e kuajve. Çomja u kujtua që kishte mbërritur, andaj ndali dhe i thirri Janit. Por askush s'përgjigjej. I thirri përsëri pak më fort. Asnjë përgjigje. Veç zilkat e kuajve u ndalën. Duket se kafshët, që po kullosnin diku aty afër, ndien zërin e njohur të Çomes dhe ngri-tën kryet me veshët e qullosur për të parë të zonë.

— O Ja-a-ni! — thirri ai fort.

Ishte e kotë. Askush s'përgjigjej. Kuajt fi-

lluan të gjëmtonin dhe zilkat përsëri filluan këngën e tyre të çrregullt. Ata hidhnin çapet e pengua dhe Çomja e ndjeu si thyheshin kallamat e holla të grurit të korrur. «Akoma të mos ketë ardhur ky?! — përsëriti me vete dhe bëri për te kuajt. I pa nga afër, u hoqi samarët dhe shkoi aty ku kishin lënë velenxat. «Kaq shumë të vonohet?! — tha përsëri ulët. — Ku ka shkuar, vallë?!... Po, edhe herë të tjera ka ardhur vonë! Ku shkon vallë? Në shtëpi?.. Unë erdha qëparë dhe ai s'ish-te këtu. Tani...»

Ndali. Befas në trup i shkuan të dridhura dhe zemra e njomë i kërceu me të shpejtë. Dikush po shpejtonte drejt tij.

— Jani! — thirri ai. Po ajo thirrje ishte aq e dobët, saqë Çomes ju duk sikur s'u shkëput fare nga buzët, sikur s'u shqiptua.

— Come! — thirri edhe ai që shpejtonte.

— Jani, erdhe, Jani!

Shoku u ndal duke dihatur. Ishte i alarmuar. Kishte përpara duarve një pushkë të shkurtër dhe një trastë, që e mbante me kujdes.

— Hë, ç'është? — i foli përsëri Çomja i tronditur, ngaqë shoku i tij ndjehej aq i alarmuar.

— Eja, eja shpejt! — i tha ai dhe e kapi për dore.

— Ua! Dyfek?!

— Eja, eja!

Ata po i ngjiteshin një ledhi. Ecën nja njëqind metra dhe ndalën në krye të një kodre të vogël, që ngrihej si tumbë, majë atyre gropave.

— E di si është puna? — tha Jani duke vërejtur përreth me kujdes. — Unë do të dal partizan.

— Si kështu? Po unë? A s'thamë se do të shkojmë së bashku? Ti sonte...

— Ashtu, o Çome, ashtu, po unë duhet të iki që tani.

— Po pse? Ç'ka ndodhur? Ku e gjete dyfekun?

— Hiç, vetëm se unë vendosa të iki që sonte. Një s'ke frikë, më përcill deri tej në Lirishte.

— Si të kem frikë?

Ata u nisën përsëri në një udhë pa udhë. Ecnin herë krah njëri tjetrit e herë njëri pas tjetrit. Ecnin dhe flisnin. Flisnin ulët, aq sa të dëgjohej vetëm midis tyre.

— E di ç'i bëri agai nënës sime? E gjeti grua, plakë, pa njeri dhe e shtyu nga shkallët. Nëna ime ende lëngon...

— Dhe vendose të ikësh që sonte? — i tha Çomja.

— Po.

— Po ku do të vesh?

— Partizan, de.

— Po ku do t'i gjesh partizanët?

— Lart, në mal.

— Po dyfekun ku e gjete?

— Ka kohë. Kam edhe fishekë, edhe shtatë bomba.

— Ashtu?!

— Nuk e sheh trastën!

— Po me se do të luftosh?

— Si të jetë rasti, edhe me dyfek, edhe me bomba.

— Po partizanët mund të luftojnë vetëm me dyfek ose vetëm me bomba.

— Kur nuk ka shoku, atëhere i ndajnë.

Ata bisedonin dhe ecnin me ngut. Pengohe-

shin nëpër gropa, griseshin nëpër gjemba, por nuk ndaleshin. Ecnin me të shpejtë.

— Çome, tani do të ndahemi, kthehu, — i tha Jani shokut dhe ndali, duke i mbështetur pëllëmbën në sup.

— Jo, po unë, unë... Ku do t'i gjesh ti partizanët?

— Sonte do të udhëtoj. Nesër ditë gdhahet, nesër do t'i gjej.

— Ata ndodhen kudo, apo jo? — pyeti Çomja.

— Po, kudo.

Çomja heshti një hop, vari kryet, pastaj belbëzoi:

— Unë e di ku janë sonte partizanët.

— Ç'thua?!

Ata u afruan edhe më pranë njëri tjetrit. Dukeshin si një trup i vetëm. U çapitën më tej dhe, të ulur buzë një shpelle, që shihte përballë, nga malet, biseduan një kohë të gjatë.

— Pastaj u çuan dhe u puthën fort-fort.

— Jani, në shtëpinë tonë ka një pushkë, — tha Çomja.

— Jo, Çome, jo. Ajo i duhet Çavos nesër. Me se do të luftojë ai? Ti do të marrësh pushkën time. Unë do të luftoj me bomba.

Çomja mbështeti faqen në kondakun e armës dhe e hodhi krahqafë.

Ishte ai çasti i paharruar në jetë, kur atyre dy njomëzakëve po u bënte zë jeta, kur ata vogëlushë po i betoheshin atdheut se do t'i dilnin zot.

Ishin dy vogëlushë që i rriti atdheu para kohe. Ja, atë natë, ata të dy morën rrugën e atdheut për t'u ndeshur me shushunjat. Janë dy çunakë. Njërin e quajnë Jani tjetrin e thërresin Çome. I pari është katërmbëdhjetë vjeç, i dyti trembëdhjetë. I pari ka mbushur një trastë me bomba, i dyti ka hedhur dyfekun e gjatë në krah. Dhe ecin. Nga lart i sodisin yjet e ndezura dhe hëna që rrëshqet qetë-qetë.

Pse shndrisin aq shumë ato yje? Që t'u bëjnë në dritë partizanëve të vegjël? Po pse i dredhin ashtu qerpikët ato yje? Mos çuditen me moshën e tyre?! Pse e ndali fluturimin hëna? Që të qeshet me dy çunakë, të cilët nisen për luftë?

Kishte shkuar vonë. Ata ecnin njëri para, tjetri pas dhe, sikur t'i kishin thënë të gjitha, flisnin rrallë. Secili ndiqte një monolog të vetin, secilit i përhihej diçka. Ishin larguar shumë nga ata dy kuaj, që shkonin për t'i kullotur çdo natë në verë, megjithatë zilet ende s'u ndaheshin. Ato u dilnin përpara, ato u tringëllinin afër. Jani sillte para syve një zjarr të madh, të madh, që ngjitej qiellit. Sillte aganë e xhindosur, sillte... Çomja mudohej të përfytyronte agimin, Gjobarin, kalanë, partizanët, luftën e nesërme dhe... A do ta pranonin partizanët? E pse të mos e pranonin? A s'ishin partizanë ata? Ç'bënin partizanët? Luftonin? Po këta, a s'do të luftonin?

Lufta! Të luftosh për atdheun? Ja, kjo i bëka njerëzit partizanë. Po këta nuk do të luftonin për atdheun? ... Që janë të vegjël? Po ç'rëndësi ka, kur dinë të shkrepin pushkën?

— Jani!

— Fole gjë, Çome?

— Po, ndal!

— Hë!

— E provojmë një herë dyfekun. A di ta shkrep unë? Unë s'kam qëlluar kurrë.

— Ulu! Bjere këtu! Veç do ta shkrepësh pa fishek, ë?

— E kuptoj.

Ata u ulën të dy. Dhe jepnin e merrnin me atë dyfek, që lidhej te një rryp i vjetër. Jani mendohej t'i shpjegonte shokut se si mbahej pushka. Herë binte njëri barkas e herë tjetri. Pastaj çoheshin më këmbë. Duhej të mësonin të shtinin edhe pa u ulur. Se kushedi si e hasnin armikun.

Zunë përsëri udhë. E ç'udhë! Ku kishte udhë aty të kalonin ata? Ajo ishte një rrugë e pashkelur, rrugë gjembash, ferrash, rrugë monopatesh.

— Jani, kur është ora një pas mesit të natës? — e prishi heshtjen Çomja.

— Ora një? Po ja aty pas mesit të natës, — tha shoku.

— Kur del Ylli i Mëngjezit?

— Jo, atëhere zbardh.

— Atëhere do ta bëjmë luftën ne?

— Po.

Heshtje.

Poshtë, përfund rrugës nëpër të cilën ecnin, ishte pllatitur një errësirë e ftohtë, ndërsa lart gjithkund dritë yjesh që digjeshin.

— Sa yje! Ë Jani?

— Plot.

— Shih, shih, si ecën hëna, ë?

.....

— I ke numëruar ndonjëherë yjet ti, Jani?

— Nuk i kam numëruar dot.

Pastaj nuk folën më. Dëgjoheshin çapet e tyre dhe zhurmat e natës.

— Sa kohë do të bëjmë luftë ne, o Jani? — e cungoi përsëri heshtjen Çomja.

— Pse, u lodhe ti?

— Jo, jo, po them. Kur thua ti se do të çlirohet atdheu?

— Kur të zhduken të gjithë fashistët italianë dhe ballistët, kur të zhduken edhe ata nazistët gjermanë, se kanë ardhur edhe gjermanë te ne.

— Po pastaj, si do të jemi?

— Të lirë.

— Po i biri i agait do të jetë i lirë?

— Jo, ai do të jetë i vdekur.

— Kush do ta vdesi?

— Unë.

— Edhe unë.

— Të dy.

— Mbase e vret ndonjë partizan tjetër.

— Mundet.

E ndalën përsëri bisedën. U dilnin përpara shpella, gorrica të vogla, driza, gjemba dhe ato i pengonin të ecnin të qetë. Qëndruan në buzë të një gremine. Poshtë ishte një shesh i madh me shpella në mes. Më tej ishte lumi. Lumi kalohej te një urë e vogël prej druri. Aty duhej të kalonin ata burrat e fshatit të tyre dhe ai komandanti, kur do të shkonin për të luftuar në kalanë e Gjobarit, kundër nazistëve dhe ballistëve.

— E dëgjon lumin, Jani?

— E dëgjoj.

— Nga ura do të kalojmë?

— Nga ura, po ata këtu, thua, do të zbresin?

— Me siguri që këtu. Ishin gjithë ata burra të fshatit. Ai i huaji, ai si komandant, u tha se do të takonin partizanët te rrepet, në hyrje të Gjobarit. Nga do të kalojnë? Këtej. Bile ai i pyeti: «Ura a është në rregull?» «Po», i thanë ata. Kësh-tu që këtej do të kalojnë.

— Po, këtej duhet të vijmë.

— Do t'i presim këtu?

— Si thua ti?

— Unë them të vemi mu atje, afër kalasë, ku do të bëhet lufta, se mos nuk na pranojnë.

— Mirë thua.

— U afrua koha, thua? — pyeti Çomja.

Jani pa lart.

— Po, në të afruar është, ashtu duket.

— Zbresim këtej?

— Andej do të zbresim.

— Këndeje s'ndihet asnjë zile kafshe.

— Epo i mbajnë pranë fshatit kafshët, o Çome.

Ata zbrisnin poshtë asaj buze, nëpër ca gër-xhe. Duket se Jani i njihte më mirë ato vende. Ai printe përpara. Ecin ngadalë, pa u ndjerë. Tani s'ndihej asnjë zhurmë tjetër, veç zhaurimës mo-notone të lumit, që kishte pushtuar gjithçka. Zbri-tën poshtë në shesh dhe dolën te rruga që të çonte në atë urën e shkatërruar. E kishin shpej-tuar edhe më hapin. Rrugën e shihnin mirë dhe përpara s'i pengonte asgjë. Të dy çapiteshin, si-kur i kishte topitur gjumi, ashtu në këmbë, duke ecur. «Sa mirë! — mendonte Çomja. — Kur të munden fashistët dhe ballistët, ne do të kemi dy-feqe plot. Pastaj do të mbajmë edhe dyfeqe, edhe

bomba... Se ja, t'u bllokua dyfeku, atëhere ç'të
bësh?... Atje është luftë... Në luftë...»

Ndërsa Jani përtypte të tjera mendime: «Ne
do të fshihemi mirë e mirë aty përmbi xhami, te
ata qiparisat, dhe do të nisim luftën, sa t'ja filloj-
në partizanët Kur të mbarojë lufta, do të bashko-
hemi me ta. Më mirë! Atëhere do të na pranojnë
edhe ne të dy, do të jemi partizanë. Partizanë!
Pastaj...»

Befas, tek po hynin në urë për të kaluar tej,
u ndie zhurmë.

— Çome, ndalu, shë-ë-t! — thirri ngadalë
Jani, duke u shkëputur nga ato mendime dhe ra
në gjunjë.

— Edhe unë e dëgjova, edhe unë, — pëshpë-
riti Çomja.

— Ç'të jenë?

— Do të jenë burrat e fshatit dhe ai koman-
danti partizan.

— Ashtu thua?

— Ka shkuar ora një pas mesnate?

— Shë-ë-ët! Nuk e di.

Tej urës dëgjohej zhurmë. Ajo zhurmë nuk
ikte tej, por qëndronte aty. Dhe ishin shumë që
bisedonin.

— Eja këtu, ngjitu, ngjitu pas meje! — pësh-
përiste Çomja dhe bëri nga e djathta, duke ju
ngjitur një kodre të vogël.

— Zëre pak dyfekun, Jani!

— Shë-ë-ët. Nëma... mbahu!... Ecë!

— Dëgjohen më?

— Çome, mos thirr! Eja të përgjojmë!

Ata ju ngjitën atij bregu që e mbante urën
nën vete, dhe bënë më tej, për te një shpellë, që
lartohej te hyrja e urës.

— Ja, ja, i dëgjon? — tha Çomja.

— Ngadalë, ngadalë!

— Mirë.

Ata flisnin ulët dhe zëri i tyre dilte i dredhur. Shpeshherë Çomja s'kaptonte as atë kom të imët të grykës.

Ju kacavjerrën asaj shpelle që ndodhej për-bri kodrës, dhe dolën pothuaj përmbi hyrjen e urës. Dhe heshtnin për të kapur ndonjë zhurmë.

— T'i vëmë fishek? — pëshpëriti Çomja.

— Shë-ë-ët!

— Se s'janë ata më duket!

Ishin nja pesëmbëdhjetë vetë. Erdhën deri te mesi i urës dhe ndalën. Dukej sikur ndalën për të dëgjuar gurgullimën e ujrave të lumit, që përplase-shin me gjëmë te këmbët e urës. Shquanin vetëm hijet e tyre. Dalëngadalë filluan të shquanin edhe lëvizjet e duarve.

— Mos folë hiç! — i pëshpëriti në vesh Jani shokut.

Ishin mbledhur galiç dhe heshtnin.

Heshtnin.

— Erdhi ora më duket, — tha njëri nga ata që ishin poshtë, përmbi urë.

— Do edhe gjysmë ore, — i tha një tjetër.

— Ti, Azem, merr edhe Rehan, Rulin, Mufitin dhe Çilen e priti te hyrja! Kështu, si e biseduam... Kur të hyjnë, atëhere... Të tjerët ejani me mua.

Dhe, si bënë këtë bisedë, ato hije u shpërndanë, një pjesë këtej urës, një pjesë matanë.

Jani dhe Çomja, ngadalë, u tërhoqën nga ana tjetër e majës së shpellës.

— E kupton, Çome? — i pëshpëriti Jani.

— E, ata s'ishin fshatarët, po...

— Ata s'ishin as partizanë. Nuk e kupton?! Ata duan të presin burrat e fshatit me atë komandantin partizan, që t'i vrasin papritur këtu te ura.

Çomja ishte hutuar ca. Ai nuk e priste kështu luftën. As që ishte në gjëndje ta kuptonte mirë ç'po ndodhte ato çaste. U mbështet pranë Janit dhe i tha:

— C'do të bëjmë?

— Unë them se burrat e fshatit ende s'kanë kaluar.

— Si të bëjmë?

— Ata do të vijnë tani për të kaluar këtu dhe... ti e sheh se ç'i pret. Unë them që një nga ne të shpejtojë rrugës për në fshat. Përpara do të gjejë ata dhe t'i lajmërojë për pritën. Ne tani jemi partizanë dhe partizanët s'tremben. Ë?

— Vete unë.

— Atëhere shpejto! Ua thuaj të gjitha! Unë po qëndroj këtu.

— Vetëm?

— Partizanët s'tremben.

— Mirë, ika. Vdekje fashizmit!

— Liri popullit! Lëre pushkën!

— Pa pushkë?

— Të pengon, ti duhet të shpejtosh, Çome. Duhet të shpejtosh shumë. Nxirri edhe shollët.

Ashtu bëri Çomja. Hoqi shollët dhe zbriti nga shpella shpejt e shpejt e pa u ndjerë. Jani nxori nga trasta bombat dhe i rreshtoi aty përpara, te një monopati i vogël i shpellës, që i qëndronte si parvaz.

Sapo kishte zbritur Çomja nga shpella, kur, nja dyqind metra larg urës, në drejtim të fshatit,

u ndien këmbë. Jani e mori me mend se ata do të ishin fshatarët e tij me atë komandantin partizan në krye. Dhe e mori me mend se Çomja s'do t'i arrinte dot. Andaj ndjeu dridhma. U shqetësua. Ç'të bënte? Çfarë bëjnë partizanët në çaste të tilla? Si veprojnë ata? A nuk ishte edhe Jani një partizan? Ai rrëmbeu dy bomba dhe njërën e afroi te dhëmbët, gati për t'i hequr rripin. Priti dhe pak. Nëqoftëse këmbët, që vinin poshtë, drejt urës, nuk do të ndalnin, nuk do të merrnin drejtim tjetër, kjo do të thoshte se Çomja nuk kishte arritur. Atëhere duhej vepruar për të shpëtuar shokët. Mbajti vesh përsëri. Zhurma e këmbëve të partizanit të vogël dhe të fshatarëve të tij po varej poshtë. Ai dridhej i tëri. Gjoksi dhe zemra e vogël i kërcente papushim. Pra, ata ende ecin të qetë. Jani shikoi poshtë, tek ishin strukur ato hije, dhe në një çast rrëmbeu në dhëmbë atë bisht rripi që varej nga bomba, mbylli sytë, e tërhoqi rripin fort dhe e flaku bombën tek ishin fshehur ata që kishin zënë pusi.

U ngrit një flakë e madhe dhe një plasje shurdhuese shpërtheu asaj lugine. Pastaj hodhi bombën tjetër, një tjetër, një tjetër. . . Nga poshtë u dëgjuan pushkë. Ca hije njerëzish shpejtonin të çorientuar përmbi urë dhe tej urës, në një brinjë, që ngjitej lart! Pastaj u ndez një luftë, që vazhdoi disa orë. Jani kishte marrë pushkën që kishte lënë Çomja, dhe qëllonte në drejtim të atyre që ende s'po e linin urën. E ndjeu se në krah të tij luftonin burrat e fshatit me atë komandantin partizan. E sëmblonte në zemër fati i Çomes, por nuk kishte kohë të mendonte gjatë, sepse, sa dallonte një grimcë flake nga dilte e shtëna e atyre që ende s'dëgjonin ta linin urën, drejtonte pushkën e tij dhe shtinte.

Së fundi pushkët e ballistëve sikur reshtën. Dita kishte zbardhur dhe ai dalloi disa nga ata që ishin shtrirë mu në mes të urës, njëri në të dalë dhe dy të tjerë kishin rënë pranë njëri tjetrit. Priti pak dhe pushkë s'u ndien hiç. Ai pa si po ngriheshin ca nga ca fshatarët, që kishin rrethuar urën dhe bëheshin bashkë, duke pëshpëritur nëpër dhëmbë.

* * *

Kishte zbardhur rare. Yjet në qiell ishin shuar dhe hëna s'kishte mundur të kaptonte prapa malit, tej, në perëndim. Zogjtë këndonin me një çuçurimë tërë potere nëpër degët e rrepeve, duke e përzier këngën e tyre me atë gllu-gllu të ujrave të lumit, të cilat dukeshin sikur e kishin humbur fuqinë nga zhurmët e dritës. Po. Burrat e fshatit ishin ata. Edhe ai partizani që kishte ardhur në fshat. U çuan të gjithë. U grumbulluan sipër te sheshi i urës. Aty, midis tyre, ishin edhe ata të dy, Jani dhe Çomja.

— Pa ejani ju, vogëlushë, — u tha komandanti partizan.

Jani dhe Çomja u afruan kokulur.

Komandanti u qëndroi në mes dhe, duke ua hedhur duart në supe, i pyeti:

— Ç'ju solli ju këtu, që të na shpëtoni ne?

— Ne donim të dilnim partizanë, — tha Jani.

— Edhe unë, — u hodh e tha Çomja.

— Po kush e nisi luftën, o partizanë?

— Çomja erdhi t'u lajmëronte për pritën, por

unë e kuptova se ishte vonë, ndaj qëllova me bomba, — tha Jani.

— Po e dini, o burra, që të gjithë ne e kemi jetën nga këta dy partizanë trima? — u foli komandanti fshatarëve.

Jani bëri çipin e buzës në gaz dhe shikoi Çomen. Edhe Çomes i vezulloi fytyra.

— Për besë, or ti shoku komandant, këta janë trima të vërtetë.

— Ne duam të vijmë partizanë, — tha Çomja.

— Po, duam të dalim partizanë, — tha edhe Jani.

Komandanti u ul, i përqafoi të dy dhe, duke i puthur, u pëshpëriste:

— Ju jeni partizanë, partizanë.

Të gjithë burrat e fshatit, që ishin aty, përqaftuan dy djelmoshat dhe së bashku me ta u nisën për t'u takuar me çetën partizane, që i priste të rripet në hyrje të Gjobarit.

XHA GOXHUA

— Merr dy shokë me vete dhe çoja pushkën xha Goxhos. Jemi përtej lumit. — tha komisari. Dhe iku.

Çeta «Plakë» do të bënte një aksion në anën e përtejme. Prapa, në mal, duke u përleshur me armiqtë, ra shoku ynë. Atje e varrosëm. Rreth e rreth i vumë ca gurë. Dikush hodhi atje pranë edhe ca kalamidhe. Dhe ikëm. Ç'të bënim? Në vend të shokut tonë po i çonim xha Goxhos pushkën e tij. Edhe ecnim sikur shkelnim mbi zjarr. Kur arritëm në shtëpi të shokut tonë, xha Goxhua sa kishte zbërthyer qetë nga parmenda.

— Je lodhur, xha Goxho, — i thamë. Dhe u përqaftuam.

— Jo për vete, o djem. Se unë i kam nja katër pesë cangadhe sa për vete dhe për plakën, — tha ai. — Dhe do bëjmë si të bëjmë. Po duan bukë djemtë e popullit, që roptohen malit për lirinë. Shkojmë brenda.

Dhe na shikoi një nga një, sikur donte të na peshonte. «Këta janë tre, po pse kanë katër pushkë?» mendoi xha Goxhua. Diçka i ra në erë. Ngriti kokën lart dhe hyri brenda. Ne shkuam pas tij.

Një nga ne të tre, që mbante pushkën e të rënit, sa hyri në dhomën ku na çoi xha Goxhua, kërkoi nëpër mur gozhdën ku varen pushkët. Se nëpër malet tona, sa mbaron së ndërtuari shtëpia, ngulin edhe gozhdët ku duhet të varen pushkët. Ai e gjeti dhe e vari njëren nga pushkët. Tjetrën e mbajti dhe shkoi u ul bashkë me të tjerët. «Pse e bëri këtë», mendoi xha Goxhua. Dhe ndezi çibukun.

Ishim të rinj dhe e kishim vështirë t'ja thoshin xha Goxhos. Kurse ai thithte çibukun dhe shikonte nga pushka e varur në mur. «E kujt është kjo pushkë?» mendonte ai. Tymi i çibukut nuk e mbulonte dot pamjen e tij. Ai dukej përpara nesh si një shkëmb madhështor, që e kishin rrahur erërat dhe shtrëngatat, dhe ai qëndronte. Pa frikë mund të pështetesh tek zemra e tij.

— T'ju bëjmë pak bukë? — tha ai dhe u ngrit.

— Jo. Nxitojmë, — i thashë. Dhe heshta. Kurse ai shikoi nga pushka e varur në mur. Dhe në mes dhëmbëve vendosi prapë çibukun. «Pse e varën në mur atë pushkë?» mendonte.

— Për ku nxitoni? — pyeti.

— Përtej lumit, — i thashë.

Megjithatë, nuk po luanim vendit. Kurse xha Goxhua diçka kërkonte me sy nëpër trupin e pushkës. Ndali sytë në një shenjë. «Ajo është», — tha me vete. — Po pse e varën aty? Mos im bir ka. . .» Thithi çibukun dhe picërroi sytë. Kurse ne e shikonim dhe s'dinim ç't'i thoshim. Nuk ishte gjë e lehte. Fëmijë tjetër nuk kishin. Pleq ishin. Nuk ishte gjë e lehtë.

— Hë, mor djem, do hani gjë, apo jo? — pyeti.

— Nxitojmë, — thashë.

Aj thithi çibukun dhe shikoi nga pushka e varur në mur.

— Po ajo e kujt është? Mos prisni ndonjë shok? — pyeti dhe mori frymë thellë si deti.

Mua m'u zu në grykë.

— Është e një shoku që mbeti në mal, — kaq munda t'i thosha. Kurse ai shikoi nga pushka. Dhe thithi çibukun.

— Më duket e tim biri kjo pushkë, — tha.

Ne nuk ju përgjegjëm. Në atë çast tymi i çibukut na dukej si një mjegull e dendur, që kërkonte të mbulonte xha Goxhon. Pastaj ai u rrit pranë nesh si një mal i lartë.

— Është e shokut tonë, e djalit tuaj, që ra në përlëshje, — tha njëri nga ne. Dhe heshtëm. Në zemrat tona bëhej luftë. Po xha Goxhua sundoi nabi të gjithë. Ai u ngrit më këmbë dhe eci drejt pushkës.

— Po pse e varët në mur? — pyeti. — Kjo është marrë jo për të zbukuruar faqet e mureve, po për të zbardhur faqet e burrave, — tha ai. Ne nuk ju përgjegjëm. Vetëm shtrëngonim pushkët.

— Kush ju tha ta sillni? — pyeti.

— Komisari, — ju përgjegja unë.

— Po ai ç'u bë? — tha xha Goxhua.

— U hodh përtej lumit në çetën «Plakë», — i thashë unë. Dhe u ngritëm të iknim. Ishte vonë. Xha Goxhua kishte marrë pushkën në dorë dhe sikur e përkëdhelte. Pastaj e hodhi në sup me rrëmbim.

— Shkojmë, djema, — tha. — Po vij dhe unë me ju. — Diçka i tha plakës dhe mori udhë i pari. Ne ecëm pas tij.

E ËMA E SEJFUDINIT

Kishin mbetur edhe disa shtëpi pa u djegur përposh, te lumi në Kuç. Në një rrinde komanda e vendit. Tjetra përkundruall, si një barakë e vogël, me dy të ndara, ishte depo dhe vend mjekimi.

Në një shesh të vogël, afër këtyre dy shtëpive, mbledheshin pleqtë e fshatit e kuvendonin për punët e Luftës me gjermanë. Në qershor, shtabi i Brigadës së Gjashtë, nga Ramica e Vlorës kishte ardhur në Kuç. Batalionet ishin në pozicione e gjermanët, përkëtej Kallarosit e Bolenës, në asnjë anë s'kishin hyrë.

Nga lufta e djeshme dy të plagosur të batalionit të katërt ishin shtrirë mbi një derë të vjetër, që infermieri i brigadës e kishte bërë si krevat në një anë të barakës së vogël.

Njëri nga këta kishte dy plagë. Tjetri një, po të rëndë. Partizanët tregonin se që të dy kishin luftuar me trimëri. Në pozicionet e Bolenës gjermanët qenë thyer tri herë.

Qe hapur fjala se qe vrarë edhe komandanti i batalionit të dytë, Sejfidini.

Burrat jashtë flisnin për të dhe kishin zënë e tregonin historira të trimërisë së tij dhe e lëvdonin. Lebërit trimin e lëvdojnë dhe e duan shumë.

Të gjithëve u erdhi keq dhe ngandonjëherë e prisnin bisedën

— Ja kam patur frikën, — tha një partizan, — se atij nuk ja bënte tërt veshi. Kur e këshillonim, ai na përgjigjej:

— E sos kemi dalë për të kërcyer...

— Ç't'i thoshim?

— Ai i jepte zemër edhe më të humburit, — tha një kuçot.

Po shtabi i brigadës s'e dinte si gjë të vërtetë këtë lajm. Korierët e batalionit, që sillnin postën, nuk kishin ardhur akoma.

Se kush e hapi këtë lajm, hajde gjeje në një fshat si Kuçi, që është aq i hapur. E kur u hap menjëherë në të katër anët!

Në pasdreke lufta filloi prapë në Bolenë e Kallarë.

Gjermanët rrahën me artileri e pastaj sulmuan.

Familjet kuçote, me ç'kishin, atë mëngjez ikën në pyjet e mëdha, ku është zor të futesh, jo të të gjejnë. Po kuçotët e njohin, se janë të vendit, e tok me partizanët muarën armë, municion dhe ushqime për t'i fshehur.

Ata lanë plaçka të shtëpisë pa marrë, po armë e municione nuk lanë.

Edhe ne partizanët e depos, si e boshatisëm, dualëm te sheshi të thoshim ndonjë fjalë me ata pak pleq të Kuçit që kishin mbetur, e të bënim nga një cigare, se na qe çarë hunda. Dhe kur je i lodhur, cigarja sikur ta heq lodhjen.

Tek po dridhnim cigaren, një kuçot u ngrit me të shpejtë. Ne s'muarëm vesh pse.

— E ëma e Sejfundinit, — na tha.

Ne s'i kishim vënë veshin se kush vinte nga ana e udhës së bregut; vështronim tej, nga vinte zëri i luftës, nga hidhnin shenja gjermanët.

Ne që s'e njihnim nënën e Sejfundinit, posa na tha ai kuçoti, e vështruam në sy të gjithë. U ngritëm. I dhamë dorën.

Ishte një grua e fortë, e veshur me çitjane të zeza e një libade që i puthisej mirë në trup. Mbi shaminë e hollë të kokës kishte një tjetër të zezë të madhe e të qendisur me ibrishime të zeza anës. E kishte hedhur në kokë si shall e i binte gjer mbi supe.

U pyetëm me të, po s'i thamë gjë. Lajmi do t'i kishte vajtur edhe asaj. Ne vështronim njëri tjetrin me bisht të syrit dhe merrnim frymë ngadalë. Po dhe ajo s'na tha gjë.

Mori kutinë e duhanit që i dhamë e po bënte cigare.

Në këtë kohë, partizani që rrinte në central të telefonit, doli me të shpejtë te sheshi dhe thirri:

— S'është gjë ajo e Sejfundinit.

Të gjithëve na qeshi fytyra, po s'arritëm të thoshim gjë, se e ëma e Sejfundinit posa dëgjoji, u drejtua:

— E do të vdis si deli burrë, zemëro, e jo nga ethet... Po pjella është e dhemshur, jeto, prandaj erdha t'ju pyes e t'ju shoh edhe juve, se edhe ju jeni djem të nënave.

Dhe na tregoi pastaj se si e kishte rritur jetim

Sejfudinin dhe se si kishte vuajtur si grua pa burrë që kishte mbetur prej kohësh.

Në Kallarat e Bolenë vazhdonte lufta dhe ne, bashkë me nënën e Sejfudinit, ja morëm këngës:

*Kurvelesh, o gur i thatë,
trima burrat, trime gratë...*

ÇELËSI I DEPOS

Komandanti i çetës partizane qeshi, kur dëgjo i kërkesën e Çlirimit, dhe ju përgjegj:

— Për këtë gjë drejtohu te komisari. Ai është përgjegjës për depon e armatimit.

Çlirimi shkoi te komisari dhe, me ton serioz, i shtroi kërkesën:

— Shoku komisar, dua të më pajisni me pushkë, fishekë e bomba dore! Komandanti më tha se ju përgjigjeni për depon e armatimit.

Fytyra e komisarit mori një shprehje tjetër. Sytë i shndritën dhe në buzë ju ndeh një e qeshur. Po pse? Cili ishte shkaku? Çlirimi kishte ardhur në çetë mbrëmjen e kaluar. Komandanti dhe komisari nuk kishin dashur ta pranonin meqë ishte i vogël, por ai kishte ngulur këmbë. Partizanët e kishin përkrahur. «Është djalë i shkathët dhe i zgjuar. Unë e njoh mirë, sepse është nga fshati im. Ma lini mua të kujdesem për të!» — ishte hedhur xha Abazi, partizani më i vjetër i çetës.

Tani ishte partizan dhe partizanët pajisen me armë e municion. A nuk ishte e drejtë kërkesa e tij? Atëhere pse qeshnin? . .

Komisari, kur pa se fytyra e djaloshit u vrëjt, i foli:

— Ashtu është, Çlirim. Por e di si qëndron puna? Mua më ka humbur çelësi i depos së armatimit! Them se për disa ditë do ta gjejmë dhe çdo gjë do të rregullohet. Ki durim! Gjatë kësaj kohe mundohu me xha Abazin të mësosh përdorimin e pushkës.

— Po unë e di se si merret shenjimi dhe si hiqet këmbëza!

— S'mjafton vetëm kaq. Mëso zberthimin, mbërthimin, mënyrën e pastrimit, mbushjen me shpejtësi, gradimin e largësisë... Mos u mërzi, për disa ditë besoj se do ta gjejmë çelësin. Më kupton?

— Siurdhëron, shoku komisar!

Çlirimi mori drejtqëndrim, nderoi me grusht dhe u largua për te xha Abazi. Në fillim sikur dyshoi në fjalët e komisarit. Si ishte e mundur që ai komisar që udhëhiqte gjithë ata partizanë, të humbte çelësin që i qe besuar?! Por fjalët e ngroh-ta dhe mënyra se si e shikonte komisarit e bënë të besonte.

Lindja ishte përskuqur, po dielli akoma nuk e kishte nxjerrë syrin mbi mal. Flladi i freskët i mëngjezit dhe vesa që kishte rënë pas mesnate, të bënë të ndjeje të ftohtë. Dëgjohej shushurima e Shkumbinit plak që rridhte si gjithnjë nën hijen e rrepeve.

Që larg u dëgjua një uturimë e lehtë dhe pastaj, në krye të rrugës që gjarpëronte, u dukën dy maqina.

— Po vijnë! — u dëgjua zëri i një partizani.

— Kujdes, shokë! I lini të afrohen mirë. Vetëm pasi të kenë hyrë në pritë, do të hapim zjarr. Të mos shtjerë asnjë pa u dhënë sinjali! Kujdes fishkët, se i kemi të pakët; asnjë fishek dëm!. — komandanti po jepte udhëzimet e fundit para fillimit të betejës.

Në gjoksin e Çlirimit të vogël rrihte me forcë dëshira e hakmarrjes. Kjo ishte beteja e parë që do të shihte me sytë e tij. Rrinte pranë xha Abazit dhe s'ishte i qetë:

— Si nuk e gjeti komisari çelësin akoma?!

— Mos u mërzi, se sot ka për ta gjetur patjetër, bile së shpejti, pas disa orësh! — Xha Abazi, ashtu si gjithnjë në ditët e përlëshjeve me armikun, ishte në qejf.

Maqinat u afruan. Pushkët, të etura për hakmarrje, u drejtuan.

— Zjarr! — u dëgjua zëri i komandantit dhe në çast u zbraz një breshëri pushkësh.

Beteja u ndez.

Me të vërtetë xha Abazi s'ishte gënjyer. Komisari, siç duket, e kishte gjetur çelësin e depos së armatimit, sepse, pas betejës, thirri Çlirimin:

— Tani mund të zgjedhësh. Depua u hap!

Çlirimi hodhi sytë nga armët dhe u çudit: ato ishin armët që i kishin rrëmbyer armikut në betejën që sapo ishte zhvilluar.

— Ç' depo është kjo? Këto janë armët e armikut.

— Pikërisht armatimi i armikut dhe municioni i tij përbëjnë depon tonë! — ju përgjegj komisari duke i treguar kështu një «sekret».

— Po çelësi... çelësi?. Ju sikur thatë se kishit humbur çelësin!

— Dhe e gjetëm sot të gjithë së bashku! E gjetëm dhe e hapëm depon! — Komisari qeshte me gjithë zemër.

— E kuptova! — foli Çlirimi si i turpëruar. Beteja qenka çelësi i depos.

— Pikërisht ashtu. Tani zgjidh!

Dhe Çlirimi zgjodhi një pushkë që ishte më e vogël, dhe ngjeshi gjerdanin me fishekë. Tani ishte partizan i vërtetë.

XHEMAL SKUTA

Kur i vdiq i ati, Xhemal Skuta ishte pesë vjeç. Edhe tri të motrat, nuk ishin të mëdha: Manushaqja, që ishte barku i parë i fëmijëve, nuk ishte më shumë se dhjetë vjeçe. Nga kjo ngjarje e hidhur Xhemali mbante mend vetëm çastet e varrimit dhe të gjyshen që i kishte thënë:

— Merr edhe ti një dorë dhé e hidhja tyt eti, or bir!

Dhe Xhemali kishte bërë siç i kishte thënë gjyshja e siç kishin bërë të gjithë ata që kishin qenë në varrimin e të jatit.

E ëma e Xhemalit, Havaja, nuse e re tridhjetë e dy-tre vjeçe në atë kohë, kishte lidhur një shammi të zezë gjer mbi vetulla dhe kishte përveshur krahët të rriste katër jetimët dhe të mbante të vjehrën, plakë shtatëdhjetë e ca vjeçe, që kishte zënë këndin. Tokën që kishte patur me të tretë, dhe qetë ua mori agai dhe ua dha të tjerëve, se tani s'kishte kush ta punonte. Ajo punoi vjete me radhë nëpër dyert e botës për 25 kile misër në muaj. Me ah e me vah i rriti ata katër fëmijë.

Por ajo nuk harronte kurrë edhe ndihmën që

i kishte dhënë fshati, sepse me njëzet e pesë kile misër në muaj nuk mbahen gjashtë frymë, e sidomos katër fëmijë, që duan t'i kenë copat tërë ditën në dorë. Njëzet e pesë kileve në muaj, erë t'u marrësh, nuk dalin. Sa herë që binte lëmi i grurit ose i mistrit, Ziko Çopelja, Rrapo Metani e të tjerë, bëhej s'bëhej bereqeti, do të hiqnin që në lëmë, kush pesë kile, kush dhjetë, do t'ja vinin një njeriu të shtëpisë në krah në një trastë e do t'i thoshin:

— Shpjere këtë grurë (ose misër, ç'të ishte) te ata jetimët e së mjerës Hava.

Çupat Havaja i martoi njëzën pas tjetrës, pa mbaruar së rrituri, dhe Xhemalin, pa mbushur ende dhjetë vjeç, e pajtoi te Qerim agai bari me dhi.

Kur u bë Xhemali i pjekur e kur e mjera Hava shpresonte të shihte një ditë të bardhë, ajo ra e vdiq. Dhe vdekja i erdhi, jo pse ishte plakur, por nga të zezat që kishte hequr. E shkreta Hava, nuk pa hair nga djali, po edhe Xhemalin e theri, sepse s'kishte ku të mbështetej e kush t'i mbante hapur shtëpinë. Prandaj, sa mbushi të njëzet vjeçët, u martua.

Qysh se ishte bërë në mentë e tij, Xhemal Skuta, duke kujtuar ç'kishte hequr e ç'po hiqte, i bënte gjithmonë këtë pyetje vetes:

— Si do të vejë ky halli i fukarasë?!

Dhe jeta i përgjigjej:

— Keq e më keq!

Sepse me të vërtetë keq e më keq po shkonin punët për të e për gjithë ata që ishin të varfër si ai. Si u martua, Xhemalit ju shtuan hallet edhe më shumë. Që motin e parë të martesës i lindi një

djalë, të dytin një vajzë. Krye tetë vjetëve martese u bë me katër fëmijë. Kishte një gojë për të ushqyer, tani gjashtë gojë. Punonte e robëtohej në atë çikë tokë që kishte të tijën dhe duke punuar hyzmeqar më dyert e botës — pa mbushur tridhjetë vjetët i kishin dalë shpatullat nga puna — por prokopi nuk po bënte. Sa kohë që mbretëroi Ahmet Zogu, ai nuk ngriti kokë kurrë. Mot për mot hiqte të zitë e ullirit për bukë. Kushedi sa net fëmijët e tij kishin fjetur pa ngrënë. Erdhi edhe fashizmi italian, po jeta e tij nuk ndryshoi aspak. Veçse keqsohej çdo ditë e më shumë.

Porse kohët e fundit, pyetjes: «Si do të vejë ky halli i fukarasë?!» që tani ja bënte më dendur vetes, Xhemali i jepte një përgjegje tjetër.

Në skrapar ishte formuar një çetë partizane. Çeta shkonte fshat më fshat dhe i thoshte popullit: «Duhet të luftojmë fashizmin. Pas lufte do të kemi një qeveri të popullit». Gjer atëhere çeta kishte bërë disa aksione kundër milicëve dhe karabinierëve italianë e kishte dalë kurdoherë faqebardhë. Që në takimin e parë me çetën, me anën e një kunatit të tij, Xhemalit i qe ngrohur zemra. Komisari i çetës qenkej një xhevahir djalë, që nuk lodhej kurrë, të fjaloste shtruar, këmbëkryq e çdo gjë ta shpjegonte fije e për pe: «Do të luftojmë kështu, do të bëhet kjo, do të çlirojmë Shqipërinë, do të kemi qeverinë tonë që të mendojë për popullin, kemi partinë tonë që na udhëheq...» e shumë e shumë gjëra të tjera.

Nga të gjitha këto, Xhemal Skutës i qe mbushur mendja atëhere, gjer në një farë pike, se, ose do ta shpëtonte popullin kjo parti, ose nuk kishte për të shpëtuar kurrë. Prandaj, kur e kishte

thirrur çeta në aksionet e saj, ai s'pati përtuar, po pati marrë atë malherin e tij të çarkut, që e kishte gjetur pas Luftës italo-greke, dhe pati luftuar për vdekje kundër fashistëve.

* * *

Një natë, aty nga fundi i dhjetorit të vitit 1942, e shoqja e Xhemalit, Shanikua, një grua me trup të pakët dhe e tukequr, pasi shtroi sofrën pranë vatrës, ku kishte vënë një tas me rehani e nga një copëz bukë për secilin, u tha fëmijëve dhe të shoqit:

— Afrohuni të hamë dy kafshata bukë.

Xhemali, që ishte pështetur në këndit e pinte duhan i mbytur në mendime, herën e parë nuk dëgjoi, po kur e thirri e shoqja për së dyti, u ngrit e shkoi në fund të shtëpisë për të larë duart. Të tre fëmijët e mëdhenj: Syrjai, Bajamja dhe Selvia, siç ishin duke lozur me misrishte në mes të vatrës, e lanë edhe ata lojën dhe u mbështuallën të gjithë rreth sofrës. Në këndin tjetër mbeti vetëm Cukja, lidhur në djep, me këmbët të kthyer nga zjarri.

Kur mbaruan së ngrëni, dikush trokiti në derë.

— Kush do të jetë, vallë, ky që ka dalë jashtë në këtë qamet? — mendoi Xhemali dhe u ngrit e hapi derën.

I pari hyri Canja i Rrapos me jakën e gunës hedhur në kokë, mbuluar me dëborë fund e krye. Pas tij hynë edhe dy partizanë të çetës së Skraparit.

— Urdhëroni, urdhëroni, — u tha Xhemali me gjithë zemër të dy partizanëve. që i njohu se cilët ishin. U puth buzë për buzë me ta dhe u shtruan pranë zjarrit.

Edhe Syrjai, Selvia e Bajamja i njohën e thanë me vete të gëzuar:

— Sa mirë që na erdhën, qenka Ramizi me Qakon!

Gjithë shtëpia tani dukej sikur kishte shpëtuar nga ndonjë ankth i madh.

Pasi u ngrohën pak, Xhemali ja bëri me shenjë së shoqes që t'u shtronte darkën partizanëve. Ajo u ngrit, mblodhi në magjet ato kafshata që kishin lënë nga darka e tyre për t'u rregulluar të nesërmen, ndërtoi një tas rehani, u kuqi edhe dy vezë e ua vuri partizanëve përpara duke u thënë:

— Urdhëroni, po... — dhe me atë «po» të lënë përgjysmë deshi t'u thoshte: «Na falni, se kjo na u ndodh».

Partizanëve nuk u pat qëlluar kurrë që në shtëpinë e Xhemal Skutës t'u shtrohej kaq pak bukë. E kuptuan se patjetër do t'i ishte mbaruar bereqeti, pasi këtë hall ua kishte treguar Xhemali që më parë, se ai, mot për mot nuk bënte veçse tre-katër muaj bukë në tokën e tij. Prandaj nxuarën një copë misërnike nja dykilëshe, gjoja se do ta hanin vetë, bënë sikur muarën nga dy tri kafshata dhe e lanë në sofër.

Kur ishin shtruar në sofër partizanët, Canja ju qas në vesh Xhemalit dhe e pyeti:

— Të qenka mbaruar bereqeti, o Xhemal?

— E, or të shkretën.

— Po pse s'më ke thënë?

— Epo... ç'të të thosha! Mos ke edhe ti e do
«ë ma prisje këtë litar që kam në grykë!

— Kam s'kam, atë që më ndodhet do ta ndaj-
më, siç më ke huajtur e të kam huajtur për mot.

— Unë nuk do t'i kisha prurë te ti sot, —
vazhdoi Canja sikur kishte bërë ndonjë faj, — po
komisari tha vetë: «Do vete nga Xhemali ta takoj,
se më ka marrë malli, këtu le të rrinë këta shokët
e tjerë». I la shokët atje, ca te unë, ca te shokët e
tjerë, e vetë mori edhe Qakon e erdhi te ti. Të do
shumë, vallahi, «është trim», thotë për ty. Të ka
vënë veshin kur ke luftuar ato nja tri a katër herë
në aksione, dhe thotë: «Xhemali i ka shokët të
rrallë».

Sa bënë Xhemali me Canen këto bisedime,
partizanët patën mbaruar bukën.

Ramizi i tregoi Xhemalit se kishte marrë pesë
shokë të çetës me vete dhe se do të futej në Berat,
ku do të qëndronte dhjetë ditë ose dy javë për ca
punë shumë të rëndësishme dhe shumë të ngut-
shme. Prandaj ishte nisur edhe nëpër këtë kiamet
dimri të madh.

Pastaj i foli për luftën, për aksionet, për si-
tuatën në përgjithësi dhe, si zakonisht, ashtu ven-
çe, siç i thoshte gjithmonë, ja përsëriti edhe atë
natë:

— Jona do të bëhet, or Xhemal, jona. Vdiq
fashizmi, iku, ta puthi dorën. Së shpejti do të kemi
pushtetin tonë, do të rrojmë të lirë...

Dhe Xhemali, duke dëgjuar, qeshte i kënaqur,
pastaj i tha komisarit:

— Do ta fitojmë si një e një që bëjnë dy,
shoku Ramiz.

Komisari qeshi me gjithë zemër dhe atë çast

ju kujtuan edhe një herë fjalët që i kishte mësuar partia, se populli ynë është trim, ai do të na ndjeki po t'i mësojmë të vërtetën. Ne do t'i japim dritën, lirinë, do t'i japim pushtetin në duart e tij. Populli do të ketë besim te ne dhe ne duhet të kemi besim te ai. Populli ynë është patriot, ai nuk do t'u trembet sakrificeve, ai do ta ndajë kafshatën e fundit të bukës me ne, do ta heqë këmishën nga trupi i tij e do të na e japë ne ta veshim. Dhe ja, fjalët e partisë i kishin dalë të vërteta që ditën që kishte filluar të luftonin për popullin.

* * *

Të nesërmen që në mëngjez, Qerim agai, me një shkop në dorë, ngrehur-ngrehur siç shkonte zakonisht, doli nga shtëpia me brucën krahëve. çau përmes fshatit dhe shkoi drejt e në shtëpinë e Xhemalit.

— O Xhemal, o Xhemal! — i thirri që përjashta.

— Urdhëro! — ju përgjegj Xhemali dhe doli në oborr duke e zënë derën.

— Ke njeri në shtëpi?

— Jo, s'kam njeri.

Qerimi priti t'i thoshte Xhemali «urdhëro brenda», po Xhemali nuk ja zgjati dhe ai tha me vete: «Diç ka në këtë mes. Nuk paskemi dyshuar kot».

— Hajde e ndezim nga një duhan, hajde, — e ftoi agai Xhemalin.

Xhemali dhe Qerimi u ulën të dy mbi ca gurë të mëdhenj përpara derës së oborrit, pasi hoqën dëborën, dhe ndezën nga një cigare.

Pas pak kaloi aty një kushëriri i Xhemalit.

— Qerim aga, — tha ai si i çuditur, — ç'ke dalë kaq shpejt zotrote? Ne që jemi hallexhinj e na nxjerr halli përjashta, përtojmë të dalim në këtë qamet, po zotrote ç'të keqe ke?

— Jo, mo, po mërzhitet njeriu.

— Mirë, mirë, — tha ai dhe iku me një sopatë në dorë, tutje nëpër ara.

Qerimi po përtypej dhe nuk dinte nga ta niste bisedën. Në fillim po i binte larg e larg. I tha Xhemalit se si kishte takuar javën e kaluar me të birin në Berat, Selimin, që e kishte kapiten milicie, se si kishte rënë fjala atje, në kafene, për luftën, ku ishin edhe disa oficerë të tjerë...

Xhemali e kuptonte se të gjitha këto ishin profka, prandaj po priste ku do t'ja nxirrte tymin dhe nuk ja ushqente muhabetin, që ta detyronte t'i binte më shkurt. Më në fund Qerimi i tha Xhemalit.

— A shkruhesh milic, o Xhemal! Ti je keq për bukë, një vatër fëmijë ke, ndonjë gjë të shesësh, që t'ja dalësh me bukë këtë faqe moti, nuk ke. Pastaj është jetë kjo dhe duhet siguruar. Shkruhu milic, se një rrogë të mirë e merr, miell të bardhë merr. Jetën e siguron jo për një vit, por për gjithnjë. Këtë duam ne, ç'duam tjetër?

Edhe kjo fjalë nuk qe qëllimi i vërtetë i ardhjes së Qerim agait te Xhemali, se e dinte ai fare mirë se me kë fliste, por prapsëprapë Xhemali e kuptoi se këto nuk ja tha pa ndonjë qëllim agai, prandaj ja preu shkurt:

— Nga fshati ynë kemi një ne në milici; kemi Selimin tënd, mjaft është ai një herë dorë për dorë. Ai është kapiten dhe vlen sa për njëqind si

ne. Le të shohim një herë ku do ta sosi ai yt bir, pa për ne të tjerët ka kohë, shohim e bëjmë.

Qerim agai i kuptoi këta thumba të Xhemalit, qeshi nën buzë si me djallësi, përdrodhi mustaqet, që sa kishin zënë t'i zbardheshin, dhe tha:

— Ke të drejtë, ke të drejtë, janë kohë të turbullta këto dhe njeriut nuk i duhet të përzihet shumë në këto kohë.

— Jo, unë nuk ta kam fjalën atje.

— Or po të them me gjithë mend që ti ke të drejtë.

Xhemali qeshi.

— Ti merre si të duash, po unë nuk ta kam fjalën atje ku thua ti.

Më në fund Qerimi e nxori në shesh qëllimin pse kishte vajtur.

— Mbrëmë natën nga kjo mëhalla juaj kanë lehur shumë qentë, — ju drejtua Xhemalit.

— Me të vërtetë, edhe unë i ndjeva, isha në gjumë në atë kohë dhe më ngjau sikur që afruar egërsira.

— Jo, jo, ata lihnin më njeri, nuk lihnin më ujk.

— Kushedi, mundet, po mua, ashtu nëpër gjumë siç isha, m'u duk sikur lihnin më egërsirë, — ja preu Xhemali.

— Dëgjo, Xhemal, unë jam i vjetër, jam i rrahur me vaj e me uthull, në këto kohë të turbullta nuk duhet të përzihet njeriu, se e pëson, shkon si qeni në vresht. Të dua pa të them, se je rritur me bukën time. Edhe ai im bir nuk bën mirë që përzihet.

— Pse m'i thua këto, Qerim aga?

— Jo... po... ja, ti e di që çeta partizane ka

kohë që po vërtitet këtej dhe kam frikë se mos gënjejesh, se janë djaj ata që kanë dalë, të hedhin sibirin. Nuk e hamë dot ne me një mbretëri dyzet milionë. Unë dëgjoja edhe djalin kur fjalosej me ata oficerët e tjerë në kafene. Këta që kanë dalë janë çunakë. Janë një gjë pa kokë. Këta të marrin në qafë.

— Hasmi është hasëm, o Qerim aga, dërrit dajo nuk mund t'i thuash kurrë, — tha Xhemali.

Si biseduan edhe një copë herë, Qerim agai u ngrit e iku. Rrugës po mendohej:

«Xhemali nuk është pa gjë sot. Në shtëpi nuk më futi. U thamë së ftohti atje në dëborë, përjashta, dhe nuk i bëri goja të thoshte «urdhëro e vemi brenda» I thashë, për t'i parë mendjen, të shkruhet milic dhe u duk ashiqare si mejton. Për qentë që u çanë së lehuri mbrëmë, u mundua ta humbiste gjurmën fare: «lihnin më uj» tha. Kanë të drejtë që thonë se është lidhur me partizanët e që e kanë zgjedhur edhe si të parë të fshatit në këshill... Jo, jo, nuk është pa gjë ai. Edhe sot, unë shpohem në hundë, po nuk i pati partizanët brenda në shtëpi. Pati të drejtë marshalli që më tha: «Shko heto ku fjetën partizanët mbrëmë, se unë kam informata të sigurta që në fshatin tuaj ha bukë çeta partizane dhe se ata sot janë këtu...»

Patën të drejtë edhe ata tre karabinierët që qenë roje mbrëmë, kur thanë se kishin parë të hynin katër a pesë vetë me guna në lagjen e Skutajve».

Me këto mendime shkoi me një frymë në shtëpi dhe ja tregoi një për një ç'kishte biseduar me Xhemalin e ç'mendonte ai vetë, marshallit të

karabinierisë, që qe gdhirë te ai atë natë bashkë me dhjetë karabinierë.

Marshalli i karabinierisë, një burrë i shkurtër e trashalug, duke shkuar tutje e tëhu, me hapa të gjata, sa në njërin cep të dhomës në tjetrin, e dëgjoi gjer në fund Qerim aganë, pastaj ju drejtua karabinierëve:

— Nisuni dhe do të veproni ashtu siç e bëmë planin pak përpara.

Xhemali, me t'u ndarë nga Qerimi, shkoi e fjalosi me komisarin për bisedimin që kishte pasur.

— Duhet të hapim sytë, — tha komisar, që i dinte mirë lidhjet që kishte Qerim agai me fashistët. — Ai do të lajmërojë patjetër postën e karabinierisë, prandaj të marrim masa. Më përpara na duhet një njeri që të shikojë ç'do të bëhet në shtëpinë e Qerim agait, të ruajë kush do të hyjë e do të dalë atje. Por veç duhet shpejt dhe njeriu të jetë i sigurtë të mos bjerë në sy.

Pa mbaruar mirë fjalën komisar, u hodh Syrjai:

— Vete unë, shoku Ramiz.

Komisari e vështroi një herë plot sytë, sikur të donte të hetonte sa besim mund të kishte te ai pionier, që ju duk i përshtatshëm për një rast të tillë.

— Mos ki merak, — përsëriti Syrjai, — vete unë dhe të shikosh po nuk të prura lajme të sigurta.

Komisari u mendua një çast dhe i tha:

— Mirë, shko.

Pastaj e porositi si të vepronte. Në këtë kohë ai lajmëroi edhe shokët e tjerë të çetës që të vinin në shtëpinë e Xhemalit.

Nuk vonoi shumë dhe Syrjai erdhi duke nxi-tuar, përpëliste sytë dhe sa me duar me gojë i tregonte komisarit:

— Nga shtëpia e Qerim agait dualën dhjetë xhandarë. Dy shkuan nga rruga e mullirit...

— Kanë shkuar në postë të lajmërojnë, — ja preu fjalën Xhemali të birit, duke ju drejtuar komisarit.

— Dhe tetë të tjerë shkuan lart, nga bregu i Qeshteve, — vazhdoi pionieri, duke treguar me dorë nga dritarja e shtëpisë një breg përkundruall lagjes së Skutajve, prej nga e kishte tërë la-gjen nën vete. — Mbrëmë marshalli me gjithë karabinierët kanë qenë për darkë te Qerim agai... Mua nuk më pa hiç njeri... — fliste shpejt e shpejt Syrjai.

Fjala se lagja e Skutajve u rrethua nga kara-binierët u përhap sakaq. Nga të dhjetë shtëpitë e lagjes u nisën e vajtën te Xhemali nga një burrë për derë, për të vendosur se si do të bëhej që të nxirrnin partizanët nga rrethimi.

Komisari, partizanët dhe fshatarët e lagjes së Skutajve po bisedonin se ç'duhej bërë.

— Të veprojmë shpejt, sa pa u ardhur ndih-ma, — u tha komisarit të pesë partizanëve që kishte me vete, — dhe detyra jonë në këtë rast nuk është vetëm të dalim nga rrethimi, po t'u ja-pim edhe një mësim të mirë karabinierëve. Megji-thëse jemi nisur për gjetiu me ngutje e megjithë-se jemi në rrugë e sipër, unë them që të mos e humbasim rastin. Ata janë tetë ose dhjetë, ne jemi pesë, por mjaft jemi. Si thoni, shokë?

Xhemali, që gjer atëhere vetëm kishte dë-gjuar, ju drejtua Ramizit si me një vështrim qor-tues;

— Mos thuaj: «jemi pesë», shoku komisar, — dhe shikoi rreth e përçark, duke vështruar në sy Canen e Rrapon e tetë a nëndë fshatarë të tjerë, sikur t'i pyeste me atë vështrim: «A fola mirë, o shokë?» Dhe prapë vazhdoi: — por thuaj: «Jemi njëzet, shoku komisar, «jemi sa frymë është lagjja e Skutajve me burra, me gra e me fëmijë, sa frymë është gjithë fshati ynë fundi i fundit, veç ndonjërit, si Qerim agai me shokë. Prandaj hesapet bëji edhe me ne.

— Mirë e the, Xhemal, ashtu është! — ja pri-tën shtatë a tetë zëra me një gojë.

— Atëhere unë them që të veprojmë kështu, — vazhdoi komisari, — ne duhet të dalim përroit e përroit dhe të hidhemi përtej, te ai bregu i madh, përkundruall bregut të Qeshteve. Vetëm këtij krahu është vendi i mbuluar dhe s'na ha plumbi. Që nga ai breg ne mund të bëjmë lëvizje e t'u marrim krahët karabinierëve dhe, në vend që të na rrethojnë, t'i rrethojmë ne ata. Përpara se të dalim nga shtëpia, duhen tre veta që t'u marrin krahët karabinierëve, kështuqë, po të na pikasin dhe të na bien, ata tre veta t'ua këpusin më përpara, që prapa krahëve, dhe t'ua bëjmë mendjen çorbë. Kjo është detyra më e rëndësishme...

Komisari fliste me gëzim, sikur nuk ishte i rrethuar, por sikur pregatiste një rrethim, ku e kishte fitoren të sigurtë.

Komisari, Xhemali e të tjerë bënë shpejt e shpejt planin si do të dilnin nga rrethimi të pesë partizanët dhe barrën më të madhe e mori vetë Xhemali me Canen e Rrapos e dy shokë të tjerë të lagjes. Ata shkuan dhe zunë Bregun e Gurëzave, prapa krahëve të karabinierëve. Kur

dualën në majë të bregut, Xhemali hipi mbi një gur të madh, siç e kishin lënë me fjalë me komisararin, dhe tundi një shami të kuqe. Me të parë she-njën, Ramizi, me të pesë shokët, i udhëhequr nga Syrjai dhe dy fshatarë të tjerë, dualën nga shtëpia, dhe, duke kaluar ledh më ledh, mur më mur, e kopsht më kopsht, pa rënë fare në sy të karabinierëve, arritën te përroi dhe qenë gati të hynin atje, ku nuk do të kishin asnjë rrezik. Kur befas karabinierët i pikasën dhe u thirrën tri herë:

— Ndal! Ndal! Ndal!

Dhe pastaj u kthyen pushkët. Por, pa bërë mirë «bamb» pushkët e tyre, Xhemali, vetë i katërti, ua këputi që prapa me një batare. Njëri prej karabinierëve u ngrit një herë më këmbë prapa një guri, ku kishte zënë pritë, pastaj ra më kurriz, sikur t'i kishe prerë kokën, e nuk lëvizi më.

— Ëh, qen, ëh, qen, atë që kërkove e gjete!
— shkroftiu Xhemali dhe shpejt e shpejt i ktheu llozin pushkës, i futi një fishek tjetër në gojë dhe shtiu përsëri.

Lufta u ndez. Partizanët e kaluan vendin ku u zbuluan pa asnjë dëm. Pas një çerek ore, ata ishin jashtë çdo rreziku. Plani i Ramizit, që t'u bënte një rrethim, nuk u realizua, sepse karabinierët, duke pasur një të vrarë e dy të plagosur që në goditjen e parë, nuk rezistuan më, por ua mbathën këmbëve dhe e mbajtën frymën në postën e karabinierisë.

Partizanët, Xhemali dhe shokët e tjerë nga lagjja e Skutajve, pas tërheqjes së karabinierëve, u grumbulluan të gjithë në një vend. Përpara se të ndaheshin, Xhemali i tha komisarit:

— Shoku Ramiz, më shkruaj një letër për çetën.

Komisari e vështroi në sy me një mënyrë që tregonte se ai nuk po e kuptonte pse e donte Xhemali atë letër.

— Më jep një letër për në çetë, — tha përsëri Xhemali. — Tani një rrugë kam unë, atë që kam menduar me kohë: të bashkohem me partizanët.

Duke u kthyer për në shtëpi, Xhemali bisedoi me Canen e Rrapos e me të tjerët: ai do të hiqte fëmijët dhe gruan nga shtëpia, do të hiqte edhe atë çikë plaçkë që kishte, do t'i vinte kyçin shtëpisë dhe do të hidhej në çetën partizane bashkë me djalin e madh Syrjanë. Këtë punë do ta bënte që atë ditë dhe sa pa ardhur nga qeveria që t'i internonin fëmijët, siç ua kishin internuar edhe të tjerëve, që kishin dalë partizanë. «Kur të vijnë nga qeveria dhe ta shtrëngojnë lagjen për të marrë vesh kush ishte me partizanët, ku hëngrën, ku fjetën... ju ngarkomini mua të gjitha», u tha Xhemali shokëve të lagjes.

Kjo mund të na shpëtojë sa për këtë radhë, o Xhemal, — tha Canja i Rrapos, — porse shpëtimi ynë është kur të bëjë shumica nga ne këtë gjë që po bën ti, e kur t'i kemi çfarosur këta qena fashistë nga vatani. Dhe këtë që po bën ti sot, të gjithë do ta bëjmë me radhë.

Xhemal Skuta që partizani i parë nga fshati i tij që u hodh vullnetar me çetën e Skraparit. Pas tij u hodhën edhe dhjetra të tjerë, njëri pas tjetrit, kaq sa, kur u çlirua Shqipëria, nga fshati i Xhemalit ishin dyzet partizanë në radhët e Ushtrisë nacionalçlirimtare.

Duke luftuar bamp këtu e bamp këtje, Xhemal Skutës ju mbush mendja top se, ose do ta shpëtonte popullin tonë nga vuajtjet partia e tij, ose nuk kishte për të shpëtuar kurrë. Prandaj, gjer ditën e fundit të lirit, ai s'e lëshoi pushkën nga dora.

VAJZA TRIME

Skuadra pushonte nën hijen e një panje dhe priste të kthehej komandanti nga shtabi. Një nga partizanët shqiti një fletë nga fletorja dhe shënoi: «Mendoj t'i propozojmë skuadërkomandantit që në këtë luftim të mos e marrim Feten».

Letra kaloi dorë më dorë. Vetëm partizanja e vogël nuk e këndoi. Të gjithë e pëlqyen mendimin e Sulos. I fundit e lexoi Zeqiri, skuadërkomandanti, që sapo kishte ardhur.

Si t'ja bënte? A t'i dëgjonte shokët? E kush guxonte t'ja zinte në gojë atë fjalë pionieres!

«Duhet t'i dëgjoj! Shokët kanë të drejtë. Fetja është e vogël dhe nuk mund të na ndjekë në një luftim të tillë», — mendoi Zeqiri dhe thirri vajzën.

Po, pa mbaruar ende fjalën, ajo ja priti:

— Ju të veni në aksion e unë të rri këtu? Kështu-u? Unë të ndahem nga shokët? Jo, jo, jo! — dhe u zbeh në fytyrë.

Komandanti e dinte ç'dashuri kishte ajo për shokët e skuadrës së saj, ndaj e priste një përgjigje të tillë. Partizanët e panë vogëlushen ashtu të dëshpëruar dhe u penduan për qëndrimin që kishin mbajtur ndaj saj.

Në piskun e vapës, Fetja u nis bashkë me gjithë partizanët e skuadrës.

Po ku shkonte ky grup i vogël partizanësh?

Në majën e malit të Tartarit kishte mbetur e rrethuar një kompani e batalionit të tretë. Partizanët e skuadrës, të komanduar nga komunisti Zeqir Muho, kishin detyrë t'u vinin në ndihmë të rrethuarve sa më parë, prandaj nuk ndoqën udhën, po i ranë shkurt nëpër një përrua, të udhëhequr nga një djalosh i asaj ane, që e njihnte vendin pëllëmbë për pëllëmbë. Si bënë një copë rrugë, Zeqiri ndaloi skuadrën dhe tha:

— Pa uluni të shohim si e kemi punën! Gjer këtu arritëm mirë. Më tutje nuk mund të shkojmë, pa e zbuluar mirë vendin ku janë shokët tanë e ku është armiku! — dhe u shtri barkas e zuri të zvarritej. Fetja ju qep pas. Hiqeshin zvarrë, duke shtyrë me duar shkurret dhe çajin e malit, që i pengonte gjatë lëvizjes.

— Eh, sa të bukura janë këto male! — thoshte Fetja.

Ajo ishte vajzë qyteti, ndaj çuditej me natyrën e ashpër të maleve të Kurveleshit.

Zeqiri donte të thoshte diçka, po Fetja s'e la të fliste.

— Shoku Zeqir! Shoku Zeqir! Shiko, aty poshtë kanë dalë fashistët. Zeqiri ktheu kokën dhe njëqind metra më poshtë pa ca ushtarë armiq, që sheshonin vendin për të vendosur dy topa. Pastaj u dëgjua komanda, që u dha oficeri ushtarëve, dhe topat e armikut u zbrazën njëherësh. Predhat e tyre goditën majën ku ishin vendosur partizanët. Malet buçitën nga ai shpërthim i fortë.

...Dy kompani fashiste u hodhën në sulm

kundër kompanisë partizane, që ishte rrethuar në malin e Tartarit.

Partizanët e rrethuar shtinin papushim mbi fashistët.

— Tata... ta-ta-ta! Ta-ta-ta...

— Ta-ti... ta-ti... ta-ti... — u dëgjua zëri i burisë së partizanëve.

Ata u hodhën në kundërsulm. Ecnin me vrap, uleshin, shtinin me pushkë, hidhnin bombat, e prapë ngriheshin e sulmonin.

Në thepat e asaj maje, të dy palët u përleshën trup me trup. U duk sikur partizanët i vunë përpara gjermanët, po atë kohë topat e armikut i dendësuan të shtënat dhe midis asaj reje tymi, mezi shikoje ndonjë partizan, i cili prapë humbiste në për mjegull.

Fetja s'po e mbante dot veten nga inati dhe u bë gati të shtinte me automatik, po shokët e ndalën.

— Nuk bën ashtu! — e qërtoi vogëlushen komandanti. — Mos u nxito. Duhet ta mendojmë mirë punën e pastaj të veprojmë.

— Ç'të mendojmë? Po na i vrasin shokët! — ju përgjegj Fetja e skuqur në fytyrë. Asaj i dridhej zëri, jo nga frika, po ngaqë mendonte për shokët e për shoqet e kompanisë, që po goditeshin papushim nga predhat e topave.

— Dëgjoni! — u tha Zeqiri partizanëve. — Shokët tanë kanë katër ditë e katër net që luftojnë të rrethuar, pa bukë, pa ujë, pa gjumë e me municione të pakta, që mund t'u mbarohen nga çasti në çast. Është koha të bëjmë diçka për t'i ndihmuar që të dalin nga rrethimi. Puna më e mirë do të ishte që të bëjmë të pushojnë topat.

Partizanët e pranuan mendimin e komandantit.

— Më ndiqni! T'u afrohemi pa zhurmë! — tha Zeqiri.

U nisën njëri pas tjetrit, duke u zvarritur nëpër shkurret e malit.

Njëri nga shokët shtyu padashur me këmbë një gur, që u rrukullis tatëpjetë e ra te këmbët e fashistëve. Ata ngritën kokën dhe panë.

— Na pikasën! — thirri Fetja dhe desh të ngrihej më këmbë.

— Ulu! Qëlloni ku jeni! — urdhëroi Zeqiri dhe të gjithë u bënë një me dheun, duke mbajtur frymën e duke përgjuar armikun.

Partizanët vazhduan sulmin me sukses. Ja morën armikut gërxhin e madh dhe u lëshuan poshtë, në drejtim të qafës. Po ja, në atë kohë, si i dalë nga dheu, u duk një repart i ri, që u lëshua i tëri kundër partizanëve. Topat filluan prapë të shtinin.

Zeqiri e ndau skuadrën më dysh: gjysma nga e djathta e topave, kurse gjysma tjetër zbriti drejt e mbi ta. Fetja u sul në krye të skuadrës, e bindur se kishte gjetur çelësin për t'i shpëtuar shokët. Ndaj thirri:

— Përpara, shokë! Përpara-a!

Topat e armikut heshtën. Fashistët zunë të qëllonin me pushkë e automatikë skuadrën e Zeqirit.

Pionierja e vogël ju afrua një topi. Një bombë fluturoi e ra në mes të fashistëve. Fetja shtiu edhe një herë me automatik, u ngrit më këmbë dhe u turr përpara me vrull, por, sakaq, ra e goditur nga cifla e një bombe.

Partizanët, kur e panë vogëlushen që u rrëzua përdhe, u vërsulën më të egërsuar kundër ushtarëve armiq.

Atëhere shokët e kompanisë së rrethuar, kur panë se aty, te qafa, një repart i vogël partizan po u vinte në ndihmë, muarën edhe më tepër zemër dhe u hodhën përsëri në sulm.

Armiku, i goditur nga të dy krahët, e humbi toruan. Fashistët zunë të tërhiqeshin në rrëmujë: nuk shikonte i pari të dytin.

Kur shpëtuan nga rrethimi, partizanët shkuan në vendin ku kishte luftuar trimërisht skuadra e Zeqirit dhe muarën shokët e vrrarë.

Partizanit që mori trupin e Fetes së vogël për ta varrosur, ju duk sikur ajo luajti qepallat vetëm një herë e pastaj i mbylli përsëri. Prandaj bërtiti:

— S'ka vdekur! Qenka gjallë!

E ngritën Feten dhe të gjithë u grumbulluan rreth saj.

Fete Gjini, ashtu topolake siç ishte, e shëndoshë dhe e bardhë si bora, me flokët e gjatë, të mbuluara me dhé e gjak, me gjerdanin ngjeshur në bel dhe me xhaketën ushtarake të shqyer nga ashkëlat e bombave, me krahun e djathtë të thyer në shpatull, nxori një rënkim të mekur dhe heshti. Nuk u dëgjua më.

Partizanët e ngritën vogëlushen, ja lëvizën dorën e thyer dhe panë se mbi gjirin e djathtë të vajzës dukej një plagë e mavijosur, nga filloi t'i rridhte gjaku çurk. Në shpatull, te gropa e supit, i qenë futur thellë në mish, drejt mushkërive, tri ashkëla bombe dhe së andejmi i dilte më të rrallë, bashkë me gjakun, edhe një zhurmë e lehtë: «kërr, kërr!»

E muarën në krah dhe filluan ta mjekonin.
Ajo jetoi dhe disa orë, pastaj vdiq.

Partizanët e varrosën të pikëlluar dhe u larguan kokulur nga ai vend, ku po linin një pjesë të zemrës së tyre.

Ata marshuan një copë rrugë të heshtur, pastaj heshtjen e theu kënga partizane.

RRUGA E RINISË

Rruga Kukës-Peshkopi, Rruga e Rinisë, është një rrugë e bukur, që shpesh gjarpëron pas Drinit. Tregojnë se lumi ka fuqi t'i japë dritë, jo vetëm Shqipërisë, po edhe një pjese të mirë të vendeve fqinjë. Ajo kohë ka për të ardhur. Sot për sot, Drini rrjedh i rrëmbyer atje pranë kufirit. Ujrat e tij, që përshkojnë male të thepisura e lugina të ngushta, në zhurmën e tyre ruajnë krismën e kaq luftrave, që janë bërë në atë kufi, kujtimin e portershëm të kohëve që nuk harrohen, se janë krenari e popullit tonë e se i mbajnë zgjuar brezat për çdo rrezik të ri që mund të vijë për matanë atij kufiri.

Brahim Lika, një lumjan, është një nga ata burra që e mban lumi zgjuar me zhurmën e vet, e që e di mirë se ç'gjak do të thotë ai kufi. Sherrin e kralave të Serbisë ai e ka njohur që fëmijë, kur ata hodhën ushtritë e tyre këtej, dogjën e grabitën, vranë e varën luftës tjetër botërore. Tani së voni, ai ka njohur sherrin e Titos, ashtu siç e njohu gjithë Shqipëria e gjithë bota.

Hera-herës Brahim Likës i qëllon të qëndrojë atje përfundi fshatit, te një breg përmbi Drin, e të dëgjojë ujrat e egërsuara ose të vështrojë malet

larg, nga kufiri. Zemra i pëlçet kur mendon se ka dhe andej shqiptarë me qindramijë, që nuk panë një ditë të bardhë këto pesëqind vjet. Por, kur sheh xhadenë e re e automobilat që kryqëzohen, mendon se ditë të bardha do të agojnë edhe për ata që robtisen matanë, ashtu si ç'erdhën për ne. Kohët ndryshojnë.

Kohët ndryshojnë ngandonjëherë kaq shpejt, sa njeriu mbetet shtang. Kohët ndryshojnë. Ja, Brahim Lika, që tanimë nuk habitet, nuk ka menduar gjithmonë siç mendon sot. Sot, mbi këtë breg, përmbi Drin, ai kujtohet se nuk pat menduar gjithmonë kështu.

Ja, i kujtohet kur çilte rinia udhën e saj atje poshtë, e ai, me të birin, shihnin së këndejmi. Djali ruante dhinë në shkoza. Brahimi korrte arën e tij nën shkozë. Dinamiti ngrinte përpjetë dumanin e bënte të buçisnin grykat. Oshëtimat përsëriteshin me valë, gjersa humbisnin maleve përtej. Skënderi vinte e i lutej:

— Aman, babë!

Brahimi vihej prapë e korrte. Heshtja e tij donte të thoshte jo. Djali kthehej zemërvrarë te dhinë.

E ëma e ndiqte me bishtin e syrit e i dhimbej, po të shoqt i thoshte të mos i jepte leje. Ajo e shihte se burri nuk ishte dhe kaq i vendosur që të mos e lëshonte djalin për të punuar te rruga.

Adilja e vogël e ngushëllonte të vëllanë, duke i thënë se duhej të priste edhe ca, gjersa të rritej mirë. A nuk i thoshte i ati Skënderit «je i vogël»?

Me vite po, i vogël ishte. Me trup ai kishte marrë përpjetë, si një vgje i ri bjeshke, që ngrihet i bukur pranë vgjeve të moçëm, gati ta çojë kryet aq lart sa ata, në mos edhe më lart. Brahimin djalë po i ngjante si një vëlla i vogël. Ai kishte nisur të vishte çakçirët e kuparanet e t'et. E ëma e ndjente veten krenare, se po i bëhej djali burrë. Që tani ajo mendonte për nusen, ajo që, po të mos e dije se po bëhej me djalë katërmbëdhjetë vjeç, mund të thoshte se qe nuse vetë.

Po Skënderi ishte djalë i vetëm, «djalë dëshiri», si thonë në disa anë të veriut. E Brahimin me të shoqen e ruanin si sytë e ballit.

Atje, mbi xhade, punonin dhe plot çunakë. Kur i qëllonte Brahimin të shkante e t'u shiste ndonjë shportë me kumbulla ose me qershi — disa herë edhe s'ua shiste, po ua falte — ai shihte në mes tyre djem të një vërse me të birin. E jo veç djem, po dhe vajza. Kishte disa lebër, të cilëve zor t'u jipje moshë, sepse kishin qëlluar prej vetiu të shkurtër. E pra, sa të vegjël dukeshin, për punë ata ishin të parët në gjithë atë xhade! Si djemtë, si vajzat... Kjo puna e vajzave nuk i pëlqente fare Brahimin.

Këto kohë që kishin ndryshuar kaq shumë, nga kjo anë kështu, s'kishin ndryshuar për mirë, mendonin ata të dy... Po e kishin fjalën te djemtë. Çamarrokët e Labërisë punonin atje në xhade aq mirë, sa t'ua kishin zili dhe burrat. Skënderi nuk do ta turpëronte Brahimin në mes të shokëve, edhe pse punë krahu s'kishte bërë gjer atëhere, po kishin vajtur në shkollë e me dhi. Veç Skënderi ishte djalë dëshiri. Pastaj, kush do t'i ruante dhinë? Adilja ishte ende e vogël. Asaj i mjaftonin kecat.

Kur kujton sot Brahimi punën e dhive, që s'kishte kush t'ja ruante, vë buzën në gaz ose qesh. Qeveria çel udhë, që të shpjerë dritën e mirësitë kudo, ai tjetri qahet se nuk di se kush t'ja ruajë dhitë! Brahimin s'kishte se kush t'ja ruante dhitë! Po kush ja ruajti kur i iku djali? Se iku! Ato dhi që ka sot, kishte edhe atëhere. Atij aq i bënte për xhadenë atëhere; i dukej se mund të bëhej edhe pa xhade.

Tani Brahim Lika e ka kuptuar se kanë ardhur kohë që, pa xhade, nuk bëhet. E xhadeja i pëlqen. Ja, prej kanalit të Vllashukut të Lushnjës, që po mbarohet së hapuri sivjet,¹⁾ e ku Brahimi punoi këto tre muaj që shkuan, atij nuk ju deshën më shumë se dy ditë gjer në shtëpi. Po të mos kishte qëndruar një natë në Tiranë, nuk do ta bënte më shumë se një ditë të plotë udhën. Të ishte nisur më këmbë, do ti duheshin një javë ditë. Mos thotë kush se atë puna as që do ta shpinte ndonjëherë në Vllashuk, se ja që e shpuri. Kur do t'i merrnin djalin ushtar, puna mund ta shpinte edhe gjer në Gjirokastër... Tani Brahimin e ka kuptuar se kjo kohë e sotme nuk mund të bëjë pa xhade. Atëhere ai s'e merrte vesh e djalin nuk e shpuri të punonte me shokë aty, buzë Drinit.

Kur u mbarua Rruga e Rinisë, njerëz si Brahimin bëjnë «shyqyr». Më në fund, do t'u binin veshët rehat nga djemtë. E në Kukës e në Peshkopi e gjetiu, do të shkonin shpejt e më rehat. Po kjo qeveri e sotme e paske nisur punën keq me udhët. Rinia edhe më keq. Sa mbaroi Rruga e Rinisë, nuk

1) Tregimi është botuar për herë të parë njëzet vjet të kaluara.

shkuan veçse pak muaj — dimri e gjysma e pranverës — e filloi Hekurudha e Rinisë.

— Të iki, babë, — lutej përsëri Skënderi, kur shihte automobilat me të rinj që vinin xhadesë drejt jugut, me këngë e me flamur.

Po Brahim Lika, që s'e la djalin të punonte aty, nën shtëpi, si do ta largonte prej sysh andej nga Durrësi? Le të ishte rritur akoma ato pak muaj Skënderi, që tani po ja arrinte vërtet babait me shtat.

Në katund, rinia nisi të ziente si bleta në koshere. Ata që kishin punuar në xhade, ikën e muarën dhe shokë pas. Që nga Kukësi vinin të rinj e agjitorin nëpër Lumë e nuk ktheheshin pa marrë të rinj të tjerë me vete. Mësuesi i fshatit bënte edhe ai punën e tij. Skënderi ju lut dhe disa herë t'et, që s'e dëgjo; atëhere iku pa leje.

Brahimi ishte në të thyer e sipër atëhere. Ca se e shihte se djali vuante, ca nga sedra se djem më të vegjël shkuan. Brahimin i qe mbushur mendja ta lironte të birin. Po nuk dëgjonte e shoqja. Veç Skënderi iku vetë, atij i erdhi rëndë e u zemërua. Burri nuk mbante mend kurrë t'ja kishte bërë çuni kështu.

Kaluan ditë e Skënderi dërgoi letër. Ishte shëndoshë e mirë e punonte buzë detit, te Shkëmbi i Kavajës. Kishte dalë dhe sulmues. Përpiqej djali, në atë letër, t'u tregonte se ç'ishte hekurudha, po Brahimin me të shoqen nuk muarën vesh gjë të madhe, as Adilja që u lexoi letrën, që kishte bërë vitin e dytë në shkollë. Për fat, edhe shkolla ishte mbyllur atij mbarimi qershori e mësuesi nuk ishte aty që t'ua shpjegonte më mirë. Burri e merrte me

mend se rinia tani nuk ishte duke ndërtuar një xhade të zakonshme, po diçka të madhe fort. Një udhë e tillë hekuri ishte e para në Shqipëri. Adilja s'kishte ditë që të mos e përfytyronte në një mënyrë të re atë udhë prej hekuri e t'ua tregonte prindërve, të cilët kishin qejf t'i bënin të tyret përfytyrimet e vogëlushes.

Kaluan tre muaj e shumica e shokëve të Skënderit u kthyen në fshat, në krahinë. Ai vetë s'u kthye. Dërgoi letër e tha se ishte zotuar të qëndronte edhe tre muaj të tjerë vullnetar. Shokët treguan se djali po mësonte edhe në një kurs, për punë të hekurudhës.

Brahimi u vreros. E shoqja qau. Qau dhe Adilja e vogël, që e kishte pritur me aq mall e me aq kureshtje të vëllanë.

Burri mbaroi së korruri arën përmbi Drin e u nis të shihte të birin. Ai arriti në Durrës ato ditë, kur lokomotiva e vagonat e parë zbritën në port. Ai dëgjoi fishkëllimën e lokomotivës së parë dhe pa trenin e parë që u nis nga Durrësi për Kavajë. Një alamet maqine si ajo Brahim Lika as që do ta kishte marrë me mend kurrë. Përbindshat e përrallave nuk shëmbëllenin me të. Atij ju dukën asgjë kamionat e maqinat e tjera që vërtiteshin pranë lokomotivës. E kur pa Brahim se kjo maqinë, që nxinte nga qymyri e që tymoste përpjetë si njëzet oxhakë bashkë, tërhiqte një bisht të pambaruar shtëpish, ai tha me vete se, pa dyshim, ky tren — si i thoshin — jo vetëm fshatin e tij që e merrte brenda, po mbase Lumën e gjithë. Këtë radhë Brahim Lika e ndjeu edhe më mirë forcën e partisë e të qeverisë e ju kujtuan partizanët. Për ta, ai dhe fshatarë të tjerë kishin thënë se ishin njerëz

që mund të sheshoshin edhe malet. Këta vërtet kishin për të sheshuar malet ndonjë ditë.

Brahim Lika shkoi te Shkëmbi i Kavajës të shmallej me të birin. Shkoi me tren, përmbi një vagon të ngarkuar me binarë. E muarën disa djem, që e njihnin Skënderin. I kishte nxirë e bërë dielli si arapë, po i kishte kalitur era e detit e puna i kishte bërë të zhurmshëm e fort të qeshur. Ata pyetën për Lumën, për fshatarët që kishin njohur verës tjetër, kur kishin punuar xhadenë, u interesuan për gjënë e gjallë e të mbjellat, për shkollat e organizatën e rinisë. Brahimi ndjeu zili në vetëvete se ishte i një brezi tjetër, edhe pse ai e hiqte veten ende të ri; të tridhjetepesat nuk i kishte mbushur.

Treni shkonte ngadalë. Udhë s'kishte zënë vend mirë ende, thoshin djemtë. Rrotat i rrihnin binarët si çekanë të mëdhenj, bam e bum, bam e bum. Maqina atje në krye fishkëllente fort, sikur të donte ta dëgjonte bota e gjithë se po kalonte treni i parë i Shqipërisë. Nga të dy anët e udhës, të rinjtë që punonin ende për të sheshuar ose për të pastruar ndonjë kënd, linin lopatat e karrocet e rendnin pas trenit me të britura të gëzuara. Njerëzit ngrinin shpinën nëpër ara e bostane e thagmitëshin. Përmbi detin e kaltër e aq të shkëlqyeshëm, sa të dhembnin sytë ta shihje gjatë, zgalemët fluturonin larg, të friksuar nga fishkëllima e egër e atij gjarpëri prej hekuri, që kishte ardhur të pushonte ranishtet.

Brahimi s'e gjeti djalin te Shkëmbi i Kavajës. Skënderi kishte shkuar me punë në Tiranë atij mëngjezi e qe bërë me famë në gjithë hekurudhën, se gjer tani kishte dalë katër herë sulmues e se e kishin bërë komandant kompanie. Në mësimet ish-

te i dalluar. Brahimi hëngri drekën me të rinjtë. Ushqimi i pëlqeu. Pa dhe barakat ku flinin e s'ju duken keq. U qau hallin për vapën e madhe e për atë uje të valë që kishin. Por, kur nuk dëgjoji njeri të qabej nga vapa e nga ujët e kur pa detin atë pasdreke të mbushet me qindra të rinj gazmorë, i përmalluar se nuk u takua dot me djalin, i hipi trenit në të kthyer e mori udhën e fshatit.

Në shtëpi, Brahimi tregoi çudirat që kishte parë. Adilja e vogël, këtë radhë, sikur e pa me sytë e vet trenin kur i ati rreshtoi kacarrumat e misrit bisht në bisht në një varg të gjatë, e vuri një sapllak të madh e të nxirë në krye të vargut.

— Zëre se ky sapllak është një maqinë sa kjo shtëpia e që lëshon tym sa njëzet oxhakë. E zëre se këta kacarruma janë të mëdhenj secili sa tri herë kjo shtëpi, me dyer e me dritare të mëdha. E zëre se gjithë këta ecin me rrota hekuri, që shkasin mbi dy biga të drejta hekuri bam e bum e zhak e zhuk. Të futësh gjithë Lumën brenda, vallahi!

Brahim Lika thujse gjithë asaj jave mbeti së treguari punët e trenit nëpër fshat e në shtëpi. Kot e kishin bërë ata djem që nuk ndenjën në hekurudhë më shumë se tre muaj. Ata s'kishin parë gjë me sy pa ardhur treni. Sot ishte ç'ishte në Durrës. Tani ishte për të punuar atje. Të rronte kjo rini, që po bënte çudira.

Kështu me Brahimin. Ai agjitoi për hekurdhën atëhere më mirë se dhe organizata e rinisë vetë. Vullnetarë të tjerë u nisën të entuziazmuar.

Muajt shkuan. Skënderi u kthye vetëm për një pushim të shkurtër në shtëpi. Ai kishte dhënë

fjalën se do të qëndronte me punë në hekurudhë. Rroga i dilte të ndihmonte edhe shtëpinë. Brahimi më kot nguli këmbë që djali të qëndronte. Ky tani dukej si burrë i pjekur. I tregonte t'et ato pesë dynym tokë pa ujë, që kishin përmbi Drin, e ato njëzet kokë dhi, e i thoshte se nuk duheshin dy burra për të punuar një hasër vend e për t'ju kujdesur një grushti bagëtie. Brahimin ju mbyll goja. Nëna qau. Adilja qau edhe më shumë. Skënderi iku.

... Sot kanë kaluar vjet e Skënderi po kryen shërbimin ushtarak në Korçë. Brahimi është e dyta herë që ka shkuar krah pune. Vjet në Rogozhinë, ku u ndërtua një fabrikë e madhe për zhveshjen e pambukut. Sivjet punoi tre muaj në kanalën e Villashukut, që kësaj vere do të njomë mijëra hektarë tokë të asaj Myzeqeje të përvëluar për ujë, e ku do të bëhen pambuku e misri që të mos kenë të mbaruar.

Ka qëndruar Brahimi te ai bregu i vet përmbi Drin, përfundi arës së korrur. Vështron grurin stivë e mendon se e shoqja është përpjekur shumë kësaj vere. Punën e ka bërë për bukuri. Vajza e ka ndihmuar.

Adilja tani është rritur. Burrë e grua kanë menduar edhe se ku do ta japin, po s'ja kanë thënë ende, se është ca vështirë me këto çupat e sotme të vendosësh për gjëra të tilla, e Brahim Lika e di mirë këtë. Ai i druhet vajzës, megjithëse e ka të urtë. I urtë ishte edhe Skënderi, të cilin s'e përmbajti ashtu si donte vetë. Jeta i shtyn përpara të rinjtë me aq vrull, sa nëna me babanë s'kanë ç'të bëjnë.

Kur ishte nisur për Vllashuk Brahimi, rinia ziente më shumë se ngaherë në fshat. Kërkoreshin vullnetarë për Hidrocentralin «Enver» të Matit. (I kishte ardhur dita Matit! Edhe Drinit do ti vinte, mendonte Brahimi. Kohët ndryshojnë shpejt). Tani ishte puna, sidomos, edhe për vullnetarë. Duhej të dilnin vajzat, që, këtyre anëve, gjer më sot, kishin dalë tepër pak. Brahimi, për punë të vajzave, kishte mbetur thujse ku qe. «Zjarri te baroti nuk duhet afruar», thoshte ai. Po në Vllashuk vajzat nuk mungonin e gjë e ligë s'ishte ndjerë e parë. Kur i kujtohej atje e bija, që i pat hedhur fjalën nja dy herë se do të ishte mirë të shkonte edhe ajo me shoqet (dhe Skënderi kështu i shkruante prej ushtrie), Brahimi sikur pendohej që nuk e mori vajzën me vete në Myzeqe, të punonin së bashku e ajo ta hiqte edhe këtë merak. Mot shihte e bënte.

Udhës nga kishte ardhur Brahimi, që nga Burri e gjer në fshat të tij, kishte parë kamiona me të rinj e të reja prej gjithë krahinave buzë Drinit, që shkonin për hidrocentral. Thujse kishin lënë shtëpinë gjithë çikat e maleve. Burrit nuk i erdhi mirë. Nuk i erdhi mirë, jo se kohët kishin ndryshuar kështu, po u druajt se mos dhe e bija iku me shoqet e ai e mbajti kot. Kur po shkonin qindra të tjera, pse të mos shkonte dhe ajo?.. Kështu mendon Brahimi sot, megjithëse me një halë në zemër.

Burri e ndjeu veten diçka të kapitur nga këto mendime, po u ngrit e mori të përpjetën. Nga larg diktoi te shkallët e kullës së tij, xhoken e bardhë të gruas që zbriste. E shoqja e pa kur vuri këmbën te kapërcelli i kopshtit nën shtëpi, e rendi e i mori një torbë të madhe me tesha, që ai mbante në sup.

Sikur kishte një gëzim të shqetësuar e shoqja. Brahim i çoi mendjen menjëherë te e bija. Gruaja e vështroi të shoqin me dy sy të përmallur, ku nisën të shkëlqenin dy lot. Uli kokën e nuk foli.

— Demek, shkoi dhe Adilja? — tha burri e e ndjeu veten më të lehtë së brendshmi.

— M'u dhimbs e e lashë, o Brahim, — ja bëri e shoqja. — Fëmija nuk mbahet më sot. Po të themi lum që i kemi fëmijë të mirë e nuk ua kam frikën. Po kam mall, — tha ajo e, me cepin e shamisë së bardhë të kreit fshiu sytë e faqet e njomura.

Brahimi u ul në fund të shkallëve prej guri të shtëpisë. Ai vështroi larg malet nga kufiri. Tutje, nga e majta, vështroi udhën pas Drinit, që ishte fort e kaltër asaj dite vere, edhe pse i thonë «i zi» e është i rrëmbyer.

Brahimi ja nisi një kënge që kishte mësuar në Vllashuk. Kënga fliste për punën, rininë e për ditët e reja.

DILA

Unë jam teknik gjeometër i këtij sektori. Nuk jam më i ri, si këta vullnetarë që vijnë, shtrojnë trasenë, shpien më tutje shinat dhe ikin. Ikin të lumtur. Ata do t'i kujtojnë me mall këta dy muaj pune këtu. Kurse unë do të kujtoj me mall këto vite, kur u bëra i ri si ata.

Ata ikën. Tani kapanonet janë të qeta. Një qetësi e mërzitshme, si ajo kur në shtëpi kanë një të sëmurë.

Ikën të gjithë, bile dhe kuzhinierët shkuan të bëjnë pushimet e tyre.

Por qetësia është e rreme. Krejt e rreme për një njeri që e ndjen. Ja, vër veshin e dëgjo, dëgjo me kujdes! A s'i dëgjon përsëri zërat e shokëve, këngët, bisedat, shakatë? A nuk i ndjen ata që ikën dhe të tjerët që po vijnë? A nuk e dëgjon përsëri Dilën se si këndon këngën e Llesh Palit?

Dilën?

Ajo mbeti aq e urtë, aq e heshtur, sa dhe në ditët e para të ardhjes në sektor të vullnetareve nga malësia, kur të gjitha ato, megjithëse fort të reja, jetonin midis nesh aq serioze, aq të përqëndruara në mendimet e tyre, sikur hekurudha të

ishte një kuvend solemn malësorësh të lashtë. Pra-
pëseprapë, edhe midis tyre Dila spikaste për druaj-
tjen e saj.

Ajo ishte e vogël, fare e vogël. Bile mua më
dukej se andaj ishte edhe aq e truar, sikur të kish-
te frikë se ndokush do t'i thoshte: «Po ti ç'do këtu,
moj njomzake? Ikë shpejt në shtëpi, se nuk është
hekurudha kopsht fëmijësh».

Por asnjë nuk i tha «ikë». Ajo punonte tok me
malësoret e tjera dhe nga dita në ditë filloi të na
zbulonte të fshehtat e saj, të shtrenjtit margarita-
rë së saj.

Në fillim ajo na zbuloi të qeshurën e saj.
Ishte një e qeshur e rrallë, magjepsëse. Një e
qeshur që të joshte për të qenë i lumtur. Për të
qenë i lumtur si ajo?! Jo! Ato ditët e para, megjithëse
ajo qeshte me të madhe, nuk ishte e lumtur.
Ky gaz i saj ishte vetëm një pasqyrim i turbullt,
i largët i lumturisë që po afrohej, por jo lumturia.
Ishte ende larg ajo nga lumturia.

Vështirë e kishte lumturia ato ditë me Dilën.

...Hoqi një ditë Dila ato rrobat e rënda, që
për trupin e saj të imtë — ishte vetëm trembë-
dhjetë vjeç Dila — peshonin shumë dhe i merrnin
frymën, si ato kostumet fantastike të palombarë-
ve. Ishin fort të rënda ato rroba që ja kishte dhë-
në e ëma (apo e motra) atje tej, rrëzë Munellës.
Dhe veshi Dila rrobat tona të aksionit, rrobat e
lehta, kominoshet tona punëtore. Dhe pamë atë
ditë që Dila ishte e bukur.

...A e dëgjon, a i dëgjon zërat e gëzuar të
shoqeve?..

...Dhe shkuan vajzat e malësisë në banjë,
e tok me to dhe Dila, e i gululisi ato uji i vakët

i dushit. Atyre u dukej sikur një dorë magjike u derdhte mbi supe ngrohtësinë dhe dashurinë e jetës.

I gudulisi ato uji i pastër dhe qeshën ato, sa që sumbullat e ujit — kristale të çuditshme — shkisinin e binin nga kurmi i tyre si kokrra orizi nga nusët e përrallave tona.

Dhe qeshi Dila, qeshën vajzat e malësisë me një të qeshur të tillë, sa u çudit gjithë sektori dhe ai gazetari që shkroi tri kolona në gazetë për këtë ngjarje. Ishte hera e parë që gocat e malësisë laheshin në banjë.

...Më vonë Dila na tregoi vallet e malësisë, valle të forta, do të thosha pak të ashpra. Ndoshta në këto valle gratë tona kanë dashur që të pakuin këtu të ishin njësoj si burrat, të forta si burrat. Apo ndoshta burrat u dhanë në shekuj grave të malësisë, jo vetëm ligjin e tyre, por dhe ritmin e valleve, meloditë e këngëve?..

Dhe kërcente hijshëm Dila, thua vendi i saj ishte në Ansamblin e këngëve dhe të valleve në Tiranë. Dhe i bënte ajo njerëzit me vallen e saj të gëzoheshin, kurse ajo vetë megjithëse nuk ishte e lumtur.

E shihja përditë në trase, tek punonte më shumë edhe se shoqet e saj malësore. E shihja kur djersa i pikonte gushës dhe mënga e bluzës i bëhej qull nga të fshirët. Më vinte keq për të dhe u thashë një ditë shokëve ta caktonin për të mbushur ujë për vullnetarët. Nuk pranoi: «Unë duhet të punoj sa për dy vetë e të mos korritem», u ishte përgjegjur ajo shokëve.

Unë nuk e kuptova pse duhej të punonte kjo vajzë e vogël sa «për dy vetë». Ç'qëllim i kishte vë në ajo vetes në këtë aksion? Ç'kërkonte ajo? Mos

ndoshta lavdinë personale? Jo, nuk mund të ishte kështu. Dila dhe lavdia personale ishin larg njëra tjetrës.

Gazetat përditë shkruanin për fejesat e mi-shura. Përditë ne, e tok me ne dhe malësoret dhe Dila, lexonim e dëgjonim letrat e vajzave dhe të grave të krahinave të ndryshme të Shqipërisë që i drejtonin shokut Enver. Dhe shoku Enver u përgjigjej. Ai u shtonte kurajon, guximin vajzave dhe grave kudo në Shqipëri, e jo më në sektorin tonë, ku flaka ishte gati të digjte e të zhuriste çdo gjë të vjetër e të kalbur, se nuk mungonin pishtarët, që ishin shoqet e shokët vullnetarë.

Mua nuk më shkonte mendja që midis shoqeve vullnetare të brigadës së malësisë të kishte nga ato të fejuarat që në djep, ose që pa lindur akoma; të kishte nga ato që, përpara se të lindnin, ishin «gruaja e Frrokut» apo «burrnesha e Pjetrit». Mua më ngjante sikur gjithë ato që dëgjonim ishin dikur larg nesh, tutje maleve të larta. Dhe nuk e kuptoja dot, ose, më mirë të them, s'më shkonte në mendje kurrë se si mund të ndodhte që vajzat e ardhura vullnetare nga malësia, ato që ngri-nin me ne trasenë, që po i jepnin atdheut një lumturi të re, një lumturi të madhe e njerëzore për veten e tyre të ishin fatkeqe. Sa i gabuar që isha!

Andaj, duke mos e kuptuar këtë, unë mendoja se ç'kishte Dila, ç'po kërkonte ajo në këtë aksion, ç'flisnin vajzat e malësisë ato ditë.

Nga shtatëdhjetë e gjashtë vajza vullnetare që kishte dërguar malësia, që jetonin tok me ne, gjashtëdhjetë prej tyre qenë të fejuara, të fejuara pa i njohur të fejuarit e tyre, burrat e tyre të ardhshëm.

Gjithkund në Shqipëri prishen fejesat e bëra me pahir, kurse në sektorin tonë kishim gjashtëdhjetë të tilla! Sa e vështirë, sa e ashpër, sa njerëzore është kjo luftë që po bën sot Shqipëria! Merre me mend, këtu midis nesh, midis vullnetarëve të rinisë, dhe kaq shumë fejesa që duheshin prishur... Dhe ato u prishën.

...U mblodhën atë ditë vajzat e urta, vajzat e qeta të malësisë, dhe secila prej tyre rrëfeu një dramë të madhe, gjashtëdhjetë drama të forta, por më e madhja, më e forta ndër to ishte ajo e Dilës.

Dila e vogël — trembëdhjetëvjeçare Dilë — ishte e fejuar me një burrë të ve, dyzetvjeçar, që e kishte përzënë të shoqen, se ishte plakë. Ishte fejuar me një burrë, i cili djemtë i kishte më të mëdhenj se Dila. Djemtë e tij mund të ishin dhëndurë për Dilën. Kishte Dila edhe një motër më të madhe, Mrikën, që kishte çfaqur dëshirën të vinte në hekurudhë. Por i fejuari i kishte thënë babait të vajzave se në «kjoftë se e len me kalue katundin — apo ndoshta kanunin — e kemi prishë fejesën».

Dhe u tremb i ati i vajzave. Ju tremb ai turpit, me çka do ta damkoste kanuni, dhe nuk e la Mrikën të shkonte vullnetare. Por në ditët tona qenka dhe një turp tjetër, një turp i panjohur deri sot, ai i shkëputjes nga kolektivi, nga fshati. Dhe që të mos turpërohej burri i malësisë para fshatarëve të tij, se në fund të fundit e bija, Mrika, kishte dalë vetë vullnetare, pa e shtyrë njeri, dërgoi vajzën e vogël, Dilën në vend të Mrikës në hekurudhë.

Mendoi babai se nuk do ta prishte fejesën Ndue Pali (i fejuari, burri i Dilës, që priste Dilën

sa të bëhej për martesë), se s'kishte ku të gjente Ndue Pali cucë më të re e më të mirë se Dilën, në këto ditë që po bëhej kiameti i zi. E aq më tepër se, duke qenë fëmijë Dila, nuk kishte ç'turp t'i ndodhte në hekurudhë. Kjo është lufta e klasave, që shfaqet tek ne sot me një forcë të re.

Ashtu mendoi babai i vajzave dhe kështu doli. Ndue Pali nuk i bëri fjalë atij, e la të shkonte Dilën në hekurudhë, «edhe ndonji palë tesha po i sjell me vedi një ajo», pa çka që vajtja e saj në hekurudhë, diku thellë nuk i pëlqente... Por ishte e njomë fort, besa, Dila e për të hekurudha pranohej!

Kështu mendoi Ndue Pali, kështu mendoi babai i Dilës, por nuk mendoi kështu Dila, nuk menduan kështu gjashtëdhjetë vajzat e malësisë, që atë ditë prishën fejesën e tyre, që atë ditë e lanë Ndue Palin me gisht në gojë.

...Dhe atë mbrëmje na zbuloi Dila dhe këngën e saj. Këngën e bukur të Llesh Palit, dhe ne e quajtëm pas kësaj këngëtarja e Llesh Palit, emër ky që i mbeti deri ditën që iku. Dhe atë mbrëmje, po, ajo ishte e lumtur, sepse këndonte për lindjen e saj, për jetën e saj të vërtetë të dhuruar nga partia.

Ajo iku dhe unë qëndroja këtu midis shinave që shtroi ajo, dhe mendoj për të. Mendoj për luftën që e pret atë në fshatin e saj, për luftën që e pret atë për të çliruar si veten edhe Mrikën dhe shoqet e saj. Mendoj që fati i saj dhe i Mrikës mund të jenë fare pranë njëri tjetrit, siç janë këto dy shina, e të mos bashkohen kurrë, të mos shkrihen kurrë... Por tek i shoh shinat në horizont të pykëzohen e të shkrihen në një të vetme, unë besoj që dhe fatet e tyre do të jenë të njëjta. Unë i besoj këtij vizioni të hapësirës... dhe të kohës.

NJË «KONGRES» I VOGËL I VULLNETAREVE MALËSORE

...Por kurrë ëndërrat e tua, Myzeqe, nuk e kanë derdhur lumturinë me shtëmba në tabanin tënd të begatshëm. Dikur ti ëndërroje që parmendën ta tërhiqnin dy qe, ndërsa tani ëndërron që ndonjë ditë të rrëshqasë përmes gjoksit të gjerë treni i hekurt. Dhe e beson këtë, e beson, se në prehërin tënd ndjen si po të thërmojnë me kazma, ndjen zhurmën e karrove dhe rrahjet e tokmakut, ndjen mbërthimin e shinave përmbi trasenë e gjatë që kanë nisur e hedh shtat, ndjen këngën dhe gazin, si atëhere kur ndjeje lirinë nga krismat e pushkëve partizane.

Dhe kanë zbritur këtu plot të rinj dhe të reja nga tërë anët e Shqipërisë, nga Kukësi dhe Konispoli, nga Durrësi dhe Pogradeci, nga Lezha dhe Përmeti, nga Erseka dhe Burreli. Ti e sheh tek ka zbritur në prehërin tënd e tërë Shqipëria, me malet dhe fushat, me bjeshkët dhe kodrat, me pishat dhe limonat. Sheh tek kanë zbritur ato cuca malësore, ato vajza nga katundet më të ndryshme të maleve, nga Kurdaria, Karrica, Baza, Derjani, Lisi, Zenishta, nga Shishtaveci, nga Domaj, nga

Gramshi, nga Komaj, nga Surci, nga Kalimetri, nga...

Ehu, sa shumë kanë zbritur! Zbritën ashtu, si copa malesh të palatuara; me dimçe dhe rasha të rënda.

I.

«Ne, cucat fshatare, nuk do shitemi
me para»

U nisën një ditë nga qytezat e tyre, u nisën nga sektorët e tyre dhe erdhën tërë ato malësore, në sallën e madhe të kulturës, pranë Shtabit gendror të hekurudhës. Ishin mbi treqind cuca. I shihje tek ecnin ashtu të qeshura e të gëzuara, jo si atëhere në fillim, të zëna dorë për dorë. Ecnin si një karvan i madh, në relievin e të cilit luhateshin dhjetëra ngjyra, dhjetëra triko, dhjetëra shami vullnetarësh. Dhe s'kanë kaluar as dy muaj jetë aksioni, po ato i sheh të pastra si jo më mirë, me flokët e shkurtër të krehur, me funde dhe fustane të lehta, pa dimçe, pa rasha, pa ato «pulëbardhat» e rënda. Se erdhën këtu këto copa malesh që edhe të marrin diçka të butë nga gjelbërimi dhe bujaria e Myzeqesë, e jetës, e njerëzve të tjerë, e të rinjve dhe e të rejave të tjera shqiptare.

Kishin një mbledhje të rëndësishme ato cuca, diç të madhe do të diskutonin dhe do të vendosnin aty, në sallën e madhe të kulturës.

— A s'e ke marrë vesh ti, a? — më tha një balldrenase, e qeshur dhe me një farë krenarie të përlligjur. — A nuk e din se na do të bajmë një mbledhje për të dënue zakonet prapanike?!

Kështu i dukej asaj balldrenases se tani, pas një muaj e gjysmë jetë aksioni. kishte mundur të kuptonte diçka të madhe: ndoshta të kuptonte atë që ato s'kishin mundur ta kuptonin tërë jetën. Dhe tashmë, që kishte kuptuar këtë, e ndjente sa shumë u është dashur dhe i duhet partisë sonë, njerëzve tanë, për t'i sjellë ato në jetë. Andaj i dukej sikur tërë njerëzit që ndodheshin përreth mendonin pikërisht atë, jetën e atyre malësoreve, se edhe partia për ato mendon kaq shumë.

Qysh në fillim mbledhja nisi si një kuvend, por me një ndryshim: këtë kuvend e bënë të rejtat e malësive tona.

— Rroftë sokoli i maleve, shoku Enver Hoxha!
— thirri një malësore me sa zë që kishte.

Ndodhi një shpërthim i bujshëm duartrokitjesh, thirrjesh, ovacionesh të pandërprera për parti-në dhe shokun Enver.

Heshtja ende s'kishte platitur plotësisht, kur u çua një e re nga mesi i sallës e tha:

— Cucat tona janë të mrekullueshme. Na do t'i djegim ligjet e kanunit. Pse të shitemi me lek?

Po aq papritur çohet një malësore e lexon një letër që matjanët i kanë çuar kohë më parë shokut Enver.

Duartrokitje të stuhishme, thirrje të forta për partinë dhe shokun Enver. Ishte një manifestim nga më të zjarritit i shpërthimit të ndjenjave, të mendimeve dhe të guximit të malësoreve tona. Ato kanë nisur një kuvend të tyre, të cilin s'mund t'ua ndalë asnjë forcë në botë; tek ato ka shpërthyer një vrull dhe mendim i mburjtur prej kohësh.

— Mrika e ka fjalën, cuca!

Dhe Mrika nis e flet:

— Qysh dhjetë vjeç më pat fejue baba jem, o motra, qysh dhjetë vjeç. Më pati fejue me njanin që s'e dojshta edhe kur nisa me e kuptue jetën. Por baba jem s'e kuptonte, andaj më shkëputi edhe nga shkolla, të cilën e dëshirojshta aq shumë. Kështu edhe nana. «Po pse, o nanë, më keni fejue kaq të vogël?!» i thashë. «Shëëëët!» ja bante nana. «Po pse, o babë...»? «Mbylle atë gojë» më hakërruhej baba. Dhe koha kalonte e unë haja bukë e lot... Por a mendoj kush për ne, cuca? Mendoj shoku Enver! Fjalimi i 6 Shkurtit më shtyu mue të shkoja te sekretari i partisë, kur baba më zboi nga shtëpia. Dhe partia më ktheu në shtëpi dhe unë e prisha të-jesën. Tash do të marr atë që do të dëshiroj.

U ngrit e foli ajo Dudia nga Burreli. Edhe ajo pothuaj po atë histori tregoi, se të tilla ligje kanë rënduar njëheresh mbi jetën dhe rininë e malësive tona, andaj mjerimi i tyre ka qenë i përafërt, andaj ato flasin të njëjtat gjëra.

— Më kanë fejue tash katër vjet. Mue më pëlqeu aksioni si dhe cucave të tjera; atij si pëlqen. E ndava, o motra, e prisha atë fejesë, se unë e ai s'dashu-
noheshim, se na s'njiheshim, s'mendojshim njëllorj. Dhe u fejova, cuca, me një që e desha vetë, — tha Marjana.

Sa fort thërret ajo malësorja e vogël nga Kukësi! Sa shumë i duartroket ajo fjalët e Marjanës! Dhe sa shumë duartrokasin të gjitha ato malësore që gjenden në atë sallë! Duartrokasin Marjanën, mendimet e saj, ndjenjat e tyre.

Kjo mbledhje të jep edhe përshtypjen e një kuvendi vullnetarësh malësore, edhe përshtypjen e një kongresi të vogël, që buron nga një mendim dhe guxim i papërmbajtur.

— Cuca, — u ngrit e tha Mina nga katundi Domaj i Kukësit, — motrën teme e lëshoi burri, e la, se ata nuk duheshin, se ata nuk njiheshin. Por e la vonë, kur ishte martue. Dhe pastaj baba deshti me më fejue edhe mue, me më fejue ashtu, sipas zakonit të vjetër, pa na pyetë neve, por unë s'pranova: unë do ta gjej vetë atë që më takon.

Çoheshin dhjetëra malësore, çoheshin e flisnin pa marrë leje nga presidiumi, se aty ishte kuvend dhe ato ishin të gjitha në kuvend; flisnin ashtu si dinin, ashtu si mendonin, me atë logjikën e squet të malësoreve sonë, me atë guximin e madh që u ka shpërthyer rishtas. Shikonin përreth dhe shpërthenin tërë atë lëmsh urrejtjeje që u ishte pleksur prej kohësh, ngriheshin me guxim kundër ligjeve poshtëruese të kanunit mesjetar, kundër bestytnive fetare dhe mashtrimit që prindërve të tyre ua kishin mëkuar deri në palcë regjimet e huaja.

Dhe tërë këtë shpërthim nuk e solli çasti, atë e solli puna e gjatë edukuese e partisë, fjalimi i 6 Shkurtit i shokut Enver, puna e madhe ideologjike dhe aksioni. Dalja në jetën e madhe, të gjerë e vajzave tona malësore, marrja kontakt me një diapazon të gjerë jete, ndeshja me shpirtin e kolektivitetit, përpjekja e ideologjisë së tyre me ideologjinë e re të partisë, të cilën e hasën në jetën e përditshme, së cilës ju ndodhën pranë për një muaj e gjysmë rresht, i bëri malësoret tona të hidhen në jetë në një çast të rëndësishëm.

Zbritën ato nga malet, ashtu të pështjella rëndë me rasha dhe dimçe, të ngarkuara me mentalitetet e vjetra, me një botë të tyre, e cila për to ishte e vetmja në jetën e gjeratëhershme.

Por këtu u ndeshën me të renë, me heroiken.

U ndodhën afër pukjanet ato ditë prilli, kur tre vullnetarë gjirokastritë, duke rrezikuar edhe jetën e tyre, kërcyen përmbi valët e turbullta të Shkumbinit, vetëm e vetëm që të shpëtonin jetën e një njeriut, i cili po mbytej. Dhe menduan gjatë pukjanet, menduan atje në trase, menduan natën nëpër kapanonet e gjata. Dhe pyetën veten: «Ç'i shtyu ata djem të rrezikonin jetën e tyre për të shpëtuar atë minahedhësin?»

E i thanë shoqja-shoqes: «E ç'i shtyu ata vullnetarë të vinin jetën e tyre në rrezik?»

Ndërsa atje, në sektorin e Dushkut, ato malësoret lezhjane pyetën kur u çuan në mëngjes: «E pse u heqin vrejten atyre, o ti?» Dikush u tha se atyre vullnetareve, atyre vajzave, u hiqej vërejtja, sepse qenkishin çuar natën e kishin punuar jashtë orarit.

Dhe lezhjanet i thanë shoqja shoqes:

«A e more vesh? Qenkan çue natën e paskan punue? Pa u thanë kush? Vetë?.. E!»

Ndërsa me vete mendonin: «E, ç'i shtyu ata... ato»?!

Shkojnë pogradecaret dhe vallzojnë. Pastaj shkon ajo Liljana edhe mundohet e i mëson Gjystes vallzimin. Dhe kalon një ditë, dy, tre e Gjyستا nga ai fshati i Lezhës mendon: «Po kjo, pse i ban këto? Pse i duhet edhe asaj që edhe unë të mësoj me vallzue...?! E...?!»

E nisën pastaj lezhjanet të kërkojnë të presin flokët te pogradecaret, te berataset, te...

Ata vullnetarët e brigadës «Sami Frashëri» të Përmetit s'janë më të rritur se të tjerët; por një natë, kur shiu derdhej nga lart si ujëvarë, dikush prej tyre u hodh në përroin e madh për të shpëtuar

pasurinë e popullit, që po e rrëmbente uji. Atëhere kuksianet pyetën: «Ë pse u hodh ai?!»

Dhe dikush tha: «Ishte pasuria e popullit».

Net të tëra binte shi, po brigada «Sami Frashëri» s'u nda nga fronti i punës, megjithëse disa herë teknikët u thanë që të mos e vazhdonin punën. Shumë herë drita elektrike ishte ndërprerë dhe dritë s'kishte atje ku punohej për të çelur themelet, për të hedhur beton, por vullnetarët e rinj nuk e lanë punën. Mbushën kova me hi dhe naftë e nën dritën e tyre punuan deri në mëngjez. Atëhere matjanet pyetën:

«Po... ç'i shtyu ata të bënin këtë?!»

Përgjigja ishte e njëjtë: jeta jonë, heroika, revolucionarja.

Me këto tipare u ndeshën malësoret tona, me këto akte dhe sakrifica. Dhe tërë këto, dalëngadalë, nisinin e hynin thellë në ndërgjegjen e tyre, zirin vend, shtynin diçka të vjetër dhe ndillnin diçka të re për të shpërthyer. Ndjaj edhe ato, që u nënshtroheshin ligjeve të jetës ashtu si ua servirte e vjetra, nisën të merrnin një qëndrim aktiv ndaj zgjidhjes së problemeve që i preokuponin, në vend të atij qëndrimi të ftohtë me të cilin ishin rritur.

Mbase ende s'janë në gjendje ta formulojnë bukur, por tashmë, këtu, përmes këtij kolektivi kaq të madh, përmes tërë këtyre akteve të guximshme, ato e ndjejnë se qëndrimi ndaj revolucionit socialist është në të njëjtën kohë edhe një qëndrim ndaj dhënjes fund të interesit personal, dhenjes fund të botës së vogël, dhënjes fund të ligjeve dhe zakoneve patriarkale.

Sepse e ndjenin dhe e kuptonin që, të prishnin ato fejesa të padrejta, të ngritura në bazë të zako-

nit të vjetër, të shkelmonin tërë atë nënshtrim, nuk ishte mbase ndonjë akt më i madh se sa ato akte që vërsnikët dhe vërsniket e tyre po kryenin çdo ditë, çdo orë aty pranë tyre. E shihnin se dikush linte edhe jetën për diçka të bukur, për diçka të madhe, ndërsa disa nga ato s'mund të shkëputeshin dot nga një i fejuar që s'e njihnin! Ja, kështu i mëkoi ato heroikja, guximi, i mëkoi aty në kolektiv, në jetë, në aksion.

Ajo që qëndron në krye të këtij guximi, Liza, tha:

— Ka thënë shoku Enver, moj cuca: «Gjithë partia dhe vendi duhet të ngrihen në këmbë të djegin me zjarr e t'i këputin kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave...» Për të drejtat tona flet kështu shoku Enver, moj shoqe. Dhe na, po të na kërcënojë kush, do t'i themi partisë, do t'i themi shokut Enver.

Ej, Lizë, Lizë, si të shikojnë ato cuca ty, si të ndjekin! Se ti nise e para këtë betejë drejt së resë, se ti ishe e para që u shkëpute nga ajo botë ku donin të të ndrydhnin. Andaj thërrasin ato malësoret: «Rroftë rinia heroike edhe Liza komuniste!» «Ndihet fjala e partisë, mu në zemrën e rinisë!» «Ne cucat fshatare, nuk do të shitemi me pare!»

Ishin thirrje të fuqishme ato, thirrje që u grumbulluan së bashku këtu, në qytezat e hekurudhës dhe, si një ortek që shkëputet nga mali, shkëputeshin nga zemrat e tyre.

Dhe çoi fjalë që nga spitali edhe ajo vullnetarja tjetër matjane, Marta: «Erdhi daja në shtëpi dhe i tha babës: «Në Lurë të kam gjetë një dhandër». Baba s'ndigjoi. Ai erdhi përsëri. Përsëri baba s'ndigjoi.

Atëhere ai i tha babës: «Edhe djalin të të kërkojsha, do të ma jepshe, jo ma një vajzë...» «Ta kam fal», i tha baba. Dhe mue më fejuen me një të panjohun nga Lura. Po si të martohem unë me te, oj?!...-

Ndërsa Bukuria i shkruen nga hekurudha këtë letër babait të saj, që jeton në fshat:

«I dashun babë,

Jam fare mirë, dëshiroj që edhe ju të jeni mirë me shëndet dhe me punë... Ne të rejat vullnetare matjane, të mbledhuna këtu në hekurudhë, për të diskutue kundër veseve dhe zakoneve prapanike, pamë se 45 vajza nga ne ishin të fejueme nga prindër që në femini, sipas zakonit të vjetër. Aty doli se këto shoqe, shumica e tyre, as nuk e njifshin fare burrin e tyre të ardhshëm... Ndaj, unë së bashku me shoqet e mia vendosëm njizani që këto fejesa t'i shpallim të prishuna.

I dashun babë! Ju njoftoj se edhe unë fejesën time e shpall krejt të prishun. Me bindje protestoj kundër të gjithë atyne që fejojnë vajzat me ndërresë si mue... Unë nuk jam plaçkë pazari, babë. Ju si prind duhet të mendoni për lumtuninë time dhe jam e bindun se do të bashkoheni me mendimin tim.

Unë ta them edhe një herë, babë, se po që se do të veproni ndryshe, unë do të ankojem deri në parti, deri te shoku Enver.

Përqaftime njimijë herë, vajza juej Bukurie».

Dhe flisnin, lexonin letrat që u dërgonin prindërve, e brohorisnin ato malësore; ishte një brohoritje që zbriti nga malet dhe u mëkua dhe u rrit në trase, atje, rrugicave të qytezave, nëpër kapalone, e shpërtheu aq fort në atë sallën e kulturës, pranë Shtabit qendror në Lushnjë.

* * *

Kishte shkuar vonë. Nata ishte ulur dhe kuvendi ende s'po mbaronte.

Nga jashtë, parvazet e dritareve të sallës së kulturës mbanin ndanë xhameve dhjetëra kuresh-tarë nga vullnetarët që ishin afruar atje për të ndjerë atë shpërthim, për të parë atë hap të madh, të guximshëm.

FITORE DHE GËZIM

Tani jam e rritur, vazhdoj shkollën e mesme, po gjithmonë më pëlqen të kujtoj një ngjarje nga koha kur isha nxënëse e klasës së tetë.

Kishim marrë inisiativën të ndihmonim për elektrifikimin jo vetëm me mbledhjen e hekurish-teve, po edhe duke punuar gjatë muajve të verës për instalimet e brendshme në zonat malore. Rrethin e elektrikistëve e kishim ngritur qysh në fillim të vitit shkollor. As vetë nuk e di pse, po atëhere nuk i kisha treguar gjë nënës, ndoshta ngaqë ajo përgatitej për provimet e shkollës, që do t'i jepte në janar. Kaluan kështu tre muaj. Ishte e shtunë pasdite. Kishim mbaruar mbledhjen e rrethit dhe unë u ktheva gjithë gaz në shtëpi.

— Mama, kam një lajm shumë të gëzuar. Sapo na thanë se u pranua kërkesa jonë për të shkuar në një fshat malor, në Beslicë, për të bërë instalimet.

— Si??! Ç'kërkesë, moj? — pyeti nëna e habitur.

— Po ja, kur doli vendimi për elektrifikimin, edhe ne vendosëm të japim ndihmën tonë, po unë atëhere... nuk ju...

— Po si?! Të shkosh në fshat? Nuk je ti për fshat, jo! E ku, në Beslicë!.

— Çfarë!! Si? Ti... mama... ti... — Ndosh-ta fjalët e mia, që i ngjanin një belbëzimi, nuk i dëgjoj. Unë fola shumë ngadalë. Më fort nuk mund të flisja. Më dukej sikur po më zihej fryma. Nëna ime të fliste kështu! Po pse e kishte ndërprerë bisedën aq shpejt? Ç'gëzim në klasë, ç'hidhërim këtu, në shtëpi!

Nëna mbaroi punët e kuzhinës dhe erdhi përsëri në dhomë.

— Mos u mendo shumë, Teuta, — më tha. — Ti dy orë vete në punë vullnetare dhe, kur vjen në shtëpi, shtrihesh menjëherë, e jo më të bre dhësh fshatrave. Pastaj kur u bërë ti të instalosh?

— Po ne kemi bërë gjithë ato prova; mësuesi i fizikës është shumë i kënaqur. Ne s'kemi mësuar të rregullojmë vetëm hekurin e rrobave, furnellën apo sigurecën, po edhe...

— E di, e di, po ti këtu dhe i bën naze nga njëherë gjellës, ndërsa atje do të hash atë që të të shtrojnë përpara.

U dëgjua një trokitje në derë. Nëna doli jash-të. Ishte teto Lena, komshia jonë, që na kënaqte gjithmonë me historitë që na tregonte.

— Po ja, si të vejë, moj teto Lena, ajo s'di mirë qytetin e jo të vejë aq larg! — dëgjova pas pak zërin e nënës.

— Ti, Marie, mos u bëj merak! — i tha teto Lena. — Tani të gjithë shkojnë. Ç'e gjeti Luizën timë që vajti tre muaj në malësitë e Tropojës? Djali m'u vra në kufi, vetëm ajo më ka mbetur, si dritën e syve e kam, po, kur më tha për aksion, s'ja prisha qejfin.

Sa mirë foli teto Lena! Më ngrohën fjalët e saj. Mbase tani nëna... Oh, si më rrihte zemra. Një buzëqeshje e nënës, një «po» e saj dhe unë... oh... ç'gjëra të mrekullueshme mund të bëja në ato çaste, mjaftonte që të isha me shokët e mi...

— Kur erdhi andej me atë fytyrë të nxirë nga dielli, — vazhdoi teto Lena, — m'u duk me trime, më e fortë, tamam si i ati kur erdhi për herë të fundit nga mali. Vërtet, ne kemi vuajtur, moj Marie, e tani themi që fëmijët tanë të rrinë rehat, po, ama, sikur nuk shkon kështu.

Pas pak nëna erdhi në dhomë. Më shikoi drejt në sy, sikur kishte rënë në mendime të thella, pastaj uli kokën dhe u largua.

Pse s'më tha: «Po, shko, Teuta»? Pse ngul këmbë ende në të sajën?

Babai erdhi vonë atë mbrëmje, kështuqë i ak biseduam fare për këtë çështje. Rashë për të fjetur, po gjumi s'më zinte. Më vinin në mendje të gjitha ngjarjet e atyre ditëve.

«Tani për tani as shokëve s'u them dot që s'më lë nëna», mendova.

Të nesërmen ishte e dielë. U ngrita shpejt për të larë një pjesë të rrobave që kishin mbetur nga e shtuna. Për çudi, nëna nuk më tha: «Lëri, se i laj unë», siç më thoshte gjithnjë pasi laja gjysmën e rrobave. Këtë e bënte sepse mendonte se lodhesha shumë.

Kaloi gati një javë. Një natë i tregova babait për inisiativën tonë.

— Kjo është një inisiativë e mirë. Po ti, Teuta, ke mësuar të instalosh ashtu siç duhet?

— Po, kam mësuar. Dhamë dhe provat. Të gjithë dolëm shumë mirë.

— Po... në fshat, Teuta, ti... s'ke qenë ndo-
njëherë.

— Bashkë me shokët do të kalojmë mirë.

— Do të mësohesh. Duhet të mësohesh. Të mos
na turpërosh as ne, si prindër, as veten tënde.

— E mban mend si u bë atëhere Teuta, kur
e zuri shiu në aksion? — ndërhyri nëna. — Një
javë të tërë s'vajti në shkollë.

— Po, e mbaj mend, — foli me zë të qetë
babai, — po kjo nuk do të thotë se Teuta nuk është
të e fortë.

— Nuk është e fortë. Ja e zuri një shi? Kush
do kujdeset? Kush do ta ndërrojë? Po për t'u tha-
rë? Atëhere erdhi në shtëpi, u tha, u vesh e
prapë...

— Atëhere ju kisha vetëm ju të dy, tani kam
gjithë ata shokë, gjithë fshatarët, — foli unë.

— Ndryshe është kur kujdesen të tjerët,
ndryshe kur kujdesemi ne, — ma ktheu nëna. —
Po të ishte në ndonjë kooperativë këtu afër, atë-
here po, — dhe e shikoi babanë drejt në sy.

Babai i mbante sytë te unë.

— Ne kemi dhënë fjalën, — foli. — Edhe unë
e dhashë. po nuk e mendoja se do të ndodhte
kështu. Në shtator do të bëj lutjen për t'u pranuar
në organizatën e rinisë, pse kështu do më pengosh
ti mua? Më vonë duhet të japim edhe më tepër.
Unë s'ndahem nga shokët! — thashë e vendosur
dhe me një pozë zemërimi.

— Po, shumë drejt flet Teuta, — ndërhyri ba-
bai. — Në klasën e nëndë do të shkojë dhe në ak-
sione, madje jashtë rrethit. Ti e di vetë se ç'po bën
rinia sot. Po edhe tani mund të bëjë diçka, s'ka gjë
se është pioniere, edhe pionierët po punojnë, madje
shumë...

— Atëhere do të jetë më e rritur, — foli nëna me një ton që tregonte se po tërhiqej. Pastaj edhe do të stërvitet.

— Do të jetë më e rritur, po do të ketë punë më të mëdha, — ja ktheu babai. — Vajtja në Beslicë është hapi i parë. Për stërvitjen e saj edhe ne kemi faj. Këtë le ta themi hapur para Teutës, s'ka asgjë të keqe. Sa herë e ke penguar për të shkuar bashkë me shokët e shkollës në marshime! Edhe unë kam pasur faj, sepse s'kam ngulur këmbë deri në fund.

— Unë të thashë më parë, — foli nëna, — shkoi një herë në eskursion dhe pastaj zuri shtratin për një javë.

— E zuri për fajin tonë. Po të ishte e kalitur që më parë, s'do ta zinte shtratin.

Babai s'foli më. Nëna heshti.

— Unë s'ndahem nga shokët e mi. Ata të punojnë për të bërë shumë gjëra të mira, ndërsa unë të rri veç tyre, e pse?!

— Edhe unë s'dua të të ndaj nga shokët, — foli nëna me zë të dredhur. — Inisiativa juaj është aq e mirë, aq e mrekullueshme, sa s'di ç'të them. Edhe mua ma ka qejfi që ti të bësh diçka të mirë për shtetin, po flas vetëm për të mirën tënde. Ju do të rri njëzet ditë në fshat. Ku je e zonja ti?!

— Do ta bëjë, Marie, do ta bëjë. Është trime Teuta jonë, — dëgjova babanë t'i thoshte nënës, kur unë, e mërzitur, kalova në dhomën tjetër.

Më 19 prill, një ditë para takimit kombëtar të pionierëve, Tirana ushtoi nga «uratë» e brohoritjet e pionierëve të rretheve që vinin në takim. Si livadh gjithë ngjyra të mrekullueshme dukej Pallati i pionierëve. Ne prisnim me një dashuri të pakufishme moshatarët tanë të rretheve. Unë mora si mysafire në shtëpi një vajzë nga Borshi i Sarandës. Jetmira e quanin, ndërsa Drita, shoqja ime e ngushtë, mori Dilën, një vajzë nga fshati Beslicë.

Të nesërmen Drita me Dilën më erdhën për vizitë dhe së bashku dëgjuam emisionin e pionierit.

Unë ju afrova më tepër radios kur një pioniere fierake tregoi se klasa e saj kishte marrë iniciativë për të shkuar në zonat malore për punë të elektrifikimit.

Kur ajo mbaroi së foluri, nëna uli kokën dhe buzëqeshi pak. Më dukej sikur diçka e re lexohej në sytë e saj, diçka që më ngrohte zemrën.

Ditën që do të përcillnim mysafirët e rretheve, unë nxora bllokun, ku shënova në disa kopje adresën time për t'ua dhënë katër vajzave me të cilat u njoha gjatë takimit kombëtar.

— Mos harro Dilën, — më tha nëna. — megjithëse me të do të takohesh prapë kur të shkosh për elektrifikim.

Sa u gëzova atë çast! Gati sa s'thirra «urra», siç e kam zakon në raste gëzimi, gati sa s'ju hodha në qafë.

Ditën që do të nisesha, kur po e përqafoja nënën, i thashë mengadalë: «Mirupafshim, nënokja ime. Unë do të kthehem krenare, e fortë, sokoleshë mali».

Ja kështu më ndodhi atëhere.

ËNDËRRA

Gati çdo mbrëmje te hauri i Mete Goxhajt niste atëhere një këngë, këngë labçe nga ato të çobenjve... Mazja ja merrte, ja kthente Minja e pastaj ëmë e bir e zgjatnin me një iso, që dëgjohej në krua e përmatanë zallit.

Një djalë kishte Minja dhe shpirtin jepte për të. Si nënat me fëmijë të vetëm dhe ajo i shkonte pas djalit... Por Mazja kishte tekat e tij për të qeshur.

— Mëmë, vezë të skuqura sot. Mora pesë 1), — dhe Minja tiganin në zjarr.

Nganjëherë djali nuk thërriste që nga lesa e gardhit; ai vinte qetë-qetë nga shkolla dhe me zë të ulët pëshpëriste:

— Mëmë, sot nuk mora pesë, katër mora.

Atëhere Minja e shikonte si me qërtim dhe, duke fshehur një farë gëzimi, i thoshte:

— Nesër mos harro të na marrësh pesë!

Mbrëmjeve Mazja rrinte gjer vonë pranë zjarrit. Minja tirrte, tirrte dhe bishtuku aty mbi vatër

1) Në sistemin e mëparshëm të notave, pesa ishte nota më e mirë.

digjej duke lëshuar një vijë të drejtë tymi, që linte vula mbi trarët e haurit. Kur kolopuçi mbaronte mësimet, mëma linte punën dhe niste kënga, këngë tërë gaz, siç mund të këndojë nëna me djalin e vetëm. E pastaj fillonte një bisedë e këndshme. Mazja thurte ëndërra. Zor të ëndërrosh në moshën nëndëvjeçare, por ja që Tahmazi ëndërronte. Jo për t'u bërë pilot, as për të rrokur hënën, mësuës donte të bëhej Mazja.

— Mëmë!

— Shpirti i mëmës!

— Kur të rritem, do të bëhem mësuës.

— Mësuës bëhu, të keqen!

— Do të vete nëpër shkolla të mëdha, moj mëmë!

— Pa dale një herë. Mua ku do të më lësh?

— Po jo, moj mëmë, jo. Do të mbaroj shkollën në fshat një herë, pastaj do të shkoj në unike, 1) pastaj në qytet, kur të mbaroj atë shkollën e qytetit do të vij në fshat përsëri.

Minja qeshte nën buzë e zemra i mbushej tërë gaz. Mazes i picërroheshin sytë.

— Atëhere fli, t'u bëftë mëma!

Dhe binin. Minja ndjente frymëmarrjen e të birit dhe i bëhej sikur dëgjonte një melodi të ëmbël, si shushurimë krojesh, si fërfëllimë fletësh. Tërë natën shtrëngonte në gjoks birin dhe ëndërrat e tij.

...Që atë mot Mazja filloi të bëhej mësuës.

Asokohe në Frashnjët u hap shkolla për të rriturit. Të moshuarit atij viti u futën në kurset e LKA²⁾. Hyri dhe Minja. Atëhere e mori ajo em-

1) Kështu quheshin më parë shkollat tetëvjeçare.

2) LKA = Luftë kundër analfabetizmit.

rin doktoreshë. Bëri çantë e bleu syze dhe në atë shkollë dyzetzveçarësh u shqua mbi të tjerët. Në fillim lapsin e shtrëngonte me të pesë gishtrinjtë, pastaj e pati më të lehtë. Së pari shkroi «mali», pastaj «Mine», «Metë», «Maze». Mësonte në mbrëmje, mësonte dhe natën. Mbrëmjeve me mësuesin, natën me djalin. E nisi me krrabëza, por shpejt filloi ta ndreqte shkrimin dhe i qendiste fletoret me lloj-lloj germash. Ja që u mësoka dhe në pleqëri!

Në mëngjez, e niste nëna djalin në shkollë, pasdite djali niste mëmën dhe e porosiste te dera e klasës:

— Mëmë, të na marrësh pesa!

Mësuesi qeshte me gjithë zemër.

Në mbrëmje Mazja priste te lesa. Ja merrte çantën mëmës dhe ja shikonte një për një fletoret.

— Po pse s'passe marrë pesë, moj mëmë? Ooo, dhe ti!

Minen e zinte gazi. Kënaqësia që i ngrohte shpirtin, i dilte ndër buzë.

Dhe në drekë, si mbaronte mësimet e veta, Mazja bëhej mësues i mëmës.

— Ja kjo është «n», kjo «m». Kjo ka një urë, kjo ka dy ura. Shkruaj tani.

Shkruante Minja një radhë, dy... Mazja i rrinte mbi krye dhe si mësues, rëndë-rëndë, herë qërtonte, herë lavdëronte.

Pastaj ja merrnin labçe. E, ç'm'i zgjidhnin ato këngë! Sa u shkonin ato këngë! Pas këngëve thurnin ëndërra. Mazja do të shkonte në shkollën e madhe të qytetit e, si të mbaronte atë, do të kthehej në fshat mësues,

— T'u bëftë mëma, ore Maze! Mësues i vogël i mëmës.

Natën vonë, kur binin për të fjetur, Mazja, duke u kotur, pëshpëriste.

— Mëmë, nesër të na marrësh pesë.

...Mete Goxhaj, i ati i Mazes e i shoqi i Mines, punonte atëhere maleve të Kolonjës e fushave të Delvinës. Tërë jetën ishte munduar Metja, por katërmbëdhjetë kokë dhen s'i kishte bërë¹). Trembëdhjetë e nën trembëdhjetë. Kur u formuan ndërmarrjet blegtorale, i dha rrugë ai dhe hyri çoban në një brigadë dhensh. Me tufat e shtëtit kulloste dhe të tijën e, duke veruar bagëtinë, çoku ja merrte me gojë e me zemër asaj kënge të Maze Merkos.

*Dhent' e Mazes dy-trimijë²)
mbushur një gropë e një brinjë.*

«Trim i fortë e çelik i zoti ka qenë Mazja i Merkajve», — psherëtinte thellë e, si në të ri, nxirrte longarin. Fundin e këngës e merrte me të qarë. Vajtonte me longar:

*Të shkretat se ç'blegërijnë,
gjakn e Mazes ç'e lëpijnë!*

E, pa futur longarin në torbë, i përqafonte ato ftujake e manare sikur t'i kishte fëmijë.

— Ja, ashtu dua të vdes dhe unë, moj korba, si Maze Merkua, në mes të bagëtisë, me blegërima të më ligjërojnë.

1) Flitet për kohën para çlirimit.

2) Mete Goxhaj është rritur në vitet e paraçlirimit me ndjenjën e pronës private.

Kështu u fliste shelegëve Mete Goxhaj, që tërë jetën kishte ëndërruar të bëhej çelnik 1).

«Edhe Mazen tim çelnik do ta bëj».

Me ëndërra të tilla gudulisej këtu e trembëdhjetë vjet më parë Mete Goxhaj atyre brinjave të Kolonjës. 2).

I varfëri çoban s'arrinte ende ta kuptonte se dhentë që kullosnin ditë e net ishin të tijat e të Mazes së tij. Edhe pse e donte atë bagëti përreth, e donte siç duan mëmat e përvëlura fëmijët e botës.

...Lejen vjetore Mete Çobani s'e mori në vejshtë, kur tufat e dhenve qenë kthyer në kullosat dimërore të Delvinës. As gjatë dimrit s'qe dukur ndonjëherë në Frashnjë. Në fund të prillit çoi lajm se vinte filan ditë e filan kohë. Ka qenë zakon i motit që, kur kthehej çobanëria nga dimri, fëmijët dhe graria të dilnin dhe t'i prisnin larg fshatit. Sa që i ri Metja, as dimëroi e as veroi, as u largua, as e pritën. Me trembëdhjetë kokë dhen mbledhej në të nxehëtë e në të ftohtë. Verës në ato copë musha që i caktonte pleqësia, dimrit rreth haurit të tij. Atë vit e bëri ferë Metja me atë zakon çelnikësh e zemra ja desh që zakoni t'i mbe-tej shtëpisë mot pas moti e brez pas brezi.

Mazja dhe Minja e pritën në Skërficë. Veç të shihje atë mbrëmje, kur bëri ballë tufa në Gur të Mokrave. Plla e shelege e zbardhonin një copë vend. Tringëllinin këmborë e zile dhe dashi me bipe shkante në krye të beharit me kësulë e krribë. Beli çoban i Frashnjëtit!

1) Pronar i madh dhensh.

2) Ëndrën për të pasur një kope dhensh.

Minja shtroi belcet me theke atë natë. Metja pruri shelegun më të mirë dhe e shkoi në hell. Erdhën pastaj miq e fqinjësia.

Mësuesi në krye e më plaku karshi. Më t'u ngreh një muhabet, që s'e kishte parë konaku ndo-njëherë. E kur të dëgjoje, një labçe, dy dhe isoja gjëmonte.

Ja mbante dhe arësimitari, një «normalist» nga ata të Elbasanit, dhe habitej Metja me ison e gegës.

Gotë pas gote, kënga nxori këngën dhe tingujt vajtën dhe qëlluan drejt e mu në zemër të Metes.

Pastroi mirë gurmazin dhe e nisi «Maze Merkon». Sytë i mbylli, kokën e mbështeti në pëllëmbë dhe krahun mbi gjunjë, këndonte a s'këndonte; kryetari ja kthente me grykë, të tjerët ja mbanin e Metes ju bë dhen dynjaja. Ai pas dhe Mazja pas tufës.

— Iso, ore, iso!..

Dhe isoja si moti, Metja e merrte me të prera, duke mëshuar në fund gjithë afsh, sikur nxirrte pjesë të zemrës nëpër këngë.

*Mbushur një gropë e një brinjë,
të shkretat se ç'blegërijnë!*

E pastaj mbytej në këngë çobani. «Isoja» i bëhej blegërimë. Tufa ngjitej përpjetë «Shurit», shpërndahej lëndinave... dhe fundi me të qarë.

*Të shkretat se ç'blegërijnë,
gjakn e Mazes ç'e lëpijnë! 1)*

1) Të dhënë pas pronës e pas pasurisë bëhej shkak vrasjesh e gjakderdhjesh, burim i mjaft të zezave. Këtë vetëm tani e kupton Metja.

Në të sosur u drodh Metja, me zor e mbaroi këngën dhe u përmend i trembur. Djali rrinte pranë, mbështetur te gjuri i tij dhe ja kishte ngulur sytë në fytyrën e trishtuar. Ai zuri të lëmonte flokët e Mazes. Malli e kishte djegur.

Pastaj nisën bisedën. Dukej se Metja mezi kishte pritur që djali t'i bëhej nëndë vjeç e të këshillohej me të.

— Po ti, o xhan i vogël, a do t'i bëhesh çelnik babait?

— Jo, baba, unë do të bëhem mësues me pedagogjike.

— Ç'janë këto «pedagogjike», more! Çelnik të bëhesh! — foli Metja me zë të fortë.

Të ftuarit i tërhoqi ky bashkëbisedim.

— Mësues do të bëhem, baba, mësues me shkollë të madhe. Kështu thotë dhe mësuesi ynë.

— Po ku do të gjesh poture e setër të leshtë pastaj? Ku do të gjesh pastaj djathë e gjalpë, kos e dhallë, këmborë e zile? Ku do t'i gjesh, more jezit? — foli Metja si me shaka, si me të nxehur.

Atëhere hyri arësimitari në bisedë.

— Edhe mësuesit s'kanë mbetur zbathur e zhveshur, o shoku Mete! Sa për çelnik, çelnikëve u shkoi koha; tjetër puna e çobanit, pastaj. Po ç'bëri çobani, ç'bëri mësuesi. Kanë diçka që i afëron. Njëri rrit e ruan bagëtinë, tjetri rrit e mëson fëmijët. Mësues le të bëhet djali, meqë i dashka zemra.

— E, or gegë, gruan ma bëre të librit e të kalemit, edhe Mazon tani do ta bësh si veten. Po unë, Mete Goxhaj, s'paskam të drejtë ta bëj djalin çelnik?

— Jo, jo, baba, unë mësues do të bëhem, — foli i vogli duke ngulur këmbë në të vetën.

— Çelnikëve u iku koha, o shoku Mete, — foli kryetari Hyso. — Ata qenë dikur, kur pasuria u hante kokën njerëzve dhe u lëpinte gjakun bagë-tia pastaj.

Këto ju ngulën thikë në zemër Metes, të dri-dhura ja përshkuan trupin, foli dhe të tjera krye-tari, po çobani s'dëgjonte më.

— A s'kam të drejtë? — pyeti kryetari Hyso, në fund.

— Të drejtë ke.

— Le të bëhet mësues djali, se na duhen edhe arësimitarë nga fshati.

— Kështu, eee, — mërmëriti babai i mundur, — le të bëhet, pra! Çoban fëmijësh le të bëhet. Ja, unë hoqa dorë nga imja, por me ndihmën e partisë dhe të qeverisë, ama.

— More, mukajeti yt të jetë, pa s'kursehen partia dhe qeveria.

— E bërë qoftë!

Plasi gazi atëhere. Të gjithë qeshën. Qeshi dhe babai me gjithë zemër.

Kështu rrodhi biseda atë natë në shtëpinë e Mete Goxhajt. Kryetari Hyso, njeri me dy barrë mend, që i peshonte fjalët në kandar, ngriti gotën e foli:

— Mosha jonë e dora jonë në errësi u tërhoq qysh këmbadorazi, honeve na shkoi rinia. Të thur-nim ëndërra, as ndër mend s'e patëm në fëmijëri. Hyzmeqar ose kaçak, mos njëren, tjetren, e kishim të siguruar. Edhe ti, o shoku Mete, që gjithë jetën të bëheshe çelnik pate ëndërruar, u bëre nishan me trembëdhjetë berrat e tua. Mazja ëndërron të bëhet

mësues. Do të bëhet! Sot kemi parti e qeveri, diell e dritë që ndriçon rrugën e fëmijëve tanë. Cuni sa të rritet mund të ketë dhe dëshira të tjera. Por cilado qoftë më e bukura ëndërr e fundit, ajo do të plotësohet se s'bën.

— Si thoni, shokë?

— Të drejtë **ke, o Hyso.**

— Epo ta ngremë këtë dolli për Maze mësuesin, pra, për partinë e qeverinë, që i bëjnë të rinjtë të thurin ëndërra të bukura!

U ngrit pastaj dollia me tri shëndete.

Nata shkonte e vallja krisi, e si në valle gjëmoi shtëpia e dhentë u përzien në vathë. Kërcente Metja dhe Hysua, mësuesi dhe miqtë, gjithë bashkë. Valle burrërishte e grarishte, sipas atij që hiqte në ballë. Kur erdhi radha e arësimitarit, atëhere ai ju lut ta falnin, se akoma s'ua kishte marrë anën valleve të Labërisë. Doli kryetari pastaj në krye. Për t'ja mbajtur, ja mbajti vetë gega; dhe Mete Çobani aty për aty ngriti këngën, si veç labi di të ngrerë:

*Deli, moj thëllëza, deli,
po hedh valle Hyso Çeli,
Hyso Çeli kryetari,
se ç'ja mbante arësimitari,
arësimitari geg me halle,
na mësoi të hedhë valle,
të hedhë valle Labërie,
obobo, ç'm'i paska hije!*

Kërceu mësuesi dhe mendja i mbeti te kënga e Metes. Shastisi pas vargjeve të atij vjershëtari, që pranë e kishte e s'e shihte, me të bisedonte e s'e

njihte 1). «Sa ëndërra s'u plotësuan, sa ëndërra s'u ëndërruan!» — pëshpëriti arësimitari. E, duke fshirë djersën, ju drejtua të zotit të konakut:

— Të lumtë goja, o Mete Goxhaj!

— Dhe ty të lumshin këmbët, o gegë! Gjynah që s'të pata njohur deri më sot! Më ke gëzuar sa s'bëhet.

— Në dasmën e Mazes do ta tundim.

— Në plotësimin e ëndërrës së Mazes më parë e pastaj në dasmë, — shtoi kryetari.

Të gjithë qeshën dhe gëzimi mbushi shtëpinë. Vonë, kur u ndanë, mësuesi, si u përshëndet me të shtëpisë, e mori grykë Mazen e kolopuçi ja mbërtheu duart në qafë e s'i shqitej.

«Mësuesi i madh dhe mësuesi i vogël», — murmuritën të tjerët.

Gjithsekush u largua duke ndjerë përbrenda një afsh që i ngrohte shpirtin.

...Sa vite kaluan që atëhere! Sa male e fusha brodhi mësuesi! Sa qafa e përrenj kaptoi! Ngado e ngjeshi baltën e mëmëdheut, por kudo që vajti, dije përhapit e dëshirë për mësim ngjalli.

...Lexues, ti sa herë e ke parë atë duke ngjitur trenin me ngut, çizmet gjithë baltë e mushamanë krahut. Ke biseduar me të në kabinë, e veç për nxënësit ai të foli. Mos u mërzit. Ajo është puna e tij, të ngjallë ëndërra të reja dhe të shendohet kur t'i shohë të plotësuar ëndërrat që mbolli dikur.

Ja, në atë shkollë buzë hekurudhës jep mësim ai. Në atë portë trokiti para ca ditësh postieri.

1) Mete Goxhaj është rapsod i talentuar. Me aftësitë që kishte, ai duhej të ëndërronte që të bëhej poet. Shoqëria e vjetër e pat ndrydhur bariun. Atij as ndërmend s'i ka shkuar kjo gjë.

Ishte nëndor, mëngjez. Mësimi sa kishte filluar. Dikush trokiti në portë. Me vonesë e hapi mësuesi derën.

— Një letër, shoku arësimitar.

Një zarf me adresë të ndrequr disa herë. Nga s'kishte bredhur letra! Po zemrat e kishin gjetur zemrën.

Mësuesi shtangu.

Dërgon

Maze Goxhaj

Shkolla shtatëvjeçare

Frashnjet

Lexoi përsëri adresën. S'kishte gabuar. E hapi me ngut atë zarf. Një ftesë dhe një letër. Hodhi sytë mbi kartvizitën: një shkrim prej dore të pamësuar.

I dashur mësues:

Të mërkurë, më 8 nëndor 1961, martojmë djalin tonë, Mazen, me arësimitaren Kuçupe Nora.

Ju ftojme të na vini e të na nderoni. Do të na ndriçoni shtëpinë. Ne s'ju heqim nga goja, ju presim krahëhapur.

Mehmeti — Emineja.

Ai buzëqeshi për një çast dhe pyeti i hutuar:

— Sa kemi sot?

— 10 nëndor!

U vrëjt arësimitari. S'e deshi atë përgjigje
«10 nëndor», por...

U hutua pak dhe më pas urdhëroi:

— Zgjidhni këto detyra.

Me ngut shkroi detyrën. Nxënësit s'u ndien.
Ata në heshtje kopjuan, në heshtje filluan punën.

Mësuesi u ul në tryezë. Si mblodhi veten, zuri
të lexonte letrën e arësimitar Maze Goxhajt. Malli
e kishte marrë për kolopuçin dhe ai na paskësh
mbaruar Institutin pedagogjik.

Kështu duhej të ndodhte.

Lexoi dhe më poshtë. Fytyra i çelej. Buzëqe-
shte dhe murmuriste.

«Mazja dhe Kuçupja, nxënësit e tij më të mi-
rë». Koka i ishte mbushur gjithë përfytyrime,
mundohej ta imagjinonte atë dasmë në Frashnjet,
dhe shpesh i përfytyrohej mbrëmja e gëzuar në
shtëpinë e Mete Goxhajt. Pastaj çdo gjë në rregull.
Ja, një dasmë Labërie nga ato që shpesh kishte
jetuar, gjithë gaz e këngë. Por, kur donte të sillte
parasyshtiftin e ri, ngatërrohej përsëri. Mazja dhe
Kuçupja i dilnin gjithnjë të dy të vegjël, nxënës
në klasë të tretë, në bankë të tretë.

UNË, BABI DHE SHOKËT E MI

Shtëpia jonë ndodhet në katin e pestë dhe, për të hipur gjer atje lart, unë ngjit nëndëdhjetë e tre shkallë. Gjyshit s'i pëlqen shtëpia jonë, ose, më mirë, kati ynë, prandaj nuk vjen shpesh te ne. Ai thotë se është më lehtë të hipësh në majë të një kodre se sa të ngjitësh gjithë ato shkallë. Gjyshi ka të drejtë, sepse është plak dhe vuan nga reumatizma. Kurse mua, babit dhe mami na pëlqen shumë shtëpia atje ku e kemi. Bile mami nuk do që t'ja shash katin. «Jemi përbukuri këtu lart; as pluhur, as zhurmë, si në majën e malit të Dajtit» thotë ajo. Këto fjalë i përsërit mami sa herë që ndonjë guxon t'i shajë katin. Po nganjëherë dhe mami t'i vjen mirë që e kemi shtëpinë në katin e pestë. Këtë e di vetëm unë. Kjo ndodh zakonisht në muajt e dimrit. Dhe kur, thoni ju? Kur vjen puna për të ngjitur drutë.

Sa herë që babi pret faturën e druve, mami dhe babi rrinë në shtëpi pasditeve. Mirëpo një ditë, kur erdhën drutë, ajo nuk u ndodh aty. Kishte vajtur te një shoqe e saj. Në shtëpi ishim vetëm unë e babi. Rrinim në kuzhinë. Babi po shkruante, se do të shkonte në një mbledhje, kurse unë vizatoja.

Ishte qetësi e madhe. Vetëm zjarri, siç thotë gjyshi, bubullonte në sobë. Por, papritur e pakujtuar, trokiti dera. Dikush i ra derës disa herë me të madhe. «Kush i bie kaq fort?» thashë unë me vete, kurse babi e kuptoi dhe thirri:

— Janë drutë.

Unë lashë vizatimin dhe vrapova të hapja derën.

— Piçiruk, faturën e druve, — më tha një djalë i gjatë, me flokë kaçurrela. Babi e dëgjoi prapa meje dhe ju përgjegj:

— Faturën jua jap unë, po mund të na ndihmoni pak?

Ai djali nuk priti e, duke ikur, tha:

— Ne nuk ngjitim dru, po shikoni se janë disa djam poshtë. Ata mund t'jua ngjitin.

Babi nuk foli më. As mua s'më tha gjë, po unis menjëherë të zbriste poshtë: i vajta pas dhe, duke zbritur shkallët, mendoja: «Si do t'ja bëjmë? Babin nuk e pret puna».

Kur zbritëm poshtë, pamë në oborin prapa pallatit tonë maqinën e druve dhe gjithë ata fëmijë mbledhur përçark. Shoferi rrinte te timoni, me kokën të nxjerrë jashtë. Ai djali me flokë kaçurrela shkarkonte drutë. Babi i dha shoferit faturën dhe u kthye pastaj nga unë, duke qeshur. Ai nuk më tha gjë, po unë e kuptova. Babi ishte në hall. Dëgjova kur i tha mamit se në ora gjashtë kishte mbledhje. Të prisnim mamin të vinte, apo t'i fillonim vetë? Babi nuk foli gjersa u shkarkuan drutë. Kur iku maqina, ai më tha:

— Tani forca, Ilir, t'i ngremë!

Unë i thashë Tanit:

— Tani, hajde më ndihmo një çikë!

— Babi i Ilirit, — tha Tani, — do t'i ngjitësh drutë shpejt? Thuaj Ganiut.

Babi shikoi nga grumbulli i çunave dhe pyeti:

— Kush vjen të na ndihmojë pak?

Në fillim nuk foli asnjëri. Bënë sikur nuk dëgjuan. Mua më erdhi inat që nuk ua vunë veshin fjalëve të babit tim. Koçua hodhi topin përtokë dhe zuri të lozte me të, gjoja nuk dëgjoi. Nja dy çuna, që nuk i njihja, ikën fare. Gjithë të tjerët s'flisnin, sikur ta kishin bërë me fjalë.

— Vij unë, babi i Ilirit, — u dëgjua papritur zëri i Artanit. Artani është djali i xhaxhi Taqos, fqinjit tonë.

— Jo ti, xhani i xhaxhait, se je i vogël e lodhesh, — tha babi dhe nxori paqetën e ndezi një cigare shpejt e shpejt. Babi vërtet kishte rënë në hall, dhe mua më vinte keq. Po më shumë më vinte inat me çunat. Disa nga ata ishin shokë të mi. Në vend që të rrinin ashtu kot, le të vinin të na ndihmonin. Me mendje thosha: «Mirë, mirë, do të keni nevojë dhe ju ndonjë ditë, po ta shihni, po ju ndihmova»!

Babi hodhi cigaren dhe pyeti:

— Cili është Ganiu?

— Unë jam, — tha me zë të lartë Ganiu, që rrinte në mes të çunave.

— Si thua, do t'i ngjitem? — i tha babi me buzë në gaz.

— I ngjitem, po duam pesë lekë.

Babi desh t'i thosh diçka, po nuk foli, veç mbaj mend që u vrejt në fytyrë. Mua më erdhi plasja, sepse me Ganiun kisha luajtur futboll, pas-taj ishim në një shkollë. Unë nuk do ta bëja kurrë këtë. Po nuk i fola gjë, se babi i tha:

— Mirë, po vetëm do t'i ngjitësh?

— Jo, — ja pritni Ganiu duke e parë babin në sy, — jemi plot! — Ai zuri të numërojë me gisht: — një, dy, tre, katër... dhe unë!

Unë i njihja dhe të tjerët! Qenë Vaska, Kadriu, Kozmai dhe Ademi. Ata ishin shokë të Ganiut dhe e dëgjonin atë për çdo gjë. Ata e donin Ganiun, se zinte gardalina me kafaze. Ai kishte shumë gardalina në shtëpi dhe i shiste me lekë. Kurse atyre që i kishte shokë, ua falte, nuk u merrte fare para. Shokët i bindeshin Ganiut, prada kur ai tha: «Hajdeni, çuna, t'i ngjitem», ata filluan menjëherë të ngrinin drutë. Babi u habit kur ata të katër ju bindën shokut të vet, po nuk foli. Filloi dhe ai të merrte dru, dhe, pas tij, unë me Tanin. Kështu u bëmë gjithsej tetë vetë. Ja vinim drutë njëri tjetrit në duar dhe ngjiteshim varg gjer lart. Babi merrte më shumë nga të gjithë. Pastaj vinte Ganiu. Ai ishte më i fortë dhe më i shpejtë nga të gjithë ne. Babi, sa herë e ndeshte nëpër shkallë, e qërtonte:

— Jo kaq, djalë i mbarë!

Po Ganiu nuk dëgjonte. Ai ngarkohej si kalë, gjer te hunda, dhe prapë nuk lodhej. Po dhe të tjerët punonin sa mundnin.

Më vinte çudi kur shihja se të gjithë i ngjiteshin shkallët të gëzuar, sikur të ngrinin drutë e veta e jo tonat. Secili mendohej t'ja kalonte tjetrit dhe secilit ja kishte qejfi ta shihte të ngarkuar babin im. Babi u buzëqeshte të gjithëve u përkëdhelte kokën, ose thoshte: «Rri ti, mos merr më, se je djersitur shumë». Ai mbylli gjithë dritaret e shkallëve që të mos na binte era kur ngjiteshim lart.

Kur i ngjitëm të gjitha drutë, babi i futi të gjithë çunat në dhomë dhe vetë shkoi në kuzhinë. Ata u ulën nëpër karrige dhe në divanin e madh, kurse unë qëndrova në këmbë, afër derës. Isha shumë i gëzuar, sepse asnjëherë nuk më kishin ardhur në shtëpi kaq shokë. Ata shikonin bibliotekën dhe fotografitë nëpër mure dhe, me sa dukej, u pëlqente shtëpia ime.

Ganiu pa fotografinë e madhe të varur në mur dhe më pyeti:

— Po ky, kush është?

— Gjyshi! i thashë.

— Gjyshi! — thirri ai. — E paske patur të bukur gjyshin!

Mua më erdhi mirë që Ganiu më lavdëroi gjyshin, dhe desha t'i thosha se tani gjyshi është plakur dhe s'është më i bukur, siç ka qenë, po ma morri fjalën Kozmai:

— Ne s'kemi fare fotografi të gjyshit, — tha ai.

— Gjyshi im ka qenë partizan, — tha Kadriu. — Ne kemi një fotografi të tij, ku ka dalë me xhaxhi Enverin.

Kështu, të gjithë zunë të flasin për gjyshërit e tyre, duke treguar se ç'ka qenë njeri dhe ç'ka qenë tjetri. Unë bëja ç'bëja dhe shikoja gjyshin tim në mur. Atë ditë po më pëlqente sa asnjëherë tjetër.

Kur hyri në dhomë babi, ne e ndërpreme bisedën për gjyshërit. Ai ishte i qeshur dhe unë kisha qejf ta shikoja gjithnjë ashtu.

— E, — pyeti ai, — u lodhët ca?

— Jo! — ja priti menjëherë Ganiu, — jemi çapajevë ne.

— Ju faleminderit, — tha babi.

Ai kishte marrë me vete kupën e karameleve dhe ma zgjati mua:

— Na jepu shokëve. Merrni nga tri secili.

Babi shkoi prapë në kuzhinë dhe, kur u kthye, u ndau të gjithëve nga një grusht arra.

Çunat i merrnin arrat si me turp dhe thoshin: «Falemnderit!» Vetem Ganiu nuk pati gajle, e pa babin në sy dhe, shpejt e shpejt, provoi të thyente një arrë me dhëmbë.

— Qenkan gunga, dreqkat! thirri Ganiu.

— Jo me dhëmbë, se të prishen! — e këshilloi babi.

— Ku pyesin dhëmbët e mi! I kam çelik unë!

Babi nuk bisedoi më për dhëmbët e arrat, dhe fjalët e fundit të Ganiut bëri sikur nuk i dëgjoji. Unë e di se, kur babi nuk të vë veshin, kjo do të thotë se atij nuk i pëlqen ajo që thua. Prandaj ai e la Ganiun dhe filloi të bisedonte me çunat e tjerë. Babi i pyeti me radhë se të kujt ishin dhe në ç'klasë mësonin. Në fund, ai tha:

— Kjo punë që bëtë sot është për t'u lavdëruar. Ju lumtë! Unë do të dëshiroja që këtë gjë ta vazhdonit. Pallati ynë ka nevojë dhe për ndihmën tuaj. Ti, Ilir, — më tha ai, — që sot e tutje u je borxhli të gjithë këtyre. Dëgjuat, mos kini turp! Sa herë që t'ju vijnë drutë, thërrisni dhe Ilirin.

Kur tha babi kështu, unë ula kokën dhe nuk fola, sepse të gjithë shikonin nga unë. Pas kësaj, u bë një pushim që mua m'u duk një orë. Nuk flisnin as babi, as çunat. Unë shikoja me bisht të syrit.

— Xhaxhi Leka! — ky ishte zëri i Vaskës, që rrinte afër mësje, dhe babi, sa e dëgjoji ktheu kokën.— Ne nuk i duam lekët... Ne nuk deshëm...

Vaska nuk e mbaroi fjalën, sepse diçka e shtrëngoi në grykë. Të gjithë sa ishim në dhomë, kthyem kokën nga ai. Vaska kishte ulur sytë dhe qepallat i dukeshin si të kolisura. Unë pashë nga babi, mos ishte habitur dhe ai si të gjithë ne të tjerët nga fjalët e Vaskës. Babi nuk tha gjë në atë çast, po, ashtu siç foli pastaj, as me të qeshur, as me seriozitet, donte të thoshte se dhe babin e kish-te çuditur Vaska.

— Ju lumtë, djem! — tha babi.— Kështu vep-rojnë pionierët. Punët e mira as blihen, as shiten me para.

Babi fliste dhe sytë i mbante nga Ganiu. Ganiu, si dëgjoi këto fjalë, uli kokën, po unë i vija re mirë sytë e tij të hapur dhe nofullat e shtrënguara. Mua se si më vinte kur e shihja ashtu Ganiu. Më vinte edhe keq, edhe mirë. Nuk e kisha parë ndonjëherë ta ulte kokën, aq më tepër në sy të gjithë atyre çunave. Papritur, më kapi një frikë e madhe. Thashë me vete: «Kushedi se ç'do të bëjë ky tani!» Mund të shante shokët, pa mund të hidhte edhe arrat te këmbët e mia dhe të ikte me vrap.

Unë pashë nga babi dhe vura re se ai ishte vrëjtur në fytyrë. Kjo donte të thoshte se dhe babi e ndjente veten ngushtë si unë.

— Gani, — tha babi, — ngrije kokën dhe ti si shokët.

Ganiu e ngriti menjëherë kokën. Unë mora frymë i lehtësuar. Atëhere dëgjova Kadriuun që tha:

— Xhaxhi, as Ganiu nuk i do paratë...

Të gjithë çunat shikuan nga Ganiu. Ai, për çudi, nuk e uli kokën, por papritur u skuq e u bë

flakë nga turpi. Mua më erdhi shumë keq, dhe jo vetëm mua, po të gjithëve. Ganiu nuk e kisha parë kurrë të bëhej ashtu si lulekuqja dhe doja që kjo gjendje të kalonte sa më shpejt.

Ne rrinim të gjithë si të hutuar. Asnjeri nuk dinte se ç'do të bëhej më tej. Tërë shpresën e kisha te babi. Në këtë kohë, babi i qe afruar bibliotekës dhe kishte marrë një libër në dorë.

— Gani! — tha babi duke i zgjatur librin.— Dua të të jap këtë libër si dhuratë për të kujtuar ditën e sotme. Nuk besoj që shokëve të tu t'u vijë keq, që ta jap ty. Zëre se ua kam dhënë të gjithëve, apo jo, djema?

— S'ka gajle, s'ka gajle! — ja bënë të tjerët, gati me një zë, të gëzuar që çdo gjë po përfundonte aq bukur.

Pastaj babi shtoi:

— Këtë libër të mrekullueshëm e ka shkruar një shkrimtar shumë i dashur për fëmijët, Arkadi Gajdar quhet.

Ganiu mori librin dhe e shtrëngoi në gjoks. Ai rrinte palëvizuar, si i ngrirë. Ne e shikonim atë libër nga larg, sikur të mos kishim parë ndonjëherë libër me sy. Babi qëndronte në këmbë, me fytyrë të qeshur.

Nuk kaloi shumë, dhe çunat u ngritën. I pari u ngrit Vaska:

— Ne do të ikim tani, xhaxhi Leka.

— Si të keni qejf, — tha babi dhe i zgjati dorën. Pastaj u dha dorën të gjithëve me radhë, duke i thënë secilit: Faleminderit!».

Dorën ua jepja dhe unë, po më vinte për të

qeshur, se ata ishin shokët e mi dhe ne s'ishim mësuar t'i jepnim dorën njëri tjetrit.

Pasi ikën çunat, babi u vesh e shkoi në mbledhje, ndërsa unë ju vura punës. Kjo ishte hera e parë që i vendosja vetë drutë në depo dhe fshija koridorin. Kështu, kur erdhi mami, nuk kishte mbetur asnjë punë pa u bërë.

«KRUSHQIT»

Atë ditë babai u kthye nga kuvendi i burrave me fytyrë të vrarë. Pa hyrë mirë në shtëpi, i thirri nënës:

— Grua, më bëj gati bukën; do të shkoj gjer në qytet të marr pleh kimik për kooperativën. Sonte mos më prit, se nuk arrij dot të kthehem, do të fle atje.

Unë dhe Neta, motra ime, dolëm në shkallë. Babi e pa Netën një copë herë, sikur kishte kohë pa e parë dhe, kur nëna solli bukën, i tha:

— Tani je e lirë. Dhashë fjalën në kuvendin e burrave se fejesën tënde me Mersinin e quaj të prishur.

Neta zbriti shkallët fluturimthi, si një zogëzë që del nga kafazi në ajrin e lirë, dhe ju hodh baba-bait në qafë. Ai e puthi, i lëmoi flokët e verdhë dhe iku pa e kthyer kokën. Siç duket, nuk deshi që ne t'ja shihnim lotët që i rrodhën nga gëzimi. Nëna mbeti si e shtangur mu në mes të oborrit, pa guxuar të fliste. Neta, që ju hodh në qafë, e solli në vete.

— Avash, se më dërmove, moj leshprerë.

— Jam e lumtur, nënë!

— Ashtu qofsh! — i tha ajo duke fshirë sytë me cepin e përparësës.

Pas nënës e kisha radhën unë të duroja për-qafimet e Netës. Nuk e kisha parë kurrë aq të gë-zuar.

— Nesër Neta do të të blejë një palë këpucë të reja,— më tha duke më mbërthyer komçën e trikos.

— Neta, a të të them një fjalë?

— Folë, xhan i motrës.

— Do që të më përqafosh edhe një herë?

— Po, — buzëqeshi ajo.

— Atëhere premtomë se do të më blesh edhe një këmishë të re, se ajo tjetra m'u gris dje duke luajtur me top.

Motra më pushtoi përsëri, dhe unë fitova kë-shtu një këmishë të re.

Kur u futa në dhomë, mendova me vete: «Pse babai nuk e bëri këtë më përpara? Ka një vit e shkreta Netë që punon natë e ditë e qan. S'e do të fejuarin që s'e do! Pastaj, kush është ky njeri? As Neta, as nëna, as unë s'e kemi parë kurrë. Vetëm babai tha: «Është djalë i mirë!» dhe kaq. Dhe unë e mbaj mend edhe tani shpullën që hëngra atëhere nga babai, kur i thashë: «Baba, Neta nuk do të fe-johet. Ndaje! Pse e bën të qajë kot? Kur qan ajo, më vjen dhe mua të qaj!».

Babai, pasi hëngri bukë shpejt e shpejt, shkoi për në qytet të merrte plehun kimik. Në të ikur ai, edhe ne shtruam bukën e u ulëm në sofër. Ne-ta, që më parë mezi hante dy kafshata, llufiti plot dy pjata me supë. Kur po mbaronim së ngrëni, di-kush trokiti në portë mengadalë. Nëna e hapi, dhe brenda hynë shtatë burra. Njerin e njoha: ishte

mblesi i Netës, ai Lili që i kishte sytë gjithmonë të skuqur nga rakia.

Neta, kur e pa, u bë dyllë e verdhë.

— Si u ngryse, moj zonjë e shtëpisë? As bujrum nuk po na thua, — i tha mblesi nënës, që po rrinte si e hutuar.

— Urdhëroni! — i tha nëna me zë të mekur.

— Ku e ke të zotin e shtëpisë?

— Ka shkuar gjer në qytet.

Ata nuk pyetën më, po shkuan në dhomë. Neta deshi të dilte, po mblesi e kapi fort për supi duke i thënë:

— Ku vete, moj shqerrkë? Ne për ty kemi ardhur.

— Unë s'kam punë me ju!

— Po kemi ne me ty. Mos kujto se yt atë e dha me gjithë mend fjalën sot në kuvendin e burrave? Ai foli ashtu sa për t'u hedhur të tjerëve hi syve; ne nuk e prishim krushqinë.

— Gënjen, grabitës! — i thirra unë që nga qoshja ku isha strukur.

— Pusho, ti, mi — ulëriu mblesi.

— Hajde, se nuk kemi kohë; bëjeni gati vajzën, se do ta marrim që sonte. Në shtëpi na presin dasmorët me raki e me mish të pjekur.

— Pa qenë burri, unë nuk e jap vajzën, — u tha nëna. — Pastaj, ajo nuk e do të fejuarin.

— Po paratë, i deshët? — u zgërdhi mblesi.

— Merrini paratë, ja ku i keni, — u tha Neta, duke hedhur te këmbët e tyre një tufë kartmonedhash të reja, që i nxori nga sënduku.

Mblesi i pa me vërejtje kartmonedhat e shpërndara në dyshemenë e dhomës dhe tha:

— Ato nuk na duhen më; bëje gati vajzën, —

ju drejtua ai nënës, — dhe mos e zgjat; ndryshe i lajmë hesapet me këtë, — dhe i tregoi pushkën e shkurtër që kishte me vete.

— Unë vdes, dhe me ju nuk vij! — foli e inatosur Neta.

Ajo nuk do të kishte shkuar me të vërtetë, po forca e gjashtë burrave e mposhti. Ata e mbërthyen përduarsh e për flokësh dhe po përpiqeshin ta merrnin zvarrë. Nuk durova dot dhe dola duke qarë nga dhoma. «Ah, sikur të kisha mundësi ti lajmëroja shokët e të shikonin pastaj këta të poshtërit se ku do të futeshin. Vetëm nuk jam i zoti ta mbroj motrën, që po ma rrëmbejnë».

Kur dola në divan, nga brenda u dëgjua një zë i trashë burri:

— Mos ka ndonjë dalje tjetër e na ikën ai laneti?

— Mos u bëj merak, Mersin, dalje tjetër nuk ka, ndërsa nga porta s'del dot njeri, ti e di.

Vërtet nuk dilja dot. Pranë portës, ulur në oborr, ruanin dy burra. U mbylla në dhomën ku flinim, dhe rashë përmbys mbi jastëk. Ç'të bëja? Edhe sikur të bërtisja, nuk do të më dëgjonte njeri, se shtëpitë e fqinjëve ishin larg. Le që «krushqit» do të ma mbyllnin gojën. M'u kujtua diçka tjetër. Fshiva lotët me kurrizin e dorës dhe u futa në dollapin e madh. Atje rrinte varur pushka e babait. Sa herë e kisha fshirë atë pushkë bashkë me babanë! Me të kisha qëlluar vetëm një herë, atëherë kur erdhi në fshat drita elektrike. Po, ama, ma kishte mbajtur babai, ndërsa unë vetëm kisha tërhequr këmbëzën. Tani do ta provoja të shtija vetë. E dija se me tri të shtëna pushke mblidhej gjithë fshati. Ky ishte sinjali i alarmit. E mora

pushkën me duart që më dridheshin. I dija të gjitha pjesët e saj, dija dhe ta mbushja, po, të them të drejtën, kisha frikë të shtija. A do ta mbaja dot? Koha s'priste. I futa fishekët te gusha e pushkës dhe e vendosa këtë në dritaren e vogël të dhomës. E lidha fort pas hekurit të dritares, që të mos më shpëtonte nga dora, mbylla sytë dhe shtira...

Një krismë çau ajrin dhe një dritë ndriçoi për një çast errësirën e natës.

«S'qenka dhe fort e zorshme», — thashë me vete; djersa më shkante çurk, dhe shtiva shpejt e shpjet edhe dy herë të tjera.

Në dhomë ja behën «krushqit» si të çmendur.

— Kush të tha të shtiesh, kush? — Ulëriu mblesi.

Sa i shëmtuar që dukej në atë çast!

— Pse zemëroheni, zoti Seit? — i thashë ngadalë.— A nuk po martoj motrën sonte? Gjithmonë kemi shtënë me pushkë në dasma. Meqë nuk është babai, shtira unë.

— Na... këlysh bushtre, na... se na more më qafë!

Nga pëllëmbët e rënda, sytë më nxorën xixa. Rashë mbi dysheme. Nëna u sul nga unë duke thirrur.

— Shpejt të ikim! — ja pat mblesi.

Po një zë i fortë e ngriu në vend:

— Mos u nxito, o matrapaz i fëlliqur! Sot vajzat e gratë tona kanë zot partinë, gjithë popullin.

Ishte sekretari i organizatës bazë të partisë në fshat. Pas tij kishin ardhur shumë burra të armatosur. Me të ishte edhe Ylli, shoku im.

Sekretari i partisë u hodhi nga një sy «krushq-

ve», që kishin varur kryet, dhe erdhi pranë meje.
Më ngriti dhe më fshiu me shami njollat e gjakut.
Unë e përqafova dhe pëshpërita:

— Sa mirë, sa mirë që erdhët shpejt!

— Të lumtë, Sokol, sot shtire tamam në shenjë!

Pas pak, shtëpia u zbraz. Sekretari i partisë
dhe fshatarët i vunë përpara «krushqit» e pafuar.

USHTARI ME LEJE

Ushtari e kishte herën e parë që kthehej me leje në shtëpi.

Ushtari e braktisi shtegun që kishte zgjedhur dhe i ra pjerrësisë drejt, duke kapërcyer shkurret e bushit e duke shkarë nëpër guralecët. Çanta i hidhej mbi shpinë dhe kutia e konservës e godiste. Ngjiti edhe një bregore tjetër, dhe ja... përpara syve i doli fushëza e shtrydhur midis një morie kodrash dhe e çarë nga një vazhdë e përdredhur, që ndriste nga dielli, sa të merrte sytë. Ky ishte lumi. Një lumë i çuditshëm, i kaltër, i rrëmbyer, i egër. Kurse lumenjtë e tjerë ishin me ujë plot, të qetë, po të turbullt gjithmonë! Ujrat e këtij lumi të vogël, pas rrjedhjes së rrëmbyer nëpër gryka, dremisnin një hop në fushëzë, sikur çlodheshin për udhën tjetër, që ishte edhe ajo e rrëmbyer.

Në këmbë të kodrave shtriheshin fshatra të vogla, me shtëpi shumë të larta e me çati të murme, me kopshte mollësh, me erën e veçantë e të dashur të fshatit.

Ushtari u ul mbi një gur të bardhë. Pjerrësia ishte mbushur me bedunicë që kundërmonte një erë të rëndë, që ishte si një afsh i pakuptueshëm. E

gjithë kjo rrëpirë ishte vendi i bedunicës. Fshiu djersët... Ndjehej shumë i gëzuar e i lumtur dhe nuk e kuptonte dot nga i buronte gjithë kjo lumturi: nga qielli i thellë e i kaltër i qershorit, nga shkëlqimi i ujrave të lumit që të merrte sytë, nga mali, nga tokat e gjelbëra me misër, ku lëkundeshin si një valle shamitë e bardha të nuseve dhe kapelet prej kashte të çupave, nga era e bedunicës, apo nga ajo kreshtë e bardhë e Tomorrit, si në mjegull, prapa së cilës ishte fusha e madhe, ku lumenjtë janë të gjerë e të qetë?

Ushtari ja mori një kënge.

«Sa i madh është vendi ynë! — mendoj ushtari. — Ja... kësaj bime këtu i thonë bedunicë, më poshtë i thonë çfagë, ne i thomi sherbelë!...»

Në rrëpirë i zuri syri tre djem të vegjël që mblihdnin budenica. Ai u ngrit dhe u nis drejt tyre.

— Ej, ushtar! — tha njëri nga fëmijët. Koka tullë nuk e fshihte dot që ishte kuqo. Fytyrën e kishte tërë prenka, si shumica e kuqove. U afruan edhe dy djemtë e tjerë. Nuk ishin më shumë se dymbëdhjetëvjeçarë.

— Ku e ke automatikun? — pyeti kuqua.

— S'kam! — tha ushtari. — Unë shkoj me leje!

— Nga posta vjen?

— Ç'të duhet ty? — qeshi ushtari.

— Leri ato! Sikur nuk e di ti që kjo më duhet edhe mua! Apo s'ta mbushim syrin ne të tre?

— Jam me leje! — qeshi ushtari.— Nga posta po vij.

— Ikë, or kuqua i dreqit! — tha tjetri, i pakët, flokëzi.— Pse, po të ishte ashtu siç mendon ti, do të bridhte në mes të ditës duke kënduar?

— Ikë or cmingo! Se mos di ti nga dinakëritë! — tha kuqua.

Ushtari u shkul së qeshuri. Ndenji me ta, bile i tregoi kuqos lejen.

— Për vete e mblihdni bedunicën?

— Ikë, or, tej!.. Pse privatë jemi ne? — tha kuqua. Mbledhim për kooperativën dhe marrim pika...

— E sa pika?

Djemtë ulën kokën.

— E kanë vënë normën shumë të madhe! — tha i treti.

— Ç't'ju bëj këtyre të dyve që janë frikacakë e kllëngjo, — tha kuqua, — pa ngjitesha në shpellën e Bozjakut unë dhe të shihje ç'bedunicë do të mblihdja.

— Ku është kjo shpellë? — pyeti ushtari.

— O! Atje nuk hipet kollaj. Pastaj, atje është edhe një guvë e tmerrshme. Asnjeri nuk ka hyrë brenda!

— Pse s'ka hyrë?

— E di unë! — tha kuqua.— Hedhin gurë brenda dhe dëgjohet sikur bien në pus, humbasin dhe vjen një tringëllimë e fortë sikur gjëmon moti.

— Timoteu, që ishte psallt, thotë se është guvë e shenjtë, brenda ka ikona...

— Ikë, or kllëngjo! — tha kuqua.— Unë do të hyj ndonjë ditë dhe do t'ja nxjerr në shesh gënjeshttrat atij Timoteut!..

— Lamtumirë, djema! — tha ushtari.— Mos u bëni frikacakë!

U ngrit, rregulloi rripin e çantës së shpinës dhe me një kërcim të madh, kapërceu një shkurre. Prapa shpinës, dëgjoji zërin e fortë të kuqos:

— E dëgjuat ushtarin, ë? Kllëngjot e dreqit!
Ushtari buzëqeshi.

Ishte duke dalë në xhade, kur befas dëgjoi nga rrëpira me bedunicë një zë të dridhshëm e të trembur.

— Ushtaaaa!... Ushtaaa...a...ar!

Ai ktheu kokën. Fëmijët nuk dukeshin më. Vetëm rrëpira bojëhiri ngrihej mbi krye. Pastaj, zëri i dridhshëm, i këputur, përsëriti prapë:

— Ushtaaaaar!!!

Një maqinë po vinte në xhade.

«Të hipja këtu, pas një ore isha në qytet», — mendoi ushtari. Por përsëri zëri i fëmijës ju drodh në vesh si një trompetë alarmi.

«Ç'kanë fëmijët, vallë? — mendoi. — Dhe pse i dridhet zëri kështu?» Ushtari vërejti maqinën që po frenonte. Dhe për çudi, maqina kishte targën e rrethit të tij.

Ushtari i ktheu shpinën xhadesë dhe u nis me vrap përpjetë. Zëri i fëmijëve që tani nuk e thërriste më atë, u drodh në ajër. Qëndroi një çast që të shihte se ku ishin, vuri duart në gojë si hinkë dhe thirri: «Erdha...erdha...»

* * *

— Ushtar.. pëshpëriti djali flokëzi me sytë e zmadhuar nga frika. Kuqua u zhduk... Humbi në guvë!..

— Si humbi? — pyeti ushtari i shqetësuar.

— Ne... hipëm këtu... në shkëmb. Ai tha: «Unë po e fut një herë kokën në guvë». Futi gjysmën e trupit dhe doli.

— «S'ka asgjë! — tha. — Brenda është errësi-

rë e madhe dhe mban erë dhé. Unë do të futem i të-ri!» Hyri brenda, pastaj klithi dhe nuk po del më!..

Ushtari hetoi shpellën. Kjo ishte një e çarë në shkëmb, sa mezi të nxinte.

— Ti vrapo në fshat, — i tha ushtari njërit nga të dy djemtë që nuk kishin hipur në shkëmb. U thuaj të sjellin litarë... shumë litarë. Dhe një elektrik dore! Mos harrosh gjë, ë?

Djali vrapoi tatëpjetë.

— Si e ka emrin ai? — e pyeti ushtari djalin tjetër që mbeti aty.

— Nuni!

Ushtari mbështeti duart pas shkëmbit dhe futi kokën në të çarën e shpellës.

— O Nuniii! — bërtiti.

Një përplasje e tmerrshme ajri, u përpëlit nëpër faqet e shkëmbit, në brendësi, gjëmoi si kambanë dhe nga thellësia u ngjitën mijëra tinguj të çuditshëm, sikur rrukulliseshin gurë.

«Qënka thellë! — mendoj ushtari dhe ndjeu një të ftohtë që ju derdh nëpër peshkun e kurrizit, sikur t'i kishin hedhur ujë.

— Të hedh një gur? — tha flokëziu.

— Jo! — tha ushtari dhe hoqi çantën nga shpina. Preu një shkop thane dhe e futi në të çarën.

— Ti thua se më parë thirri se nuk ka asgjë?

— Po! — tha fëmija. — Thirri dhe pastaj klithi.

— E di mirë që u zvarris një copë herë pastaj tha: «S'ka asgjë?»

— Po... por pastaj klithi!

«Hyrja në guvë duhet të jetë e sheshtë, pastaj mund të ketë një vrimë si pus...» mendoj ai dhe futi shpatullat brenda.

— Mos hyrë!.. — u lebetit flokëziu.

— Pusho! — tha ushtari.— Unë do të dal pra-

pë.

Por, në atë çast i shkrepri një mendim tjetër.

«Po sikur hapësira të jetë shumë e ngushtë dhe të mos kem mundësi të vërtitem?.. Më mirë ndofta është që të hyj me këmbët përpara...»

Futi këmbët deri në gjunjë. Nisi të zvarrisej. I dukej sikur zvarrisej në një pritë, aty buzë kufirit, duke përgjuar zhurmat e huaja. Hyri deri në mes. Me majat e këpucëve godiste me dyshim dheun e njomë. U shty edhe pak më prapa dhe goditi truallin me majën e këpucës. Trualli ishte i fortë. Tani kishte hyrë deri në supet. Pa, poshtë shkëmbit, qiellin e madh, të kaltër e të paanë. Drita hyri. Fushëza ishte larë në një dritë të bardhë. Shamitë dhe kapelet prej kashte, në arat me misër, lëvizën të shqetësuara e u mblodhën tufë.

«Ka arritur djali!» mendoi ai.

«A do të mbajë mend vallë për një dritë?» Futi gjithë trupin dhe u zvarris prapa. Një lëvizje e njerës këmbë... një goditje me majën e këpucës. Edhe një shtryqje tjetër. Tokë. Edhe një... befas, majja e këpucës rrahu në humnerë dhe e lëvizi këmbën e shtrirë në boshllëk. Përreth dhe i lagësht. Ngushtësi. Në peshkun e kurrizit, po ata të ftohtë që pati ndjerë një çast më parë. E çara ishte aty disa metra përpara dhe drita t'i vriste sytë. Sa e bardhë dukej kjo dritë! U zvarris deri në hyrje të guvës dhe doli. Sa kohë kishte kaluar vallë duke u zvarrisur ashtu, si kërmill? Kushedi!

Nën shkemb ishte mbledhur një turmë njerëzish. Ushtari hetoi fytyrat e tyre të vrara, të murrëtyera. Një grua flokëkuqe ishte përmbysur mbi

një gur dhe supet i ngriheshin e i uleshin nga dënësia të shurdhëra...

— Pusho, de! Mos e qaj për së gjalli!.. — tha një zë. — Nuk dihet!

Ushtari, i hutuar, fshi u dhenë e verdhë që i kishte mbetur mbi xhakëtë, pastaj e hoqi fare dhe mbeti në këmishën e bardhë prej pambuku.

— Ç'na thua, ushtar? — pyeti një burrë i thyer.

— Disa metra vendi është i sheshtë. Pastaj duket sikur ka një humnerë, — tha ai.

Gruaja që kishte ngritur kryet, e uli prapë me një ulërimë si të një njeriu të plagosur. Një burrë i gjatë, i dobët, me një kapele të zezë, pëshpëriti:

— Kështu ishte e thënë! — Mos u helmo, o e helmuar! Shpella e Bozjakut është e shenjtë. Kush hyn atje, nuk del i gjallë!

— Pusho, Timote! I kemi dëgjuar këto përralla! — tha një tjetër. — Tani po ngjitem unë në shkëmb. Më lidhni me litarë dhe do të hyj brenda!

— Jo, — tha ushtari. — Do të hyj unë.

— Ti? Ty nuk të njohim. Kush je ti?

— Jam ushtari i postës. Po kthehesha me leje në shtëpi.

— Pse të mos hyja unë? — tha një djalë nja gjashtëmbëdhjetë vjeç.

— Unë jam më i fortë se ju, — tha ushtari. — Jam i stërvitur.

Mbi shkëmb, me atë trup të bëshëm e me muskujt që i ravijëzoheshin nën këmishën e bardhë, ushtari ngjante si një shtatore e latuar në gur të bardhë.

— Shpëtomani!... Zemra më thotë se është gjallë! — tha gruaja.

— E shpëtoftë perëndia!... — pëshpëriti burri me kapele të zezë.

Poshtë, në xhade, qëndruan dy «gaze» dhe disa njerëz u ngjitën me vrap përpjetë.

— Shikoni! — pëshpëriti dikush.— Po vijnë nga rrethi. Kur shkoi lajmi deri në qytet?

— Lajmi i zi është si vetëtima! — tha Timoteu.— Ah, mor djema! Ajo që u bë nuk ndreqet më tani!

Ushtari zbriti nga shkëmbi dhe u ul mbi një gur, i menduar. Po... vetëm ai e dinte si ishte guva. Vetëm ai dinte disa të fshehta të saj. Thirri pranë fëmijët që kishin qenë me kuqon dhe i pyeti:

— Si u fut Nuni në guvë, me kokën përpara apo me këmbët?

— Ja.. ashtu si ti!.. me këmbët!

«Është zvarritur prapa! — mendoi ushtari.— Por është zvarritur shumë shpejt dhe, kur arriti në humnerë, e tërhoqi pesha. Po të kishte hyrë ndryshe, nuk do të kishte më shpresa... Sikur gryka e humnerës të jetë aq e ngushtë sa të mos e lërë ta tërheqë kokë poshtë, ka shpresë... Ndoshta ka rënë më këmbë...»

— Sidoqoftë, — tha ushtari, sikur ndiqte vazhden e mendimeve të veta, — gjallë a vdekur, s'mund ta lëmë fëmijën atje brenda. Le të ngjiten disa nga të rinjtë me mua mbi shkëmb dhe hidhmëni me litarë!

Figura e gjatë dhe e zezë e Timoteut ju afrua dhe i pëshpëriti:

— Ushtar! O bir! Ti po lot me jetën tënde. Je dhe duke u kthyer në shtëpi! S'ka asnjë shpresë që djali të jetë gjallë. Pse të mbetesh edhe ti atje, në mes të asaj errësire? Ku e di ti se sa thellë është?

— Pushoni! — tha rreptë ushtari. — S'keni turp? Ne nuk e kemi jetën vetëm për vete!

— Ej, shpëtoje o zot gjynahqarin! — pëshpëriti Timoteu. Ushtari hipi prapë në shkëmb, e lidhën kryq e tërthor me litarë, nën sjetulla e pas mesit...

* * *

Dhe hyri në shpellë ushtari. Ndezi elektrikun dhe u zvarrit ngadalë. Pastaj, bërtiti:

— Tani lëshojeni litarin ngadalë! A më dëgjoni?

Jashtë, zëri i tij erdhi si një gjëzim i poter-shëm. Ushtari u var mbi humnerën e ngushtë dhe ndjeu se si ju përgjigjën disa zëra të mekur, të largët.

«Çudi! — mendoi.— Unë s'jam as shumë thellë! Pse vijnë kaq të dobët zërat e tyre? Më poshtë, ndoshta nuk do të dëgjohet asnjë zë!»

Deri aty humnera ishte si një grykë e ngushtë pusi. Një fërgëllimë shprese, si një valë e ngrohtë, u derdh në tërë qenjen e ushtarit.

— Lëshoni prapë litar! — bërtiti. — Aty lart dikush lëshonte duke ngurruar nga një centimetër litar. Po zbriste shumë ngadalë.

Ishte shumë ftohtë. Ushtari vërejti faqet e humnerës që ishte si grykë pusi. Një gjë e bardhë, si pushi i rrodheve, e ftohtë, mbulonte dheun. Ish-

te një myk i vjetër dhe i trashë. U mundua të drejtonte rrymën e dritës poshtë. Po nuk pa dot asgjë, drita godiste vetëm këmbët e tij të varura në një hapësirë të ngushtë.

«Do të jetë thellë!» — mendoi ushtari dhe përsëri i kaluan mornica në trup.

«Gjallë a vdekur, fëmija duhet nxjerrë!» — tha ai dhe mbështeti këmbët si bigë mbi mykun e bardhë të faqeve të humnerës.

«Ata lart po e lëshojnë shumë ngadalë litarin, — mendoi. — Siç duket kanë frikë se mos përplasem!»

Drita tani nuk para i hynte në punë. Mendi-me të befta e të panjohura i çfaqeshin e i zhdukeshin si një mjegull në kokë.

Diku, aty lart, qëndruan dhe nuk lëshonin më litar. Ushtari mbeti pezull. Mezi dëgjoheshin ca zëra të largët e të dobët, si zukatje mizash. Vetja ju duk brenda një nate të çuditshme, kurse përtej, diku, zukaste jeta e largët e ditës së gjatë!

«Ç'kanë? — mendoi. — Pse qëndruan?»

U kujtua se nuk u kishte thirrur asnjëherë, kurse atje sipër kishin vendosur që ai të bërtiste vazhdimisht se si ishte, sepse zëri i tij dëgjohej mirë.

— Shtoni litarin! — thirri. — Shpella është e thellë!..

«Sa metra kam zbritur vallë? Dhe, a mund të mos vritet njeriu po të bjerë nga një lartësi e tillë?»

Papritur, siç ishte ashtu me këmbët bigë mbi mykun e dheut, ju kujtua të kërkonte gjurmët e djalit. Por gjurmë s'kishte. Dukej sikur fëmija kishte shkuar poshtë si një gur.

Humnera u ngushtua. Ushtari e kuptoi se nuk do t'ja nxinte shpatullat dhe u mbështet me këmbë e me duar. Litari i tendosur tani po përdridhej e lëkundej si gjarpër mbi kokën e tij.

— Mos lëshoni litar! — bërtiti ai dhe lëvizti ngadalë, duke u munduar të shkasë nëpër ngushticë.

Sikur të jetë kështu deri në fund nuk do të hyj dot. Nuk do të m'i nxërë supet!» — dhe për herë të parë në jetën e tij mallkoi supet e gjera.

«Duhet ta shemb dheun!» — tha dhe thirri: — Më ngrini! — Për herë të parë i lindi dyshimi, a e kuptonin mirë vallë ata lart? Por ndjeu se litarët e shtrënguan pa mëshirë edhe ai i nxori këmbët nga vendi i ngushtë.

— Mjaft! Më ulni ngadalë! — tha ai. U mbështet fort me të dy duart në faqet e humnerës dhe e qëlloi dheun me thembrën e rëndë të çizmeve. Dëgjoi dheun që shembej nën të. Pastaj, befas, trupi i ra poshtë si hebe, me një shpejtësi të madhe dhe s'pati kohë të mendonte asgjë. Vetëm e kuptoi se nga hunda, si prej një pompe të çuditshme, po i ridhte gjaku me forcë dhe po spërkaste mykun e dheut. Veshët i gjëmuan sikur do t'i çaheshin dhe mbeti pezull, duke u lëkundur. Vendi ishte i gjerë dhe ai lëkundej si një lavjerrës ore. Gjaku vazhdonte t'i rridhte, po më ngadalë, mbi këmbishën e bardhë. Sikur ju errësuan mendimet.

«Pse nuk e mora automatikun? — i vegoi një mendim përçart. — Ah, po, unë po shkoja me leje... me leje. Nuk jam me shërbim...»

«Po pse rashë kështu si gur? Apo ndoshta kur hapja vrimën, litari, i tkurrur, u shtri dhe pastaj, në hoshllëk, rashë aq shpejt?» Me mundim,

e nxori nga xhepi elektrikun. Nën një rrymë të verdhë dukej fundi i sheshtë i guvës. Por trupi i fëmijës s'dukej gjëkund.

«Nëqoftëse ishte i vdekur do të ishte pikërisht këtu! Ai paska lëvizur!» — dhe prapë ajo valë e ngrohtë i gurgulloi në tërë qenjen, ashtu si gurgulloi në rreze drite në një qiell të turbullt. Dhe bërtiti me një zë që sikur s'ishte i tij:

— Më lëshoni edhe tri metra...

Dhe u gjend në fund. Këmbët i shkelën në një tokë të butë, që gjëmonte nga hapat e tij, sikur poshtë të ishte një guvë tjetër. Drejtoi me ankth rrymën e dritës në anët e errëta. Në një skaj, pa fëmijën të mbledhur kruspull.

— Nuni!.. — bërtiti ushtari dhe u lëshua drejt tij. Fëmija nuk lëvizi. Ushtari e rrëmbeu në krahë, i shkopsiti këmishën dhe i vuri veshin në zemër. Por nuk mundi të kuptonte asgjë.. herë i bëhej sikur ndjente një drithmë të mjerë, herë sikur mbi ata të dy kishte zbritur një heshtje e madhe. Vetëm zemra e tij hidhte shkulme gjaku në damarët dhe atij i dëgjohej sikur dikush i ecte brenda kraharorit me hapa të rëndë e kumbues. Prapë i buçiti gjaku nga hundët dhe i ra mbi trupin e fëmijës. Një dobësi e panjohur kurrë më parë po i përshkonte trupin. E tërhoqi djalin deri në grykën e shpellës, e lidhi po ashtu si veten me litarin që e kishte mbështjellë në mes. Anët e litarit i lidhi fort pas mesit, në mënyrë që fëmija të qëndronte pingul nën këmbët e tij.

— E gjeta... më ngrini! — gjëmoi zëri i tij atje lart.

Ndjeu se po e ngrinin me shpejtësi, kurse

gjaku po i rridhte akoma nga hunda. Në gojë kishte shijen e gjakut dhe pështyu mbi mykun e humnerës. Dhe ndodhi prapë diçka që ai nuk e priste. Supet ju shtrënguan pas vrimës që kishte zgjeruar më parë, kurse ata lart vazhdonin ta tërhiqnin. Supet ju mbështetën në një send të fortë. Fëmija, si një gur i varur në këmbët, e tërhiqte drejt thellësisë. Litari i hyri në trup. Ja, tani ai ndjente litarin në tërë qenjen... në brinjë, në shpatulla, në supe; e ndjente se si kjo qenje kryeneçe... litari, po thellonte vijat, po hynte në mish...

— Mjaft!... Më lëshoni... — bërtiti.— Por, siç duket, askush nuk e dëgjo. Vazhdonin ta tërhiqnin me këmbëngulje. Nuk po duronte më; litarët po i hynin në gjithë trupin...

«Po të mos i mbledh fuqitë dhe të thërras me forcë që të më lëshojnë... mbarova! — i shkrepri në mendje. Dhe, e vërviti edhe një herë kokën lart, drejt honit të errët që shihte si një masë të zezë pa formë mbi veten e tij.

— Më lëshoni!...

E kuptoi se u lehtësua, zbriti e mbeti prapë varur në hapësirë. Ngriti duart dhe ndriçoi mbi krye. E pengonte një gur. U mbështet i gjithë mbi të dhe e lëshoi veten. Guri u shemb e ra në fund të guvës me zhurmë. Dherat i ranë mbi flokë. Nuk thirri dot më. Por e ndjeu se po ngjitej, sepse po zmadhohej një dritë e zbetë, e cila u bë një lëmsh i bardhë e i padurueshëm për sytë e tij. Nuk i kujtohej se si i bëri ato pesë metra që duhej të zvarritej. I kujtohej se në mendje i hyri një vegim i tmerrshëm, diçka e bardhë, që ndoshta ishte drita e ditës...

Pas kësaj, ushtari pati një anemi të gjatë. Dhe qëndroi tre muaj në spitalin e qytetit...

Dhe, përsëri, çdo gjë i dukej e madhe, pa kufi, si atë ditë në qafën e malit. Dhe, ishte i lumtur ushtari! Pranë tij, në një shtrat tjetër, dremiste Nuni i vogël.

NË KOOPERATIVË

Tani mua më skuqen faqet nga turpi kur kujtoj se, gjer ca kohë më parë, familja s'kishte hyrë ende në kooperativë. Ama, gëzimi që më në fund hymë edhe ne, ishte aq i madh, saqë këtë dua ta ndaj me ju, duke ju rrëfyer si e qysh.

Babai im ka punuar gjithnjë larg shtëpisë. Bente dru e qymyr në ndërmarrjet e shtetit, herë në një mal, herë në një tjetër, duke i ndërruar këto vende për çdo dimër. Në pranverë e në vjeshtë vinte e rrinte ca kohë në fshat sa për t'u çlodhur e shmallur me ne. Pastaj ngrihej e shkonte përsëri. Siç më thonë, kur isha i vogël, unë s'e njihja fare për baba. Këtu kanë të drejtë, sepse, sapo arrija t'i afrohesha, ai ngrihej e shkonte dhe, kur kthehej pas disa muajsh, e kisha harruar fare.

Punë e vështirë kjo e tij, po ai ishte mësuar.

Në kohën kur u ngrit kooperativa në fshatin tonë, ai se ku rregulloi një punë të përhershme. Siç na thoshte, shpinte me mushkat humbë në sondat e gjeologëve, të shpërndara nëpër mal. Megjithatë, prapë vinte dhe rrinte ca kohë në fshat. Tani kishte zënë vend, nuk rendte nga një mal në tjetrin, ku priteshin dru e ku bëhej qymyr, po.

ama, përsëri s'ishte as punëtor tamam e as fshatar; se punëtori, si e dini, ka rrogë të caktuar dhe merr vetëm pesëmbëdhjetë ditë leje në vit, kurse babai im vinte kur t'i donte qejfi e fitonte sipas punës që bënte. E si mund ta quaje fshatar e bujk gjersa s'merrej fare me punë bujqësie?

Ja, kështu. Kur na thanë një herë për të hyrë në kooperativë, im atë bëri një lutje dhe ja dorëzoi kooperativës atë pak tokë që kishim. Po për të hyrë s'hyri. Ne mbetëm vetëm me dy copë kopshte të vogla, ku s'bënim dot as zarzavatet që na duhe-
shin për vete. Kështuqë pjesën e tyre më të madhe, si dhe bukën, i blenim. Pra, fshatin e kishim vetëm për të ndenjtur.

Kuptohet që mërzhiteshim pa masë, se është e vështirë, është shumë e vështirë të rrihesh veç të tjerëve. Ja, tërë flasin për prodhimet e kooperativës, për fushatat e saj, për ngritjen e një depoje e për krijimin e një ferme lopësh model. Ti ngrihesh e shkon, se ke frikë mos të të thumbojnë. Shkon në një grup tjetër edhe atje fjala vete ku vete e te kooperativa mbaron. Atëhere shkon e futesh në shtëpi, se kudo e ndjen veten si të huaj.

Kjo s'na pëlqente as mua e Letës, sime motre, as nënës, që ishte mësuar të punonte me shoqe, edhe më parë se të bëhej kooperativa, herë në arën e njëres herë në të tjetrës, kurse tani rrinte në shtëpi. Po kjo s'i pëlqente as gjyshes. Edhe asaj ja kishte qejfi të vinte atje në lëmë e të rrihte thekër, të nuhaste erën e drithit të ri e të grashinës; madje ajo thoshte se e kishte zënë malli edhe për pluhurin e vraheve e për çekllasat, që t'i mbushin çorapet e të bezdisin aq shumë!

Mirëpo im atë habitej fort me këto hallet to-

na. Mblidhte buzët, ngrinte supet dhe thoshte duke tundur kokën:

— Po ç'keni, xhanëm? A nuk ju sjell para sa duhet? Ç'ju mungon? S'rroni mirë e bukur? Oj, kur ju ka marrë koka erë! Dashkan të rropatem arave! Po kësaj ç'i thua?..

Shkurt, babai nuk donte të hynim në kooperativë. Një mbrëmje na erdhi vetë kryetari i kooperativës me një fshatar tjetër. Dhanë e muarën që t'ja mbushnin mendjen tim eti, po ai s'tundej nga e tija.

— Ç'keni me mua, bre? Tokën që kisha, ju dhashë. Unë jam në punë të shtetit. Mos më llogarisni fare për fshatar individ dhe s'ju prishet fare puna. Pastaj, ku e gjetët të drejtën të më quani individ? Unë jam punëtor.

Kështu thoshte ai. Po ne e dinim ç'bezdi na sillte ai emri i fëlliqur «individ»! Sapo e prishja pak me një shok, ai kthehej e më thosh:

«Ikë, more individ!»

Kur fillonim shkollën, mësuesi kujdestar pyeste ç'punë bënte babai e nëna e çdo nxënësi. Të gjithë përgjigjeshin njëzëri:

«Anëtarë të kooperativës bujqësore».

Mua më dukej sikur këto fjalë secili i thoshte me krenari. Ndërsa unë skuqesha e ulja kokën. Ah, sikur të kisha edhe unë të drejtë të thosha plot gojën: «Anëtarë të kooperativës bujqësore!»

Kur vinte te emri im, mësuesi, po të qe i ri, thoshte:

«Miti Gori, po kështu...» dhe bënte dy viza, si të gjithë të tjerët. Po atëhere hidheshin disa përnjëherësh e thoshin:

— Jo, jo, ai është individ!

— Vërtet? Si kështu? — dhe mësuesi ngrinte kokën e më shikonte.

Sa të rënda më ishin këto çaste, as që jam i zoti t'jua rrëfejë! I thosha me turp e me gjysme zëri se babai im ishte punëtor në gjeologji, po ndonjë hidhej e thoshte:

«Ç'e zbukuron? Thuaj më mirë drejt që jeni individë!»

Mësuesi sqaronte se edhe punëtori është njeri i nderuar po aq sa kooperativisti, por këto fjalë nuk arrinin dot të më ngushëllonin.

Ky avaz përsëritej herë pas here. Ja, shkonim për të marrë librat e reja. Tërë ishin të gëzuar, merrnin librat dhe vinin një firmë në listën që e kishin pregatitur mësuesit bashkë me llogaritarët e kooperativës. Unë, si individ, i paguaja lekët në dorë. Pra, kudo veç të tjerëve. Sa herë vinte rasti që më kujtohej se isha individ, unë e di sa vuaja. Le pastaj mbrëmjeve, kur shokët shkonin të merrnin bukët në furrën e kooperativës!

Ai emri i pështirë «individ» më çëriste në zemër sa më tepër që rritesha. Verës shokët mblidhnin kallinj a bënin ndonjë punë tjetër në kooperativë. Unë vërtitesha kot nëpër rrugë dhe ditët më dukeshin javë. Një herë vajta edhe unë për kallinj. Nuk e harroj kurrë atë ditë.

«Jo, more! Mos dashke të marrësh kallinj prej arave të kooperativës?» — më tha njëri.

«Nuk i mbledh për vete. Do t'i shpie edhe unë në depon e kooperativës» — thashë.

«Po ti s'je kooperativist!» — ma priti një tjetër.

Unë s'dija ç'të thosha. Mirë që u ndodh njëri nga shokët zemërmirë e tha:

«Le të mos jetë! Edhe ai do të bëhet. Mblidh, Miti! Hajde me mua!»

«Mirë, le të mbledhë», — tha edhe një tjetër. Të tjerët s'kundërshtuan më e unë punova me ta, po sa para bën? Zemrën e kisha të lënduar.

Atëhere vendosa që të bëja çmos për ta bindur tim atë. Do të bëja të pamundurën.

Dhe, sikur ta kisha porositur, s'vonoi shumë e babai erdhi.

Në fillim kisha drojtje e s'guxoja t'i them ç'kisha menduar e vendosur. Ama, as në sy s'e shihja e as fjalën s'ja ktheja. Kur ikën miqtë që kishin ardhur ta shihnin, ai u shtri në krevat e tha:

— Po ti, Miti, ç'më rri kështu, sikur të ka ngrënë gomari brumët?

— Hiç, ja...

Si ta nisja? Po ai më ndihmoi vetë.

— S'u gëzove fare që erdha, s'të paska marrë malli?

— Po ty, a të merr malli për ne?

— Shumë!

— Kur qenka kështu, pse s'rri këtu përngahe-
ra?

— Ah, sa më rrihet edhe mua, mor djalë! Po puna, puna... s'më lë puna.

— Pse, pak punë ka këtu?

Babai u ngrit më këmbë, pastaj u ul kundruall meje.

— Djali qenka rritur, — tha me tallje, — u dashka ta dëgjoj me seriozitet...

— Mirë të thotë, — tha nëna.— Në kooperativë ka punë edhe për ty, edhe për ne.

— E paski bërë me fjalë kështu?

— Pse ta bënim me fjalë? Nuk është mirë kështu! S'është punë kjo! Ç'i do edhe ato lekë që sjell? Vjen e shkon sikur je mik e jo njeri i shtëpisë.

Im atë s'foli fare. Nëna vazhdoi pak si vrazhdë:

— Pastaj, ti ngrihesh e shkon, po ne e dimë sa vuajmë.

— Pse, xhanëm, s'ju arrijnë lekët?

— Ti gjithnjë te lekët e ke mendjen.

— Po atëhere, ju bezdis njeri?

— Pse punë e lehtë të duket ty të bësh veç të tjerëve? S'di as si t'u përgjigjesh njerëzve. Apo rrihet kështu, pa punë...

— Babi, të hyjmë në kooperativë! — thashë unë — A e di ti sa turp më vjen nga shokët? A e di ti si skuqem kur më thonë «individ»? Unë kudo rri kokullur, sikur të kem bërë ndonjë faj të madh e sikur ti të kesh bërë ndonjë krim...

Më ishte zgjidhur gjuha dhe po e zbrazja tërë dufin që më kishte pllakosur zemrën. Ai rrinte e dëgjonte në heshtje. Papritur u ngrit dhe vrëjti vetullat.

— Mjaft, de! — tha me inat dhe pështyu në vatër.

— Të hyjmë, babi! Është mirë për të gjithë ne, babi! Veç të hyjmë në kooperativë!

— Të marrim bukë në furrë! Ohoho, sa mirë! Unë do t'i marr gjithnjë! — tha Leta.

Ai doli nga dhoma, por s'dëgjua ta hapë portën e jashtme. Pas pak u kthye përsëri. Dukej që e kishin dogëndisur keq fjalë tona. Mirëpo ende s'po jepej.

— Mirë të thanë edhe fëmijët, bir. Mirë të tha edhe nusja. S'është punë kjo jotja. Veç të tjerëve, jo, jo... s'është punë, — tha gjyshja.

Ai tundi kokën.

— Ndoshta keni të drejtë, — tha. — Edhe unë jam mërzitur larg fshatit...

Pas pak shtoi i vendosur:

— Flini rehat, nesër do t'i them Nikos të ma bëjë lutjen!

— E bëj unë, babi! — thirra i gëzuar.

— E bën dot? — tha ai duke më shikuar buzëgaz, sikur të mburrej me mua.

— E bëj, e bëj! — thashë dhe ju hodha në qafë. Në anën tjetër ju var Leta.

— Mirë, mirë. Ti je goxha djalë tani. Lëri këto, po lutjen...

Rrëmbeva çantën dhe grisa një dyfletëshe nga fletorja e hartimit. Nga nxitimi, derdha edhe bojën. Po lutjen, ama, e bëra shpejt e shpejt. A e dini? Që më parë e kisha bërë me mend kaq e kaq herë dhe veç sa e hodha në të pastër. Babanë e detyruam ta shpinte te kryetari që atë çast, ndërsa unë vrapova te shokët dhe ua thashë këtë lajm të gëzuar.

Të nesërmen u grindëm ca me time motër se kush të vente t'i merrte bukët, po më në fund u muarëm vesh të venim të dy dhe kjo grindje u zgjidh pa ndërhyrjen e ndonjë tjetri. Ecnim kokëlarë dhe, kur na pyesnin njerëzia se ku venim, Leta thoshte me gëzim;

— Do marrim bukë në furrë. Ne hymë në kooperativë!

BABAI FATKEQ

(Tregim humoristik)

Kryetari i familjes, Vehib Valuta, po kthehej si zakonisht nga puna i lodhur dhe i gatshëm për të ngrënë drekën.

Teli, djali i tij i madh, e përshëndeti i pari të jatin, por Vehibi ja ktheu si zakonisht me ftohtësi dhe duke mbajtur distancë. Ai është shumë i matur me fëmijët. Sipas tij, distanca, ftohtësia, vrazhdësia, bisedat akademike dhe moralizuese, ja zgjidhja ideale e edukimit të fëmijës. Kështu, sipas tij, do të rriteshin qytetarë të denjë, intelektualë dhe revolucionarë.

Këtë radhë Vehib Valuta ja filloi drekës me uri, ndërsa marrjen në pyetje të të birit e la për pas buke.

Njerëzit pas buke pyesin më me qejf dhe i formulojnë frazat shumë më mirë se sa para buke. Kjo vërteton tërthorazi se edhe stomaku ndikon mbi kulturën.

Kur Vehibi ju përvesh musakasë me kungull Teli se nga nxori një katalog të gjerë dhe filloi të shfletonte vëmendshëm.

Vehibi mbushi pirunin me sytë nga i biri dhe sa nuk ngriu, ashtu me dorën pezull. Ishte një katalog automobilash! Po, ashtu ishte, një katalog automobilash, po ç'punë kishte i biri me atë katalog? Ai po e shikonte sikur i biri të mbante në duar një pako dinamit.

Vehibi çoi dorën te goja, pa ja hequr sytë katalogut, pastaj, duke lënë musakanë përgjysmë, u ngrit papritur më këmbë dhe tha:

— Ku e ke marrë këtë katalog, mor, mor... (kungull, deshi të thotë, po u përmbajt të mos cënonte nocionin mbi edukatën qytetare).

Sa herë që bisedonte me të birin, ai ngrihej më këmbë, pasi kështu dukej më i gjatë dhe pra, më autoritar.

— Në shtëpinë e pionierit, babi, — u përgjegj i hutuar Teli, pasi u ngrit edhe ai më këmbë, sepse e mori me mend që çështja duhej të ishte serioze. Vetëm që nuk e kuptonte pse ishte alarmuar aq shumë babai.

— Po ç'hyn ky katalog në horizontin tënd, xhanëm? A nuk mund të merrje diçka tjetër më dinjitoze?

— Mua më duhet ky katalog, babi!

— Të duhet?! Pse?

— Unë, babi, kam vendosur të bëhem shofer!

— Si? Qysh? Pa përsërite edhe një herë?

Teli, i hutuar në kulm, përsëriti thujtë pa dashur:

— Pse, babi? Unë thashë se do të bëhem shofer!

— Grua! Lisi! — i thirri me nxitim së shoqes Vehibi.

— Ç'është? Ç'u thye? — pyeti ajo duke hyrë në dhomë me nxitim.

Atë e quajnë Luizë, po Vehibi e thërriste Lisi.

— Ç'është, Vehib? — pyeti ajo me një frymë. Ai ju afrua, i hodhi duart në supe, e tërhoqi me autoritet më pranë, pa harruar respektimin e distancës minimale, pastaj i tha:

— Lisi! E shtrenjta ime. Më thuaj ndershmërisht, a ke gisht ti në këtë punë?

— Në cilën punë, more Vehib? Unë nuk po marr vesh asgjë, — tha ajo, duke i hedhur të birit një sy hetues, pasi e kuptoi që fjala duhej të qe për të.

— Si, moj, nuk ditke gjë? Nëna e fëmijës të mos jetë në korent? Si ka mundësi! Ku lejohet sot një indiferentizëm i tillë? Pra, ti nuk e paske marrë vesh se Teli ynë është bërë shofer?

— Teli shofer? Paska marrë patentën? U shpirt i mamit! Po ku e mban dot timonin ti, o xhan i mamit, — tha ajo dhe e mbështolli me një përqaftim të birin.

— Ç'janë këto llastime, — shfryu kryetari i familjes. — Ti po ma shkatërron Telin, Lisi, ti po ma shthur atë, pikërisht kur ai ka nevojë të thuret me dinjitet, intelekt dhe me revolucion.

— Po pse, babi, unë nuk kam bërë ndonjë gjë të keqe!

— Ç'të keqe ka në këtë mes? — pyeti të shoqin Luiza.

— Dëgjo, grua. Dëgjo, moj Lisi. Shofer, pse? Shofer, klasë punëtore! Jam shumë dakord. Klasa punëtore na edukon, na udhëheq. Është klasa më revolucionare. Po, ama, pse pikërisht djali im të bëhet shofer? Një djalë aq i talentuar, i zgjuar, i

shkathët, të bëhet shofer! Të përfundojë në duart me benzinë! Ai ka mundësi shumë më të mëdha! Kjo as që mund të perceptohet dhe as që mund të pranohet. Kur ke mundësi të vazhdosh shkollën mirë e bukur, të marrësh një diplomë, një emërim si gjithë njerëzit dinjitozë, pse të katandisesh shofer? Ju pyes, pse? Kjo më tmerron! Kjo është fatale! Kjo është katastrofë! Pas shembullit të këtij, ime bijë do të bëhet traktoriste, apo kombajnere, ndërsa djali i vogël kallajxhi. Kështu të katandiset familja ime, dera e një intelektualit veteran? Që mbiemri im të vihet në gjithfarë listash me sqarimet; murator, karpentier, axhustator, në vend që të shkruhet: inxhinier, doktor, shkrintar. Po, kemi detyra ndaj shoqërisë! Këtë e kuptoj. Po pse vallë të më bjerë mua barra më e rëndë? Pse, pra? Dëgjo, Teli. Më thuaj kush ta ka mbushur mendjen të bëhesh shofer? — ju kthye ai të birit.

— Asnjeri, babi. Mua më pëlqen vetë. Nuk di pse, po ja që më pëlqen.

— Jo, jo. Ty dikush të heq për hunde. Unë nuk i ha këto. Kush ta ka futur në zemër këtë zannat? A e di ti se në shoqërinë tonë socialiste inteligjenca ka detyra të mëdha? Si të lejohet ty brak-tisja e shkollës?

— Jo, babi. Unë nuk do ta lë shkollën.

— Nëqoftëse nuk do ta lësh shkollën ti, mor djalë i mbarë, atëhere do të marrësh diplomën, emërimin, do nderosh babin, farefisin, do të bëhesh njeri i dëgjuar.

— Po edhe nga shoferët ka njerëz të dëgjuar, babi. Javën e kaluar që ishim në eskursion, shoferi ynë ishte një hero i punës socialiste. Ai na foli për...

— Ashtu, ë ? — ja ktheu rëndë Vehibi.— Pra, ja ku na qenka infektuar. Dhe pandeh se do të bëhesh hero i punës socialiste, ë ? Apo ministër i komunikacionit! Ç'farë leshkoje!

— Vehib! Si flet kështu? — e ndërpreu e shoqja.

— Po, me të vërtetë e humba kontrollin, Lisi! Kjo është alarmante. Na del një shofer dhe me dy tri fjalë m'i prish mendjen tim biri. Atë mendje të cilën unë mezi po e edukoj për vite e vite të tëra. Kjo nuk durohet, Lisi. Njerëzit duhet të jenë më të matur, të mos llapin shumë, sidomos me fëmijët! Ja, merre tani, të rroftë shoferi yt i ardhshëm. A thua prandaj po sakrifikoj unë, që t'i jap socializmit një shofer, kur mund t'i jepja një kuadër, një kokë, një shkencëtar? Dhe a thua se kështu e kam kryer detyrën? Jo! Me siguri, jo! Dëgjo, Teli, Shofer! Harroje këtë emër, ashtu siç harrove fjalën gogoll!

Të nesërmen Vehibi u kap me mësuesin e të birit. Ai i shpjegoi se të mësuarit e një zanati nuk mund ta pengonte kurrë marrjen e diplomës.

Ndërsa Vehibi, si më kompetent, u shpreh se më parë duhej marrë diploma, pastaj ndonjë profesion. Përndryshe, i riu rend pas këtij zanati dhe pastaj lamtumirë diplomë. Kështu, nuk u morën dot vesh.

Prej aty Vehibi takoi drejtuesin e rrethit automobilistik pranë shtëpisë së pionierit.

I kërkoi t'i tregonte kur ishte hapur rrethi i automobilistëve, pse, me ç'vendim dhe ç'perspektiva kishte. Pastaj deshë të dinte se ç'lloj motorësh mësoheshin aty, nga kishin ardhur modelet dhe a bëhej punë laboratorike...

— Këtë punë do ta shohim më me kujdes, —
tha ai më në fund, dhe ju drejtua drejtorit të shtë-
pisë së pionierit.

Po as me këtë drejtor nuk i sqaroi dot rrugët
e formimit të njeriut të ri revolucionar. Bile ky
drejtor arriti ta fyente shumë rëndë Vehibin. «Ju
jeni mbrujtur me frazeologji pseudorevolucionare.
Më pak fraza dhe më tepër kallo, shok i dashur!» i
kishte thënë ai.

— Këtë do ta shohim më lart, — ja ktheu me
furtunë Vehibi dhe u zhduk duke përplasur derën
aq fort, sa që kërcitën xhamat e dritareve.

Vehib Valuta, si njeri i formuar dhe i vendosur,
u kthye fill e në shtëpi. Do të zinte pusi në
dhomën e fjetjes, për të pritur aty të birin. Sapo të
shkelte në koridor, ai do t'i vërsulej dhe, me një
breshëri, do të bënte copë-copë këmbënguljen e Te-
lit për t'u bërë shofer. Me një fjalë, do ta siktiriste
dhe do ta bënte rezil! Emri i tij, emri Valutë, nuk
do të përzihej me graso, me vajra dhe as me ben-
zinë.

Pra, ai na qenkej frazeolog! I zgjuar ky drej-
tori i shtëpisë së pionierit! Ai, Vehib Valuta, fraze-
olog!? Jo, more, dhe kjo pse nuk do që i biri të
bëhet shofer, që emri i familjes së tij të merret në-
për këmbë posht e lart!

«Po ç'më pandehni mua, mor vëlla? Vulëhum-
bur?»

Telin e gjeti duke lexuar një revistë. Pasi u
përhëndetën, duke respektuar të gjitha normat e
distancës, i biri e pyeti pa të keq, sikur në shtëpi-
në e tyre s'kishte ndodhur asgjë dhe pa ditur se
ç'bluante në kokë i ati.

— Babi, kam një copë herë që po vras mendjen

dhe nuk e kuptoj dot. Ja, këtu është shkruar «frazzeolog». Ç'do të thotë, babi, kjo fjalë?

— Kjo ty nuk të hyn në punë! — i shfryu Vehibi, duke ja flakur revistën përtej dritares.

Teli, i hutuar, doli nga dhoma, duke menduar se ç'faj të rëndë kishte bërë që pyeti aq me të urtë.

Ndërsa Vehib Valuta vriste mendjen të kuptonte se në ç'raport ndodhej ai me fjalën «frazzeolog», që nuk po i hiqej qafe!

PËR TË MITUR DHE PËR TË RRRITUR

(Skeç humoristik)

- Shpresa, haje bukën me gjalpë...
- Babi, ti pse po vishesh?
- Se do të dalim me mamin. Haje, se të bën mirë. Je e vogël dhe duhet të rritesh.
- E ku do të shkoni?
- Në mbledhje, Shpresa, mos e lerë bukën.
- Nuk e lë. Po ku e keni mbledhjen?
- Në lagje. E do me sheqer?
- Jo. Çfarë do të bëni aty?
- Mami do të takohet me zgjedhësit. Ha, shpirti i babit!
- Po ti, babi, pse shkon?
- Që ta takoj dhe unë. Mos bëj naze, pra, se duhet të hash që të shëndoshesh pak.
- Po pse nuk e takon mamin në shtëpi?
- Në shtëpi takohemi përdita, por duhet ta takoj dhe në mbledhje, se e kemi kandidate.
- Pse, babi, ti mamin nuk e ke grua?
- Grua e kam, shpirti i babit, por e kemi zgjedhur kandidate në zgjedhjet e këshillave popullore. Do të votoj edhe unë për mamin.

- Po unë, babi, pse nuk votoj?
- Se je e vogël. Kur të rritesh, do të votosh edhe ti.
- Për babin?
- Kushedi. Ndoshta përsëri për mamin.
- Ty, babi, pse nuk të zgjodhën tani?
- Zgjidhen punonjësit më të dalluar dhe më të zot, njerëzit më të mirë.
- Pse, babi, ti nuk je i mirë?
- I mirë jam, por mami është më e zonja në punë. Ajo me brigadën e saj, ku punojnë vetëm gra, ka ngritur një repart në fabrikë, me cilësi shumë të mirë.
- Vetë e ngritën gratë, në krah? Aq të forta janë?
- Shumë të forta.
- Domethënë ti thua ta dua mamin më shumë?
- Njësoj të na duash të dyve.
- Ti, babi, punon këpucë?
- Po. Ja, këto këpucët që ke mbathur ti, ne i kemi prodhuar.
- Për mua.
- Për ty dhe për gjithë fëmijët e tjerë. Ha, shpirti i babit, ç'po mendohesh.
- E di se çfarë dua unë?
- Jo. Çfarë do?
- Unë dua të rritem shpejt, të bëhem çupë e mbarë dhe të vini pastaj ju të takoheni me mua, jo vetëm në shtëpi, po edhe ashtu si do të takohesh sot me mamin, përpara se të votoni për mua!

DRITË NË MALET TONA

Në shtegun e heshtur të malit ecnin me hapa të shpejta dy malësorë të vegjël, Gjoni me motrën e tij Lulën. Rrobat e reja e të lehta, që kishin zëvendësuar veshjen e rëndë të dikurshme, i bënin më të shkathëta lëvizjet e tyre. Çantat e librave të hedhura pas krahëve tundeshin e kërcenin kur fëmijët zbrisnin me vrap ndonjë të tatëpjetë.

Ecnin dhe bisedonin me gëzim. Malet ishin kurreshtarë të dëgjonin se për çfarë flisnin dy kalimtarët e tyre të përditshëm. Ishin mësuar të dëgjonin prej fëmijëve gjëra të reja, që s'i kishin dëgjuar për shekuj me radhë. Por ja, Lula nuk e kuptoi dëshirën e festebardhëve dhe e la përgjysmë bisedën. Vrapoi drejt një shkëmbi nga kishte nxjerrë kokën një lule e bukur mali.

Lulë, mos u largo, se po vonohemi, — i foli i vëllai duke shprehur me zërin e tij urdhër e këshillë bashkë.

— Ja, ja, erdha, prit... — vinte gjithnjë e më larg zëri i vajzës.

Gjoni u ndal për ta pritur. Shtati i tij i lartë e tregonte më të madh për moshën që kishte. Mëson-te në klasën e shtatë. Shokët e donin, sepse ishte

guximtar, i urtë dhe përmbi të gjitha përpiquej për ta çuar deri në fund fjalën e dhënë. Lula me flokë të verdhë e sy të qeshur ishte shumë e shkathët dhe e afruar me të gjithë. Ajo shprehte në klasë gatishmërinë për aksionet dhe inisiativat e organizatës së pionierit. Çdo aksion i ri e bënte të fluturonte nga gëzimi. Prandaj edhe ato ditë s'përmbahej... U kthye tek Gjoni me lulen e këputur dhe i tha me mburrje:

— Të bardhë si kjo lule do ta bëjmë kullën tonë!

Zotimi që kishim marrë në çetë për higjenzimin e shtëpisë i kishte ngjalluar dëshira e mendime të reja. Me këto dëshira e mendime arritën në shtëpi. Lula hyri me të shpejtë brenda dhe u afrua tek oxhaku, ku ishte ulur gjyshi.

— Mirëdita, gjysh! A u mërzite? — e pyeti duke i dhënë lulen dhe, pa pritur përgjigje, filloi të fliste plot zjarr:

— Në shkollë sot vendosëm të lyejmë shtëpitë me gëlqere. Shtëpia jonë s'është lyer prej kohësh, prandaj unë e Gjoni u zotua para shokëve që ta lyejmë.

Plaku po e dëgjonte. Çdo fjalë e vajzës shtonte në fytyrën e tij shprehje shqetësimi. Kur Lula mbaroi së foluri, ai filloi me të tallur e plot inat:

— Ti dhe Gjoni!? Kujt i morët lejë që paskeni dhënë fjalën?! Kush ju pyet juve?! Për shtëpinë pyetem unë. S'keni për ta lyer!..

— Po unë erdha me një gëzim të madh, mor gjysh... pse më dëshpëron? — tha Lula dhe sytë ju mbushën me lot. Ktheu kokën që të mos e shihte ai, por gjyshi që thithte papushim çibukun e madh e ndjeu nga zëri që vajza e vogël ishte gati të

shpërthente në ngashërim. E donte shumë Lulën e vogël, që kujdesej për të, e donte shumë, por mendimi se fëmijët po ndërhyjnë si tepër në «rregullat» e shtëpisë ja mbërtheu me darë të fortë dashurinë për mbesën. U ngrit dhe me hapa të mëdha e të shpejta, që shprehnin nervozitet, doli nga dhoma duke thënë: «Shtëpia do të qëndrojë siç është dhe mos e zini më në gojë këtë gjë!»

Kur doli jashtë, u ndesh përballë panoramës madhështore të atyre bjeshkëve. Në qiell, retë rrëshqisnin ngadalë, si një tufë qingjash të bardhë.

«Thonë çamarrokët se duan ta bëjnë shtëpinë të pastër si bjeshkët tona. U rritën ata për të më mësuar mua! Veshjen e ndërruan, karotat na i sollën, dhe tani...» Duke kujtuar këto, gjyshi e ndjeu që fëmijët vetëm gjëra të mira kishin sjellë, por prapë i vinte inat, se i dukej që ata po vendosnin si shumë në zakonet e shtëpisë.

— Ah, gjysh, gjysh! Pse e dëshpërove kot vajzën? — e qortuan malet, kur panë Lulën duke fshirë sytë.

Lula shkoi te Gjoni, e kapi nga mënga e xhakës dhe e pyeti:

— A e dëgjove si bërtiti? Në zërin e saj ndihej frika se mos nuk do ta zbatonin zotimin.

Gjoni, si më i madh që ishte, e kuptoi se ç'donte të thoshte Lula dhe ju përgjegj:

— Ne do ta bindim gjyshin dhe shtëpinë do ta lyejmë patjetër.

Pasdreke fëmijët morën librat dhe u ulën nën një ah të vjetër. Gjoni nisi të lexonte fizikën, kurse Lula të mësonte përmendsh një vjershë. Befas, ajo e la librin dhe, duke treguar me dorë nga rruga, i tha Gjonit:

— Po vjen gjyshi i Palit!

Megjithëse bariu ishte akoma shumë larg, fëmijët e njohën nga ecja: ai shkante i përkulur pak mbi shkop. Gjyshi ishte fqinji i tyre më i afërt. Ai jetonte vetëm me nipin, Palin. Po bëhej një muaj që Pali kishte shkuar vullnetar në hekurudhë dhe fëmijët ishin afruar edhe më shumë me të. Lula thoshte gjithnjë se ai i kujtonte gjyshin e Dritanit të poemës «Mësuesi» dhe, sa herë që e takonte, i thoshte me zërin e saj të ëmbël, që tingëllonte si ndonjë këngë:

Bjери ziles, gjysh...

Gjyshi qesh, tund zilën e bagëtive

Ajo deshi t'i dilte përpara e t'i thoshte vjershën, por Gjoni e ndali.

— E di, Lulë, unë kam menduar që në shkollë për gjyshin e Palit. Duhet t'ja lyejmë edhe atij banesën.

— Oh, lumi motra, sa mirë ke menduar! — tha ajo duke kërcyer nga gëzimi. — Bile të parën t'ja lyejmë atij, të parën — dhe vrapoi t'i dilte përpara për t'i thënë se ç'donin të bënin. Ajo e dinte që gjyshi nuk do ta kundërshtonte. A nuk mburrej gjithmonë Pali me gjyshin, kur thoshte se e kishte tamam si shok?

— Po ti prit, mos u nxito, se ne nuk kemi marrë as gëlqeren, — i thirri i vëllai.

Lula s'e dëgjoi, Ajo rrëshqiti poshtë bregores nga vinte bariu dhe i doli përpara duke i thënë:

— Gjysh i Palit...

— He, moj Lulë, mos don t'i bie ziles? — ja priti plaku duke qeshur.

— Gjysh, a ta lyejmë me gëlqere shtëpinë
teinde? — e pyeti.

— Pse, e lyet tuajën?

— Jo... por... — Lula s'po dinte çfarë t'i thosh-
te.

— Por doni të mësoni zanatin në shtëpinë ti-
me,— qeshi bariu plak. Rrudhat e shumta që i bë-
heshin në fytyrë kur qeshte, e bënë më të dashur.

— Jo, për besë, o gjysh, por kemi dëshirë të ta
lyejmë ty më parë. — i tha Lula.

— Faleminderit. Derën e keni të hapur. Kur
të doni filloni nga puna.

Një buzëqeshje e plotë ja ndriçoi fytyrën Lu-
lës. U nda nga bariu dhe ju drejtua të vëllait, që
po afrohej duke i thënë plot gjallëri:

— Gjon, hajde shkojmë të marrim gëlqeren.

— Sot u bë vonë. Duam dy orë të arrijmë de-
ri në shkollë. Nesër është e dielë. Ngrihemi heret.

U err. Në dhomën e oxhakut u ndez bishtuku.
Pranë vatrës rrinte gjyshi i menduar. Herë pas he-
re jepte ndonjë urdhër. Vetëm ai u dëgjua të flis-
te derisa erdhi koha për të fjetur.

Gjumi ishte larguar nga shtretërit e fëmijëve.
Sapo u dëgjuan të gërhiturat e gjyshit, Lula pësh-
përiti:

— Gjon, sonte më janë dukur shumë të zeza
muret.

— Kur të vijë drita elektrike do të duken edhe
më keq, — foli me zë të ulët i vëllai.

— Po gjyshi, pse na kundërshton?

— Ai ka mendime prapanike.

— Po babai me nënën pse heshtin?

— S'duan t'ja prishin gjyshit, se është nevrík.
Ata dëshirojnë të na ndihmojnë për lyerjen.

— Jo, jo, do ta lyejmë vetë, — tha Lula dhe, duke harruar që gjyshi flinte aty pranë, e ngriti zërin.

— Shshët! Ka vende që s'i mbërrijmë.

— Shtëpia e gjyshit të Palit është shumë e vogël, e ulët. Atë e mbërrijmë. Do ta lyejmë vetë.

— Po. Tani të flemë, se nesër do të ngrihem herët.

— Natën e mirë.

— Natën e mirë.

Brezet e para të mëngjezit përshëndetën Lulën dhe Gjonin në rrugën e ngushtë të malit. Ata po shkonin drejt shtëpisë së gjyshit të Palit me nga një trastë plot me gëlqere. Pesha e rëndë që mbanin në kurriz, i kishte lodhur e djersitur, por ata s'folën asnjë fjalë për lodhje edhe kur ulën trastat e me zor drejtuan kurrizin.

Gjyshi i Palit e futi gëlqeren në një kazan të madh dhe i hodhi ujë. Ndërsa gëlqereja shuhej, Gjoni me Lulën nxorën plaçkat jashtë dhe mbushën ujë, që ta kishin gati për të larë dyshtemenë. Mësuesi i kishte porositur që të mos i lyenin duart me gëlqere, prandaj Gjoni u ngjiti nga një shkop të gjatë dy furçave. Kur çdo gjë qe gati, filluan lyerjen. Ata ndjenin kënaqësi të madhe kur furça rrëshqiste pas murit. U vunë në garë se cili do të lyente më shpejt e më mirë. Kjo gjë i bënte që të shikonin herë pas here punën e njëri tjetrit, të nxiteshin më shumë dhe të mbaronin përnjëherësh. Pastaj Gjoni filloi të lyente nga jashtë, kurse Lula të lante dyshtemenë. Pasi i vuri të gjitha orenditë në vend, ajo u largua pa bërë zë.

— Po kjo nga shkoi? — pyeti veten Gjoni kur pa që Lula nuk ishte aty.

Lula po fluturonte e shpejtë si flutur drejt shtëpisë së saj. Hyri brenda, mori çantën e librave dhe nxori nga pala e një libri portretin e shokut Enver, të cilin e kishte ngjitur në një karton dhe e kishte zbukuruar anash me letër të shkëlqyer ngjyrë ari. E mbështolli me një gazetë dhe e shtrëngoi fort në gji.

— Do të pregatis një tjetër për vete, — mendoi Lula kur doli në rrugë. Era e lehtë që nisi të frynte, luante me flokët e verdhë dhe me shaminë e kuqe të pionierit, që mbante në qafë. Ajo ecte shpejt duke mbajtur në të dy duart, në kraharor, portretin. Ajo ecte dhe i kujtohej mbledhja e fundit e kompanisë, ku kishin mësuar porosinë që jep shoku Enver për higjienizimin e fshatit.

— E mbarova, Lulë! — thirri plot gëzim Gjoni kur e motra u afrua.

— Të lumshin duart! Sa e bukur duket tani shtëpia! — tha Lula dhe sytë i ndritën fort. Shiko ç'kam sjellë, — shtoi ajo duke treguar portretin e shokut Enver. Portretin e varën në murin e bardhë, të pastër. Në dhomë vinte një erë e freskët, e këndshme. Fëmijët shikonin me kënaqësi muret e bardha dhe fotografinë e udhëheqësit që u buzëqeshte me dashuri. U largua duke marrë me vete ngrohtësinë e asaj buzëqeshjeje.

Pas dy ditësh, një grup pionierësh ndaloi para shtëpisë së bariut. Me ta ishte dhe Gjoni me Lulën. Pionierëve u bëri përshtypje pastërtia që kishin mbajtur gjyshi i Palit.

— Meriton flamurin e pastërtisë, — tha komandantja e çetës.

— T'ja varim te dera, — u dëgjua një tjetër. Ndërkaq erdhën aty bariu me gjyshin e Gjunit.

Pleqtë hynë në grumbullin e pionierëve, që i pritën me gëzim. Bariu kur pa flamurin e pastërtisë në derë, ju afrua Lulës e Gjonit dhe i përkëdheli duke u rënë krahëve. Ata ngritën kokën dhe ndeshën vështrimin e qeshur të gjyshit të tyre. Për anëtarët e shtabit të çetës, që kishin dalë për të parë si kishte nisur aksioni i pionierëve për higjenizimin, çdo gjë u bë e qartë.

— Shtëpinë tuaj, Gjon, do të vijmë ta shikojmë një ditë tjetër, — tha njëri nga pionierët.

— Mirëse të na vini! Me siguri do të na vini edhe në një flamur pastërtie, — foli kësaj radhe gjyshi i Gjonit dhe i Lulës duke buzëqeshur.
